

Këtë 29 tetor u bënë 560 vjet nga ngjarja diplomatike e Rodonit, vend historik ku nga Skënderbeu dhe kancelarët e tij u hartua, u nënshkrua e u vulos me vulën e tij vetjake, si dhe me vulën e një noteri publik shtetëror, një akt prokure ndër më të rëndësishmit e diplomacisë së heroit. Nëpërmjet një prokure të tillë, Arbëria përfaqësohej me një status juridik në kolegjin e kardinalëve që do të mbledhej nga Piu II në realizim e sipër të projektit të tij luftarak kundër ekspandimit turko-osman në pjesën juglindore të Europës. Në koncistorin në fjalë, ku do të merrnin pjesë fuqitë e krishtera të kohës, prokuratori do ta përfaqësonte Skënderbeun përkrah “mbretërisht të tjerë ose ambasadorësh të tyre”, siç saktësohet në vetë aktin.

ZOTËRIT E PERLATIT

Një përkujtim historik

nga Aurel Plasari



BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË PËRKUJTON VEDAT KOKONËN

Është përkujtuar në ambientet e Bibliotekës Kombëtare ditëlindja e 110-të e Vedat Kokonës. Miq, të njohur dhe lexues e adhurues të punës së tij u mbledhën në ditën e fundit të tetorit për të vizituar ekspozitën kronologjike me gjithë udhëtimin e tij letrar, nga fillesat në vitet '20, deri kur ndërroi jetë

(fq. 9)

SHËNIME MBI LIBRAT

POEZIA ELEGJIAKE NË NJË VËSHTRIM KRAHASUES MIDIS NAIM FRASHËRIT DHE ZEF SEREMBES

Nga Dhurata Kasa

(fq. 8)

TROKITJE NË VEPRËN LETRARE TË ZIJA ÇELËS

Nga Yzedin Hima

(fq. 10)

Mario Bellizzi, “La crisalide e la forma die silenzi – NIMFA
DHE PJAZMA E HESHTJEVET”

NË HESHTJE RREZIKOHET VDEKJA E GJUHËS

Nga Shefqet Dibrani

(fq. 12)

Resul Shabani “Ëndërr e falur”/Podaren son”

POEZI ME SHKËLQIME DHE HIJE

Nga Sande Stojčevski

(fq. 14)

Mbi librin “Kalendari i ëndrrave të mollës”
të Natasha Shuteriqi Poroçanit

KUSH LEXON MIRË, MENDON BUKUR

Prof. as. dr. Helena Grillo

(fq. 15)

PUBLIKOHET NJË KËNGË E RE NGA “THE BEATLES”

(fq. 11)

ITALO CALVINO:

Kam frikën e përsëritjes në
veprën time letrare

Përktheu Granit Zela



LULJETA LLESHANAKU

“Poetessa Laureate”

për vitet 2023 – 2025

Lleshanaku u vlerësua me motivacionin: Për vargun e saj modern, larg metaforës së automatizuar duke e ndërtuar me ritëm e krahasim domethënien e frazës poetike, si dhe për krijimin e një brezi të ri poetësh. Luljeta Lleshanaku përfaqëson çka është postmoderne në poezinë shqipe, duke i kthyer kësaj të fundit bashkëkohësinë me poezinë botërore.

BIBLIOTEKË

Donika Dabishevc

(fq. 13)

*N’fushëbetejë shtratin
kam me e kthy*

Faruk Myrtaj

(fq. 16)

Krahë zogu të sa-lindur

Qazim Shehu

(fq. 17)

Qyteti i ndaluar

Anton Pappleka (përkthim)

(fq. 18)

Nga poezia botërore

Enver Kushi

(fq. 20)

*Kronikë nga dita e parë
e kohës zero*

Arben Meksi

(fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Fragment nga libri i sapobotuar
“Figura-personazh që shihet përmes fjalës”

FORMËSIMI “VIZUAL” BRENDA RRJETËS NARRATIVE

Nga Floresha Dado

(fq. 6)

Shënime rreth shfaqjes më të re të teatrit “Migjeni”
“VIZITA” E MREKULLUESHME
E DAVIDE IODICE
Nga Stefan Çapaliku

(fq. 21)

Këtë 29 tetor u bënë 560 vjet nga Kngjarja diplomatike e Rodonit, vend historik ku nga Skënderbeu dhe kancelarët e tij u hartua, u nënshkrua e u vulos me vulën e tij vetjake, si dhe me vulën e një noteri publik shtetëror, një akt prokure ndër më të rëndësishmit e diplomacisë së heroit. Nëpërmjet një prokure të tillë, Arbëria përfaqësohej me një status juridik në kolegjin e kardinalëve që do të mblidhej nga Piu II në realizim e sipër të projektit të tij luftarak kundër ekspandimit turko-osman në pjesën juglindore të Europës. Në koncistorin në fjalë, ku do të merrnin pjesë fuqitë e krishtera të kohës, prokuratori do ta përfaqësonte Skënderbeun përkrah “mbretërisht të tjerë ose ambasadorësh të tyre”, siç saktësohet në vetë aktin.

Abati Pjetër Duka, ndryshe Perlati, i shfaqur në legalizimin e aktit ndër kancelarët diplomatikë të Gjergj Kastriotit, – krahas kryepeshkopit Pal Engjëlli dhe një oratori e nunci apostullor në Arbëri të quajtur Vlash etj., – mund të përbëjë rast kërshëror në historinë e fisnikërisë arbërore të Mesjetës: pikërisht një figurë historike si e tija ndihmon të hidhet dritë mbi një familje fisnike arbërore. Fjala është për Zotërit e Perlatit, “*Die Herrn von Perlat*” i quajti më se një herë Šufflay, ende sot njëra ndër familjet e mëdha arbërore pak të studiuar.

Ndër shkaqet që mund të kenë penguar ndriçimin e historikut të kësaj familjeje, njëri mund të jetë kamuflimi i tyre nën emrin e madh të Dukagjinëve, pjesë të të cilëve dhe Zotërit e Perlatit të Mirditës përbënin. “Dukagjinët, - i ka regjistruar z. Ducange në gjenealogjinë përkatëse, - që mbajtën gjithnjë primatin ndër fisnikët arbërore”. Situata bëhet e kuptueshme për këdo që është orvatur të përcaktojë zotërimet e Dukagjinëve, sa të ndërlikuara, aq edhe të lëvizshme. Një tablo të tyre e ndërtoi Hopf-i, duke kombinuar njoftimet e kronistit Muzaka me të dhëna të burimeve dokumentare nga arkivat e Venedikut, të Napolit etj. Një tjetër tablo të tyre ndërtoi konsulli Ippen. Një orvatje për të përcaktuar zotërimet e Dukagjinëve shihet edhe në hartën bashkëlidhur vëllimit I të përmbledhjes *Acta et diplomata* (1914). Të tjera orvatje kanë pas bërë Jakova-Merturi, Sirdani, Šufflay deri te një Ivan Božić. Duhet mbajtur parasysh, padyshim, që mund të jetë fjala për periudha të ndryshme të zhvillimit të dinastisë së Dukagjinëve dhe, prandaj, për zotërimet që kohë më kohë kanë ndryshuar.

Po lidhur me zotërimet e Dukagjinëve, e ndërlikuar është edhe gjenealogjia e tyre, veçan degëzimi i tyre. Muzaka i ndante në “Dukagjinë të vërtetë” dhe “Dukagjinë të tjerë”. Për Šufflay-n ata e patën ruajtur karakterin e “shtëpisë së madhe” dhe të “vëllazërisë” deri në kohën e Turqisë, ashtu si në traktatin e dorëzimit të Lezhës venedikasve më 1393, në të cilin përmenden me shumë “vëllezër, kushërinj e farefis”. Më pranë së vërtetës rezultojnë Paolo Petta, që i karakterizoi Dukagjinët jo si një familje të vetme të

ZOTËRIT E PERLATIT

Një përkujtim historik

nga Aurel Plasari

madhe, por si një rrjetë e gjerë fisesh me më shumë se një degë. Për ç’i takon shënjesës së tyre heraldike, studiuesit kanë menduar – më sak: hamenduar – që të ketë qenë shqiponja me një kokë, sipas një basorelievi guri të inkastruar në kishën e Shën Mërisë së Ndërfandës, i gjetur nga Ippen-i. Sirdani, për shembull, pohoi: “Dukagjinët patën për stemë një shqype të bardhë”.

Që Perlatajt, siç i quajtën Hahn-i,

Ippen-i, Šufflay e të tjerë, përbënin një nga degët e Dukagjinëve e vunë re të parët autorët e *Acta*-ve (II, 1918) duke lexuar një akt dokumentar venedikas të 27 majit 1402. Me anë të tij Senati i Republikës ka miratuar propozimin e kont-kapitenit të Shkodrës për të marrë në shërbim Pal dhe Tanush Perlatin (*Paulus et Tanusius Perlat*), të cilët rezultojnë të fisit të Dukagjinëve: Pal Perlati i biri i Lekë Dukagjinit.



Botuesit e *Acta*-ve i dalluan Perlatët si “familje e fisit Dukagjin, vartës (vasalë) të tyre, me sa shihet” (“*familia de stirpe Dukagin, suboles, ut videtur*”), ndërsa dy personazhet në fjalë, Palin dhe Tanushin: “banues në Perlat” (“*in Perlat residentes*”). Duke regjistruar të njëjtin akt në *Sprovën* e tyre për një regest historik të Shqipërisë (1937-1940), edhe Cordignano e Valentini e pranuan këtë identifikim për të përmendurit Pal dhe Tanush duke i shënuar ata si *Dukagjini-Perlati*.

Kjo rezidencë e Dukagjinëve në Perlat të Mirditës duhet të lidhet me dukurinë e tërheqjes së një numri dinastesh arbërore nga qytetet e fortifikuara (Durrësi, Lezha etj.) nëpër fshatrat e krahinave të brendshme, një zhvendosje që e ka vënë në dukje Šufflay. Për të, në këtë tërheqje që rezultojnë të ketë filluar prej fundit të shek. XIV dhe që ka për shkak edhe rrezikun nga depërtimi turk në Arbëri, dinastë të tillë vendoseshin në ato ndërtesa banimi që Barleti i quan “*oppidula*”, njëfarë kështjelle e vogël, prototipi i *pirgjeve* në jug ose i *kullave* në veri. Ka shtuar Šufflay:


“Një degë e Dukagjinëve banonte në vitin 1402 në Perlat (sot Perlataj), në kufirin e veriut të Matit, ku ishte sigurisht një kështjellë e vogël (*eine kleine Burg*)”.

Në vitet ’30 dhe ’40 të shek. XV personazhi historik më i spikatur ndër “Zotërit e Perlatit” rezultojnë Pjetër Perlati, emër që shfaqet në burimet tregimtare dhe ato dokumentare herë si komandant ushtarak, herë si abat (pra klerik) dhe herë si diplomat. A është i njëjti? Që komandanti të cilit Skënderbeu i kishte besuar mbrojtjen e qytetit të Sfetigradit në qershor-korrik të 1448-s, dhe që i priu qëndresës së guximshme të banorëve të qytetit ndaj rrethimit turk, ishte njëherësh edhe klerik, kjo konfirmohet nëse lexohet me kujdes Barleti kur shkruan për të:

“Ishte ky burrë nga Emathia [Mati, -A.P.], kryepriift që ata i quajnë protosingjelë, kurse ne në gjuhë popullore i quajmë zakonisht abatë,



Shtatore e Pjetër Dukës – Perlatit. “Kështjella Duka”, Perlat. Foto e autorit.



Kalaja e Skënderbeut në Kepin e Rodonit, Arbëri. Nga: *Città, Fortezze, ed altri Luoghi principali Dell'Albania, Epiro, e Livadia, e particolarmente i posseduti da Veneti descritti e delineati dal P. Coronelli, In Venetia [1688]*.

me një jetë fort-shembullore dhe një pastërti të madhe në zakone; përveç shkëlqimit në dije, edhe mjeshtëria në të folur tok me peshën e viteve ia zbukuronin pjesën tjetër të virtyteve”.

Në kohën kur Perlatin e vizitoi konsulli Ippen, rreth 1900-s, e gjeti fshat dhe që përbënte një famulli. Konsulli albanolog ka vënë re:

“Fshati i përmendur më parë Perlataj, i cili është një famulli, zë vend në historinë e Shqipërisë si vendlindja e një mbrojtësi trim të Arbërisë nga pushtimi turk, Pjetrit të Perlataj (sic), bashkëluftëtarit dhe gjeneralit të Skënderbeut [...]. Ky Pjetër i Perlataj ishte mbrojtësi i Svetigradit, qytet të cilit iu desh të përballonte një rrethim të paharrueshëm nga sulltan Murati II më 1449 (sic)”.

Pasi ka përmendur edhe Gjon Perlatin, si një nënkomandant (*Unterführer*) të Skënderbeut dhe një ndër tetë kapedanët që u zunë rob e u rropën të gjallë me urdhër të sulltanit më 1464, Ippen-i ka bërë kujdes të shënojë që Perlati është shumë afër Matit të kohës së tij dhe, përveç kësaj, e gjithë zona e Kthellës llogaritej më parë si Mat, kështu që ai nuk pa ndonjë kontradiktë që Barleti ka përmendur Matin si vend

prejardhjeje të Pjetër Perlatit. Gjatë hulumtimeve të tij Ippen-i gjeti në Balldren rrënojat e një kishe në stilin romanik; prej një mbishkrimi që lexoi në të, mbërriti në përfundimin që në shekullin XV kisha në fjalë kishte qenë “nën patronazhin e zotërve të Perlatit”.

Në funksionin diplomatik “abati Pjetër” shfaqet në burimet dokumentare për herë të parë – me sa dimë deri sot – më 1439 në një akt prokure në të cilën përmendet si prokurator i Gjergj Kastriotit dhe “ambasador i zonjës Jellë, të vesë së zotit Gjon Kastrioti”. Arsyeja që “abati Pjetër” të ketë qenë njeri kaq i besuar i Kastriotëve edhe në çështje aferash tregtare familjare do të kuptohet në shfaqjen e tij në burimet dokumentare për herë të dytë.

Shfaqja e tij e dytë i përket vitit 1447, në një mesazh diplomatik të mbretit Alfons të Napolit drejtuar më 14 dhjetor Gjergj Kastriotit, ndryshe Skënderbe, në të cilin “abati Pjetër” përmendet si njëri ndër dy ambasadorët e dërguar prej Skënderbeut në oborrin e mbretit të Napolit. Me rëndësi në mesazhin e mbretit ndajshimi për abatin në fjalë duke e cilësuar “i një gjaku me ju”, d.m.th. me Skënderbeun: “*abate Petro, consanguineo vestro*”. Nga




teksti i përgjigjes së Alfonsit kuptohet që Skënderbeu të ketë dërguar një të afërm të tijin sepse do të trajtonte me mbretin e Napolit jo vetëm çështje të përgjithshme të qëndresës dhe të luftës kundër turqve, por edhe çështje familjare, çfarë kuptohet nga përgjigjja e mëposhtme e Alfonsit:

“Sa për strehimin që na kërkon në tokat tona të Apulisë, sidomos për ju, fëmijët tuaj dhe familjen, në rast se, Zoti na ruajttë, ju vë poshtë armiku, ne ju pranojmë me gëzim, e qysh tani kemi urdhëruar që të dërgohen letrat e duhura, të cilat kanë për t’ju sjellë të njëjtët të dërguar”.

Në këtë lidhje gjaku ka shumë gjasë të bënte pjesë edhe tjetri komandant ushtarak i Skënderbeut, Gjon Perlati, njëri ndër tetë kapedanët e përmendur që u zunë rob urropën të gjallë me urdhër të sulltanit më 1464. Për t’u vënë re që ndër ta kishte jo vetëm komandantë shumë të besuar të Skënderbeut, si Mojsiu i Dibrës, Nikollë Erizi ose Berisha, Gjergj Kuka dhe Gjin Maneshi, por edhe ushtarakë madhorë në lidhje fisnie ose krushqie me Skënderbeun: Vladan ose Vlash Gjurma, që shënohej “i një gjaku” me të; Muzaka i Angjelinës, që ai e kishte nip prej motre; Gjin Muzaka,

të cilit i kishte dhënë të motrën Vljaka etj. Schirò-i, në një rezymé të dhënash nga burime napolitane, e ka regjistruar Gjon (*Giovanni*) Perlatin edhe ndër ambasadorët e dërguar nga Skënderbeu pranë mbreti Alfons më 1454 për t’i kërkuar ndihma për marrjen e Beratit, bashkë me një Pal Kuka dhe një Nikollë Erizi ose Erizi.

Shfaqja e tretë e rëndësishme e abatis Pjetër është kjo e këtij përvjetori: në nënshkrimin e një akti dokumentar, prokurë, dalë prej kancelarisë së Skënderbeut më 29 (XXVIII) tetor 1463. Si ka marrë relacionin prej ambasadorit të tij Martin Muzaka, Skënderbeu, “nga Rodoni në vendin e Shën Mërisë”, në prani të “Pal Engjëllit të Durrësit dhe të rajonit ilir”, të Pjetër Dukës “abat i S. Aleksandrit [Shën Lleshit] të Mullirit në dioqezën e Arbnit në Arbëri”, me “Vlashin (*Biagio*) prior i domenikanëve të Kuvendit të Shkodrës, orator dhe nunc apostullor në Arbëri”, si dhe në prani edhe dëshmitarësh të përshtatshëm dhe një noteri, i ka dhënë Martin Muzakës mandatin si prokurator i tiji i posaçëm për ta përfaqësuar në Kolegjin e Kardinalëve thirrur në koncistor nga papa Piu II dhe për të trajtuar çdo çështje lidhur me sipërmarrjen e



Akti i prokurës, 29 tetor 1463, i depozituar në Dhomën Apostullore. Riprodh. Fotostatik: Lorenzo Tacchella, Giorgio Castriota Scanderbeg, Milano 1987, ff. 58-61. Po ai, Giorgio Castriota Scanderbeg, Milano 2000, ff. 66-69.

planifikuar luftarake kundër turqve. E kam trajtuar për herë të parë këtë akt të rëndësishëm në një shkrim me titull *Me kryqëzatën e Piut II*, mbështetur në kopjen e aktit origjinal të riprodhuar nga Lorenzo Tacchella ("55", nr. 130, 29 shtator 2002).

Ka pasur më vonë edhe një lexim të ndryshëm të vitit të këtij akti: 1458 (MCCCCLVIII) në vend të leximit 1463 (MCCCCLXIII) nga Tacchella. Në rastin e vitit 1458 do të ishte fjala për thirrjen prej Piut II të kuvendit të përgjithshëm të princave të krishterë të Europës, jo në Romë, por në Mantua; kardinalëve, peshkopëve, ambasadorëve dhe gjithë autoriteteve të kurjes papnore ai ua kishte shpallur idenë e një kuvendi të tillë më 10 tetor të atij viti. Në *Komentaret* e tij Piu II e ka treguar edhe praninë e arbërorëve mes të dërguarve të pranishëm në Kuvendin e Mantuas: "Ndërkaq janë paraqitur legatë nga Qiproja, Rodi, Lesboja, si dhe disa nga Azia. Mandej edhe arbërorët (*Tum vero Albani*), epirotët, boshnjakët dhe nga çdo vend i Ilirisë kanë dërguar oratorë për të kërkuar ndihmë; dhe tanimë nëpër gjithë qytetin bien në sy njerëz nga Lindja, që kërkojnë me ngulm përforcime kundër turqve". Leximi 1463 i vitit ngjan të integrohet më mirë në kontekstin historik, duke u lidhur me mbledhjen e re të përfaqësuesve të fuqive italiane që Piu II organizoi më 22 shtator të atij viti. Në atë koncistor Piu II parashitroi edhe projektin e sipërmarrjes antiturke, i cili do të bëhej publik një muaj më vonë, më 21 tetor 1463, në një bullë historike në të cilën përmendeshin veçan edhe arbërorët si potencial bashkëpunues luftarak: "Do të jenë me ne edhe arbërorët..." (*Erunt &*

Albani nobiscum...). Këtij projekt duket t'i përgjigjet teksti i prokurës së Rodonit, në të cilën edhe merren përsipër një sërë detyrimesh në atë bashkëpunim. Gjithsesi, në historikun e Perlatajve dhe të abatis të tyre emërmadh, nuk ndërron gjë thelbësore çështja e vitit të aktit të prokurës, që mbetet për t'u hulumtuar.

Pyetja që mund të shtrohet lidhur me këtë akt të 29 tetorit: Përse në të abati Pjetër shfaqet me mbiemrin Duka?

Mbiemri Duka ka qenë në Perlat mbiemër i një fisi, me sa duket, me pozicion të spikatur, qoftë edhe "vartës" (*suboles*) i Dukagjinëve, siç e menduan autorët e *Acta*-ve. Hahn-i, që e vizitoi Perlatin gjatë hulumtimeve, duke përshkruar situatën e tij të gjysmës së parë të shek. XIX e tregoi Perlatin të përbërë nga katër fise (përdor shq. *fis* për gjerm. *Geschlechter*: Dodaj, Hiloj, Dukaj, Boçaj. Përdorimi në këtë rast, nga ana e abatis Pjetër, i mbiemrit Duka dhe jo Perlati, mund të ketë të bëjë edhe me një arsye politike: me distancimin nga lidhja me Dukagjinët, të cilët – të mos harrohet – qenë ndër të parët zotër arbërorë që u morën vesh me turqit, qysh pas sulmit të parë turk në Arbërinë e veriut më 1387 kur këta depërtuan deri në grykën e Drinit, çfarë kuptohet nga rënia në ujdi me ta e vëllezërve Lekë dhe Pal. Edhe më vonë, ndërsa Pjetër Perlati, Gjon Perlati dhe ndoshta edhe të tjerë Perlatë mbështetnin Skënderbeun në qëndresën antiturke me armë e me diplomaci, Dukagjinët u dëftuan refraktarë, madje shpesh edhe sabotues të asaj qëndrese, çfarë do ta detyronte ndonjërin nga papët t'i kërcënonte deri me nxjerrje nga kisha, me shkishërim. Një arsye më shumë kjo për një benediktin, si abati Pjetër, për t'u distancuar jo vetëm nga politika e

Dukagjinëve, por edhe nga lidhja me emrin e tyre si *Perlatë-Dukagjinë* duke t'u kthyer mbiemrit fisnor *Duka* të Perlatit.

Mbetet një pyetje e fundit: Përse ky veprim i rëndësishëm i kancelarisë së Skënderbeut është kryer pikërisht në Rodon dhe jo, siç mund të pritej, në Krujë?

Përgjigjja gjendet te rrethanat që lexohen në vetë dokumentin. Pikësepari, thuhet aty që vendimi është marrë dhe mandati Martin Muzakës i është dhënë pasi Skënderbeu ka dëgjuar relacionin e tij prej ambasadori të dërguar pranë Piut II. Ky Martin Muzakë është në historinë e Skënderbeut një diplomat disa misionesh, si para këtij të Rodonit kur emërohet prokurator i posaçëm, edhe pas tij si ambasador, legat etj. Vetë Skënderbeu, në aktin e prokurës, ia lavdëron me të madhe meritat. Njëri ndër misionet e tij më delikate, pra me peshë të veçantë, ka qenë i vitit 1460, kur Skënderbeu e ka dërguar si "legat ushtarak" po pranë Piut II për t'i kërkuar lejë për një armëpushim me Mehmetin II, si dhe për ta lutur atë që, edhe nëse nuk ia pranonte kërkesën, të dërgonte në Arbëri një legat papnor për t'ia besuar atij qeverisjen e vendit gjatë mungesës së atij vetë në ndërkohën që do të ndërhynte në Itali në luftën për trashëgiminë napolitane.

Kësaj here kuptohet që ambasadori në fjalë është kthyer nga Roma dhe nuk ka ndonjë dyshim që të ketë zbarkuar në Rodon. Rodoni ishte porti funksional i Kastriotëve në rrethanat e atëhershme; Durrësin e mbanin venedikasit dhe qëndrimi i tyre ndaj sipërmarrjes antiturke në gatitje e sipër ishte i dyshimtë, më e pakta. Mundet që aty në Rodon ambasadori i ka relatuar

Skënderbeut, i cili të ketë dalë për ta pritur po aty. Pas relativitetit, veprimi me dhënien e mandatit ambasadorit tanimë si prokurator i posaçëm le të kuptohet që këtij t'i jetë dashur të nisej pa vonesë për t'u kthyer në kurjen e Romës, ku ishte atashuar dhe ku do të mbledhej koncistori i përmendur në akt. Dhe kjo nisje po nga Rodoni mund të kryhej.

Ngjarja historike e Rodonit paraqet interes edhe për të dëshmuar se kalanë e Rodonit, të njohur në harta të Adriatikut si "*Fortezza di Scanderbech*", Gjergj Kastrioti e ka përdorur jo vetëm si rezidencë të së motrës Mamicë, e cila ka gjasë të ketë pretenduar edhe trashëgimi të atij territori duke qenë nga burri e Thopiave, që qenë zotër të Arbnit, ku edhe Rodoni bënte pjesë. Skënderbeu e ka përdorur atë rezidencë edhe si kancelari alternative, edhe kishën e atyshme të Shën Mërisë e ka përdorur, si në rastin e këtij akti. Porti i Rodonit, sikundër kuptohet nga marrëveshjet e viteve të fundit të Skënderbeut me Republikën e Venedikut, kishte edhe një funksion strategjik: ishte pika më e lehtë për ikje në një rast mundjeje të mundshme. Nga ana tjetër, të vihet re që Barleti na tregon se kepi i quajtur Rodon (*que Redoni dicebat*) ishte vend i parapëlqyer për Gjergj Kastriotin, si në rastin e verës së vitit 1457 kur heroi paskësh vajtur aty për të kaluar bashkë me zonjën e tij një pjesë të verës dhe ku kaloi edhe një pjesë të madhe të vjeshtës me gjueti dhe me "pasione të tjera këso dore", e thotë vetë Barleti. Një rast ky për të kujtuar që edhe Rodoni do ta meritonte t'i rindërtohej një historik dhe të rivlerësohej në trashëgiminë kulturore të Arbërisë.

LULJETA LLESHANAKU

zgjidhet “POETESHA LAUREATE” për vitet 2023 – 2025



Në një ceremoni të mbajtur me datë 31 tetor, Luljeta Lleshanaku u zgjodh “Poeteshë Laureate”, në edicionin e dytë të ndarjes së këtij çmimi. E pranishme në ceremoni, Lleshanaku tha ndër të tjera:

Një nga momentet më të vështira në gjithë krijimtarinë time ka qenë përballja me lexuesin shqiptar. Për mua fillon një moment ankthi në momentin që libri del nga procesi i botimit. Është shumë e vështirë të impresionosh lexuesin shqiptar; jo vetëm sepse lexuesi shqiptar është pak kapriçoz, është dhe shumë skeptik por dhe sepse ti me lexuesin tënd ndan të njëjtën përditshmëri dhe është shumë e vështirë ta impresionosh dhe ta habisësh. Për më tepër ta bësh që të të

dojë. Dhe në kohët që jetojmë është edhe më e vështirë sepse lexuesi është i ekspozuar ndaj arritjeve më të mëdha botërore. E nëse ai merr mundimin të lexojë poezinë shqipe dhe për më tepër të zgjedh ty, kjo është një arsye për t’u ndjerë mirë.

Mes dhjetë poetëve të nominuar, juria e kryesuar nga Sibel Halimi dhe anëtarë Ylljet Aliçka, Arta Marku, Arlinda Dudaj dhe Dhurata Shehri e vlerësuan Lleshanakun me motivacionin:

Për vargun e saj modern, larg metaforës së automatizuar duke e ndërtuar me ritëm e krahasim domethënien e frazës poetike, si dhe për krijimin e një brezi të ri poetësh. Luljeta Lleshanaku përfaqëson çka është postmoderne në poezinë

shqipe, duke i kthyer kësaj të fundit bashkëkohësinë me poezinë botërore.

Vetëm pak kohë më parë, Luljeta Lleshanaku u vlerësua me çmimin “Poeti Evropian i Lirisë” nga një juri që në përbërje kishte edhe nobelisten Olga Tokarczuk. Ajo është një nga zërat më të rëndësishëm të poezisë shqipe, e vlerësuar kombtarisht dhe ndërkombtarisht. Zgjedhja e saj si poeteshë laureta, si rralleherë ndodh me çmimet letrare në Shqipëri, nuk ka shkatuar asnjë debat apo kundërshti, përkundrazi, të gjithë kolegët dhe njerëzit e botës së letrave e kanë uruar laureaten dhe kanë vlerësuar jurinë për zgjedhjen.

ZOGJ DHE KARBON

Po afron koha
kur poetët i rikthehen sërish stinës së
zogjve
duke fshirë me mëngë gjurmët e
karbonit mbi letër.

Ne njohim veç vendqëndrimet e tyre;
harku është i ikshëm. Të njëjtin hark
bën edhe shkopi në duart e ciceronit në
muze,
duke u ndalur çdoherë në të njëjtat pika:
Vaterlo, Itakë, Kajro e Berlin...

Atje ku historia, imja dhe e gjithkujt,
ndalet një hop dhe merr frymë thellë,
koha frenon.
Koha tjetër është veç tymra, bagazhe që
zbresin e ngjiten,
flamuj të vegjël konduktorësh.
Koha tjetër është veç imagjinatë...

Unë s’e mbaj mend se kur ka qenë hera
e fundit
që mbajta frymën.
Ishte verë. Gusht. Qielli i gërvishtur
me vija të freskëta, të kuqe, si pëllëmbë
kopshtari.
Të sapomartuarit silleshin gjithë gaz
rreth shtëpisë sime.
Erdhi frymëmarrja.
E vetmja pemë që fërgëllonte në fushë
i shndërroi ata në dy copa të mëdha
letre,
i dënoi në laradashë të përjetshëm.

MEDITIM ME SHKUMË NË FYTYRË

Një rruajtje pas pune, e përse duhet?!
Njëlloj si im atë,
shumë kohë më parë,
para një pasqyre të venitur, plasa-plasa
si një kaçamak i gatuar pa yndyrë.
Edhe ai rruhej tamam në këtë orë,
me një brisk që rrëshqiste nga lart-
poshtë,
duke hapur një shteg të pastër nga
tëmthat në mjekër
si fjalët e apostullit. E ndërsa gjuha e
mbështjellë kërmill
zbrazte njërën faqe dhe mbushte tjetrën,
e folura e tij më vinte rikoshet përmes
xhamit:
“Fuqia e burrit, bir, matet me gjërat që
nuk bën.

Pasioni mbahet fshehur, si fruta e
repës!”

Ishte njëlloj si të thyjeje një rregull
kur unë, vite më vonë,
në mëngjes herët, pa zënë punë me dorë
nxirrja ferrën time nga lëkura
duke përdorur fshehtas veglat e tim eti.

Kur dora filloi të më dridhej, unë
kërkova një zot.

Nuk qe e vështirë. Njëlloj si të kërkosh
një berber në atë lagje
që e njuh në pëllëmbë të dorës.
Ai nuk e ka zakon të të pyesë: “Çfarë
mund të bëj për ty, djalosh?”
Kryqi është më i vjetër se njeriu.

Dhe ja ku jam, pa asnjë prerje,
i ndriçuar nga llamba e hipofizës në
zverk.

Një rruajtje e pastër, - siç i thoshte im
atë i cili,
kur vdekja erdhi ta merrte,
të merrte fytyrën e tij të parruar prej
ditësh
si një grumbull milingonash rreken të
përmbysin në vrimë një kokërr gruri,
mblodhi shuk retinat, siç mbledh shuk
pecetën
fëmija
kur e detyrojnë të ngrihet i pangopur
nga tryeza.

KATËR FJALË

Eskimezët kanë katër fjalë të ndryshme
për “dëborën”:
të renë, të shkelurën, të thinjurën, të
mblledhurën në togje.
Ata janë në gjendje të dallojnë nuancat e
së bardhës,
hiçit, asgjësë, së sotmes së pafund,
që vetëm një sy i lirë ia del.

Andej nga unë vij përdoren katër fjalë të
ndryshme për mbrëmjen;
çuditërisht, ajo që i rri më mirë është
fjalë e huaj
që rimon me “jargavan”,
e sjellë nga pushtuesit dhe jo nga
tregtarët e erëzave.

Andej nga vij unë kanë vetëm një fjalë të
vetme për “mërzinë”,
si edhe për “ujin”, që merr formën e enës
që e mban:
secili enën e vet, secili mërzinë e vet.

Grekët kanë katër fjalë të ndryshme për
“dashurinë”,
si katër kunjat e një tende që të jep
patjetër një copë vend në këtë botë.
Në mos sot, nesër.

Ndërsa në vendin nga unë vij, sipas
antropologëve,
deri para një shekulli nuk ekzistonte
asnjë fjalë e vetme për “dashurinë”,
por vetëm një dyshim i zgjuar-naiv që
“duhet të ekzistojë patjetër diçka më e
fortë se ne, apo jo?”,
me gjestin retorik të një mbreti i cili
pyet,
por përgjigjet pret t’i vijë vetëm në
ëndrra.



LULJETA
LLESHANAKU

poezi të zgjedhura

Onufri

Figura-personazh, boshti i narracionit

Pothuaj në gjithë teorinë, që janë marrë me gjinitë rrëfimore, nocioni i personazhit është lidhur me dy konceptet: *subjekt* dhe *fabul*. Pavarësisht nga termat, nganjëherë të ndryshëm, që kanë përdorur teoricienët, nga antikiteti e deri në teorinë letrare moderne, (G.Genette, Shlomith Rimmon-Kenan dhe Mieke Bal) për të emërtuar këto koncepte, si: *story-histoire-fabula-narration-narrative-text*), nuk kemi të bëjmë thjesht me çështje termash, por me **thelbin e ndërtimit** të veprës dhe rolin që luan personazhi brenda strukturës funksionale të saj. Jo më kot teorinë narratologjike i kushtuan vëmendje të veçantë rolit që ka personazhi në procesin e komplikuar rrëfimitar, sepse boshti organizues i gjithë këtij procesi mbetet pozicioni dhe thelbi përmbajtjesor i tij. Sipas këtyre teorieve¹ personazhi është një 'unitet i integruar' në rrëfim, që përfshin edhe 'unitete të niveleve më të ulëta...', që lejon të ndërtohen konfiguracione semantike të tekstit'. Personazhi, duke qenë në qendër të narratives, është organizues i tekstit, sepse artikulon të gjithë tipat e sekuencës: qofshin këto narrative, deskriptive, dialoguese dhe i jep kuptim këtij artikulimi, duke qenë **njëkohësisht edhe efekt i strukturës** në të cilën 'jeton'. Në termat narratologjikë, personazhi nuk është gjë tjetër përveçse potenciali për histori, për zhvillimin e kohës dhe hapësirës, shkurt për narrativen në vetvete.

Trajtimet e para narratologjike nisën që në veprën *Poetika* të Aristoteli, ku doli në plan të parë koncepti i thurjes së subjektit, brenda të cilit veprojnë karakteret (personazhet). Por, sidomos gjatë shekullit XX përfytyrimi mbi *personazhin* dhe rolin e tij ka përbërë një problem të rëndësishëm të narratologjisë dhe teorisë, si V.Jouve² pohuan se ishte pikërisht narratologjia ajo që ofroi qasjen më interesante për personazhin.

Më parë, deri në prag të trajtimeve teorike të formalistëve rusë, e sidomos të V.Proppit, personazhi shihej më tepër rezultat i organizimit të materialit në një intrigë dhe përfaqësonte, nga njera anë, një mjet për të lidhur në seri motivet, nga ana tjetër një mishërim dhe personifikim të motivimit të lidhjes së tyre. Kjo i referohet, sigurisht në mënyrë të veçantë, gjinisë rrëfimore, në të cilën realizohet një ndërtim specifik i subjektit, përmes pikëvështrimeve dhe niveleve të ndryshëm të thurjes rrëfimore.

Kuptimi i rolit të rrëfimitarisë në ndërtimin e personazhit, ndryshoi, sidomos gjatë shekullit të XX. Kështu, në fillim të këtij shekulli teorisë e Formalizmit Rus i dhanë *sistemit narrativ* një kuptim të ri, funksional, duke e konsideruar personazhin si një komponent thelbësor të tij, mbi të cilin nuk pranohet analiza psikologjike. Në teorinë e mëvonshme, si ajo e Proppit, që u rimor nga Todorov, Greimas, Bremond etj., perceptimi i personazhit lidhet me sferën e *funksionit*, *aksionit*, të rolit si 'aktant' ose 'agjent'. Në këtë linjë kuptimi i personazhit shihet në sfondin e rrëfimit, i lidhur ngushtësisht me ngjarjen: "historitë ekzistojnë vetëm atje ku shfaqen, si *ngjarja* ashtu dhe *ekzistuesit* dhe nuk mund të ketë ngjarje pa ekzistues."³ Më vonë, studimet e strukturalistëve Greimas, Bart etj., thelluan teorinë e studimit mbi të dhe, ndonëse në një farë mënyre secili ka pikëvështrimin e vet, konceptimi i personazhit, brenda procesit të rrëfimit, u mbështet në qasje tjetër. Sipas teorisë së Bartit analiza strukturaliste nuk e përkufizon personazhin në aspektin psikologjik, nuk e sheh atë si

Fragment nga libri i sapobotuar "Figura-personazh që shihet përmes fjalës"

FORMËSIMI 'VIZUAL' BRENDË RRJETËS NARRATIVE

Nga Floresha Dado



një genie, por si pjesëmarrës. Dhe është i saktë vëzhgimi i V.Jouve se, me qasjen strukturaliste u hap rruga për një qasje gjuhësore, që u zhvillua edhe te studimi i Ph.Hamon: 'Për një status semiologjik të personazhit'.⁴ Duke iu referuar analizës semiotike të personazhi, autori e mbështet përkufizimin mbi të sipas tre kategorive: a) personazhe referencialë, b) personazhe që përfshinë lexuesin ose autorin, c) personazhe anafora, që bashkojnë dhe strukturojnë veprën nëpërmjet një sistemi kthimesh dhe kujtimesh.

Jo vetëm trajtimet teorike, por në radhë të parë është tradita e romanit, nga fillimet e rrëfimitarisë klasike deri tek eksperimentet moderniste, dëshmi e ridimensionimit të vazhdueshme të rrëfimitarisë, të shumëllojshmërisë së raporteve midis rrëfimitarit dhe personazhit, të konfigurimeve nga më të ndryshme, të pozicionit dhe rolit që luan ky i fundit në gjithë strukturën rrëfimore. Por, ndërsa romani klasik e zbulon thelbin e karakterit në marrëdhënie dhe kushtëzim nga një kontekst i caktuar, ku mbizotëron kryesisht raporti shkakor dhe kronologjik-kohor, romani modern kapërceu skemat tradicionale, ai shfaqet më refleksiv, ligjërimi organizohet në të njëjtën kohë si refleksion i brendshëm dhe i jashtëm i botës së personazhit.

Koncepti mbi **strukturën narrative** përfshin skema të ndryshme të zhvillimit të personazhit, të motivit që e vë atë në lëvizje, të raporteve që krijojnë me personazhe të tjerë, apo me autorin, apo me lexuesin, etj. Personazhi është niveli më i lartë i organizimit, sepse **lidh sekuencat**, sikurse **edhe përcaktohet prej tyre**. Në këtë nivel

të abstraksionit semioticienët kanë dalluar se personazhet i realizojnë rolet në situata të ndryshme, si: ndeshjen protagonist/antagonist, kërkimin subjekt/objekt, dhënës/marrës, ndihmës/kundërshtar, etj... Raporte të tillë realizojnë aspekte dinamike të rrëfimit.

Një trajtim i tillë narratologjik i personazhit, që e vendos atë në qendër të vëmendjes, krijon një hapësirë të pafund të konceptimit të tij artistik dhe mundësi të shumta të analizës letrare. Personazhi, në njësitë përbërëse të strukturës sipërfaqësore, lidhet në mënyrë të dukshme me ngjarjen, e cila është ndryshim nga një gjendje në një tjetër. Ngjarje të veçanta kombinohen për të krijuar mikro-sekuenca, të cilat bashkërisht krijojnë historinë, apo, më saktë, filozofinë e plotë. P.sh. te *Im atë donte Adolfin*, e *M.Krajës*, përshkrimi i veprimeve të një personazhi vjen nga rrëfimi i një personazhitjetër, i cili gjithashtu rrëfëhet, nuk është i drejtpërdrejtë...

Te *E penguar* e I.Kadaresë, mendimi i personazhit zbulohet në trajtë pavetore nga rrëfimtari, çka e shpëton personazhin prej vështrimit të njëtrajtshëm nga ana e lexuesit, ndez vatra të papritura vështrimi dhe si rrjedhim, përjetimi ngjitet në nivel më emocional. Ndërsa te *Përbindëshi* personazhet i nënshtrohen një narracioni të përzjer (rrëfim dhe dialog në mungesë).

Duhet thënë se, me gjithë format e larmishme të zhvillimit të gjinisë rrëfimore, me gjithë trajtat e zakonshme apo dhe nga më të çuditshmet të formësimit të figurës-personazh, ky është në themel të strukturimit të veprave, pavarësisht nga raportet që ndërtohen midis tij, autorit dhe elementeve të tjera të poetikës së veprës. Prandaj, koncepti mbi *personazhin* mbetet pika kyçe e përpunimit teorik narratologjik, një faktor **i ndikuar nga strukturat e**

pafund rrëfimore, por njëkohësisht **edhe ndikues në to**. Me strukturën dhe thelbin e brendshëm kuptimor të tij, ai 'prodhohet' por bëhet edhe shenjues i rëndësishëm, sepse nxit, kërkon të krijohen lloje të ndryshme të trajtave rrëfimore, duke qenë **faktor lëvizës**, që nxit hapësira dhe mundësi të pafund të një procesi të pandalshëm zhvillimi.

Kuptimi gjatë procesit narrativ

Në ç'drejtim duhet hetuar kuptimi i personazhit brenda strukturës së një rrëfimi? Kjo është çështja e parë që është shtruar nga teoricienët e narratologjisë. Një ndër propozimet (M.Bal) është që ky vëzhgim të bëhet në 'pasqyrimin e serisë së ngjarjeve', që do të thotë se rrëfimi zbërthehet në ngjarje, të cilat mund të studiohen sipas pozicionit të tyre në raport me njeri tjetrin. Kështu ndodh, për shembull, në romanin *Goja e botës* e Z.Çelë, ku rrëfimi përbëhet nga një numër pjesësh që ndjekin njëra-tjetrën: ai ka një strukturë gjatësore të kohës dhe veprimit. Ky këndvështrimin 'horizontal', që ka të bëjë me rrjedhën e një 'seri ngjarjesh' (aksi *sintagmatik*), nuk mund të jetë i mjaftueshëm për të njohur personazhin, prandaj del në plan të parë pasqyrimi i serisë së ngjarjeve, por në prerje vertikale, ku analiza kalon nga *shenja te domethënia* e personazhit. Pra, qasja ndaj figurës-personazh mund të bëhet sipas parimesh që e realizojnë analizën narrative në mënyra të ndryshme, ose **horizontalisht**, ose **vertikalisht**, ose **sipas të dy qëndrimeve**. Fakti që struktura narrative e veprës letrare është krejt e ndryshme nga strukturat që organizojnë llojet e rrëfimit historik, biografik, publicistik etj., nxjerr në plan të parë rëndësinë e njohjes së specifikave të brendshme të saj, të parimeve strukturale që kanë formësuar romanin, në rrjedhat e zhvillimit historik të tij. Në prozën tonë këto parime janë shpesh të ndryshëm midis formave klasike, ku struktura narrative ngrihet si një sekuencë e ngjarjeve (një pjesë e mirë e romaneve të letërsisë sonë) dhe prozës moderne (sidomos postmoderniste), ku braktiset rendi, synohet mohimi i mbylljes së strukturës dhe realizimit të një kuptimi të qartë. Vepra të tilla, që nuk i referohen një referenti real ka disa.

Proza jonë, sidomos e para viteve '70, ngrihet mbi strukturën tradicionale, me një rrëfim që zhvillohet përmes fazash të qarta të konfliktit dhe krizave të personazhit. Por ndikimi i prozës moderne, ku mbizotëroi koncepti se rrëfimi nuk mund të jetë një integritet struktural nga fillimi në fund, solli eksperimentime. Synimi drejt një fundi 'të hapur' (term i përdorur nga Wallace Martin...) i dha një formësim të ri personazhit, i cili brenda strukturës narrative shfaq një fizionomi me referencë të pa qartë, apo trajtë jo normale. (Kjo ndodh në romanet postmoderniste të viteve të fundit).

Meqenëse formësimi i figurës-personazh realizohet në kompleks ngjarjesh, pavarësisht rendit të lidhjes midis tyre, bota e brendshme e tij dhe marrëdhëniet reciproke me personazhë të tjerë marrin kuptim pikërisht prej thelbit të ngjarjeve, gjithnjë si një proces. Proces i është ndryshim, zhvillim dhe parakupton një vazhdimësi kohore... Kur personazhi lidhet me një ngjarje kyçe, ze vend në një hapësirë të kohës në të cilën ngjarjet kanë qenë ngjeshur, në një moment të shkurtër të kohës jeta e personazhit merr një kthesë vendimtare. Shembujt janë të shumtë, si në romanet e Kadaresë, Kongolit, Tufës etj. ku është e qartë se rrëfimtaria e tyre është një proces, por, njëkohësisht, brenda romaneve edhe çdo ngjarje është në vetvete një proces, pjesë e një procesi më tërësor dhe kompleks. Brenda këtij procesi ('Dimri

1.Tomas Dochery: *Postmodernism, A Reader*, Columbia University Press, 1992.

2.V.Jouve: *L'effet - personazhe dans le roman*, PUF, Paris, 1992

3.V.Jouve, *po aty*

4.Philippe Hamon, në: R.Barthes, L.Bersani, Ph.Hamon, M. Rifaterre, J.Watt: *Littérature et Réalité*, Edition du Seuil, 1982.

i madh, ‘Nata është dita jonë’ e R.Qosjes, ‘Ngjizja e papërlyme’ e A.Tufës, etj.) një sistem personazhesh bashkëjetojnë, kundërvihen...në pozicione të ndryshme, duke u formësuar dhe, njëherazi, duke konkretizuar ciklet narrative në strukturën e rrëfimitarisë tërësore, e përbërë nga **struktura e brendshme** e veprës letrare, e cila, në sajë të vetisë së shumëkuptimësisë së fjalës, mund të shfaqet përmes formave të ndryshme të **strukturave sipërfaqësore**. Në strukturën narrative të këtyre romaneve, dhe të tjerë, duket se në plan të parë është struktura sipërfaqësore, që ka të bëjë me vazhdimësinë e aksioneve, ose dimensionin sintagmatik, por, që në fakt, i përgjigjet strukturës së thellë, që ka të bëjë me filozofinë e veprës, (terma të përdorur nga M. Wallace). Në dy nivelet vepron personazhi, në qendër të çdo rrëfimi është një *aksion* dhe një *realizues* i këtij aksioni. Në këtë kuptim personazhi është pjesa e domosdoshme e strukturave narrative, sepse është mbështetës i funksioneve narrative dhe njëkohësisht është i kushtëzuar nga vendi që ze në strukturën vepruese të rrëfimit. Duke qenë se të rrëfyerit është një fenomen kompleks, shumë i gjerë, i larmishëm, pozicioni dhe roli i personazhit në të mund t`u nënshtrohet pikëvështrimeve nga më të ndryshmet: historike, antropologjike, psikologjike, hermeneutike, strukturalise e semiotike, ideologjike etj.

Në teoritë moderne pozicioni i personazhit në narracion u trajtua në mënyra të ndryshme. Për shembull F.K.Stanzel⁵ propozon një tipologji të situatave narrative, mbështetur në tre elementë - *personi*, *perspektiva dhe mënyra*. Teoricieni dallon disa nivele të bashkëveprimit të rrëfimitarit me personazhin: situatën narrative *autoriale*, në të cilën narratori rri pezull mbi historinë; situatën narrative *në vetën e parë*, në të cilën uni-figurë merr fjalën; dhe situatën *narrative figurale*, në të cilën narratori duket sikur zhduket me qëllim që të gjejë shkak për t`u përqendruar në vetëdijen e personazhit. Sipas teoricienit, këto tre situata ndiqen në tre shkallëzime, që paraqesin secila një zhvillim gradual të personazhit. Shkalla e parë, **shkallëzimi person**, evoluon nga identiteti te jo-identiteti. (siç ndodh në romanin ‘OH’ të A.Pashkut). Nëse narratori dhe personazhi përputhen, kemi një *unë-narrative*, mënyrë e shumëpërdorur te disa romancierë (M.Kraja, R.Dibra,...); nëse nuk përputhen kemi një *ai-* ose *ajo-* narrative. (R.Qosja...)

Shkallëzimi i dytë i Stanzel ka të bëjë me **perspektivën**, që përfshin të gjitha mënyrat e qasjes së brendshme dhe të jashtme. Më parë lexuesi i sheh ngjarjet përmes syve të një personazhi, më pas përmes syve të një agjenti, i cili qëndron mbi botën fikzionale, p.sh. një narrator autorial.

Shkallëzimi i tretë është ai i **mënyrës**, me të cilën teoricieni ka parasysh mënyrën ku narratori del në plan të parë. Ky shkallëzim rrëshqet nga poli i personazhit-tregues, ku narratori është qartësisht i pranishëm, tek përballja e tij, ku visibiliteti shkon në zero. Kjo ndodh kur ndeshim një personazh, mendja e të cilit percepton ngjarjet dhe i përcjell lexuesit përshtypjen e tij.

Praktika rrëfimtare e shumë romaneve na tregon se zhvillimi i personazhit, mund të ndiqet brenda:

1. Situatës *narrative në vetën e parë*, ku mbizotëron kryesisht ngjashmëria midis narratorit dhe personazhit, i cili është subjekt i narratives.

2. Situatës *narrative autoriale*, ku del në pah prania e qartë e narratorit dhe pamja e brendshme, përderisa shihet çdo gjë përmes syve të një figure që shfaqet në proces. (‘*Liria ime*’), ku pyetjet, për atë çka përjetuar personazhi, sikur janë midis mendimeve të

5. F.K. Stanzel: *Narrative Situations in the Novel*, Indiana University Press, 1971

tij dhe shprehjes së rrëfimitarit, dhe procesi duket si i ndërmjetëm. Apo dhe pyetje që vinë në emër të një personazhi tjetër, por në thelb janë imagjinatë e personazhit kryesor.

3. Situatës *narrative figurale*, e cila ka si konceptim themelor të personazhit praninë e tij më tepër si reflektues se sa të një personazhi-tregonjës. Narratori duket sikur është zhdukur, kështu që çdo gjë bëhet e vlefshme përmes reflektuesit. Kjo do të thotë që pamja është e brendshme, ajo që ndodh tregohet në vetën e tretë.

Te ‘*Ngjizja e papërlyme*’ mbizotëron rrëfimi në vetë të parë. Janë kolazh personazhesh që rrëfejnë situatat, dramat e brendshme dhe të jashtme, raportet midis tyre... (Parimi i vetëzbulimit). Duket sikur nuk ka rrëfimtari, ose që shfaqet rrallë dhe zhduket për t`ia lënë vendin rrëfimit të brendshëm të personazhit. Ky parim, shpesh, duket si mbizotërues. Ka raste kur rrëfimtari i drejtohet personazhit, duke i kujtuar një bisedë të tij me një personazh tjetër... Një dialog që rrëfhet...

Ndodh në vepra të tjera unifikimi i personazhit TI me personazhin rrëfimtari... (‘*Gruaja që deshe*’ e R.Dibrës). Personazhi është “TI-ja”, i paidentifikuar hollësisht në pamje të jashtme, ku realizohet shkrimi midis rrëfimarit-autor dhe TI-së, në një personazh të vetëm.

Ndërsa sipas Luc Herman⁶ personazhi shihet në raportin ‘perceptim dhe të folurit’. Nëse një personazh kujton diçka, ai bëhet automatikisht narrator i këtij kujtimi? Ose, a mund të themi se është një narrator i gjithëdijshëm që paraqet kujtimet e një personazhinë formën e psiko-narracionit harmonik (që përputhet)? Në këtë rast personazhi është agjent që ‘shihet’, ndërkohë që narratori mbetet i detyruar të dëgjojë perceptimet e tij. (‘*Kronikë në gur*’).

Te ‘*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*’, në

6 Luc Herman & Bart Vervaeck: *Handbook of Narrative Analysis*, University of Nebraska Press, 2005

dallim nga rrëfimet e zakonshme në vetën e parë, rrëfimtari nuk zbulon thjesht mendimet apo ngjarje të përjetuara më parë, por rrëfen lëvizjet e tyre. Pra, ndonëse shfrytëzohet rrëfimi i brendshëm, ai është tepër aktiv, e zbulon personazhin në dinamikën e ndjenjave dhe veprimeve të tij. Ndërkallet rrëfimi i shkurtër i një personi të paidentifikuar, që ndërpret rrëfimin e autorit mbi rrjedhën e ngjarjeve dhe veprimeve të personazheve. Përzierja e dy rrëfimtarëve shkrin dy kohë, dy veprime, që kanë të përbashkët qëllimin. Në raste të tilla rrëfimi nuk ka si synim të prezantojë një rrëfimtari konkret, por të krijojë paralelizma ideore, t`i japë **një theks të mprehtë personazhit kryesor**, nëntekstit të një veprimi të caktuar. Po kështu, edhe më tej, shfaqet rrëfimi i një të panjohuri, që s`ka si qëllim të tregojë ndonjë ngjarje a veprim, por të shprehë një gjendje emocionale të veçantë, e cila, së brendshmi, krijon një kundërvënie, rrënim moral, dështim gradual të misionit të personazhit (gjeneralit). Ky rrëfimtari-anonim vjen për ta ngacmuar më tej **botën e trazuar të personazhit**, ai sikur do t`i ndjellë diçka ogurzezë misionit të tij.

Herë herë rrëfimtari shfaqet për ta ndihmuar personazhin në kërkimet e tij. Zëri vjen si nga larg, tingëllon një çast të shkurtër dhe fiket përsëri, për t`ia lënë, si gjithnjë, fjalën rrëfimitarit-autor. Këtë rrëfim shumëzërash Kadareja e krijon me mjeshtëri, kur kori i rrëfimtarëve përbëhet jo vetëm nga dy ose tre personazhe, që ecin me ngjarjet..., por edhe nga rrëfimi i hijes së një personazhi të dikurshëm, të varrë, që nëpërmjet ditarit të tij sjell skena nga e kaluara. Ky alternim rrëfimesh në fazën e parë krijon shqetësim të personazhit kryesor dhe, nëpërmjet dridhjes shpirtërore që përjeton, i jep një tingëllim të fuqishëm fundit tragjik. Mund të ndodhë që kufijtë midis autorit dhe personazhit të përzihen

dhe, si rrjedhim, të mos dalë qartë se cili prej tyre është bartësi i rrëfimit.

Një lloj rrëfimi **pavetor** përsëritet disa herë (‘*Koncert në fund të stinës*’) në kokën e Gjergjit që fluturon me avion; shkrimja e vetës së parë me vetën e tretë i përgjigjet dyshimit të personazhit mbi vrasjen e Lin Biaos, një dyshim që shtrihet kudo, që s`prekej, por që megjithatë lëvizte në të katër anët. Vërshojnë rrëfimet e disa personazheve në formë autokritike, të cilat së bashku, formojnë një rrëfim polifonik. Në çaste të caktuara të zhvillimit të rrëfimit kombinohen dy pozicione: **rrëfimtari personazh rrëfen ç`ka ndodhur**, pastaj, papritur, ky rrëfim ndërpritet dhe shfaqet **rrëfimtari autor, i cili vazhdon fjalën e personazhit**, rrëfen më tej për vazhdimin e ngjarjeve. Më pas gërshetimi i rrëfimeve vijon me një origjinalitet të veçantë: krijohen dy rrëfime, prej të cilëve njëri ndjek veprimet konkrete të personazheve, ndërsa tjetri merr një karakter më të përgjithshëm, shtrihet në përmasat e një sfondi të gjerë historik-shoqëror. Gjithashtu, zërat rrëfimtari mund të mos i nënshtrohen njëri-tjetrit, por të tingëllojnë të barabartë. Formësohet, pra, një vepër **polifonike**, me harmonizimin e disa zërave të pavarur, të cilët janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në ngjarjet që rrëfehen. Tek ‘*Kronikë në gur*’ rrëfimi shumështrësor krijohet në dy mënyra : nëpërmjet ndërthurjes së zërit të personazhit rrëfimtari me zëra të personazheve të paidentifikuar dhe nëpërmjet një lloj bisedimi me vetveten, që nxitet nga një lëvizje e brendshme e botës së heroit.

Kombinimi i zërave të personazhit që rrëfen ngjarjet (Demkës) dhe, në çaste të caktuara, të vetë heroit kryesor (Zylos) te ‘*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo*’ të D.Agollit, krijon fizionominë e brendshme të personazhit, mendimet e të cilit kanë, në thelb, një karakter të fshehtë, kontradiktor; ndonëse duket sikur rrëfimtari kryesor e simpatizon heroin e vet, ka një mospërputhje të brendshme, e cila bëhet shkak për karakterin komik të heroit. Gjithashtu, në roman bëhet më i theksuar karakteri polifonik i rrëfimit atëherë kur, krahas rrëfimitarit-personazh, vërshojnë copëza rrëfimesh të personazheve të tjera. Një pjesë janë te paidentifikuara, shfaqen në formën e pohimeve nga më të çuditshmet. Ndërtimi i një rrëfimi të tillë shumëzërash vjen në pikën kulminante të zhvillimit të veprimeve dhe përforcon në mënyrë origjinale, me tingëllimin e një kori të paharmonizuar, thelbin komik të personazhit kryesor. Pra, rrëfimi i gjithë romanit ndërlikohet përmes disa zërave, është zëri kryesor, më tingullgjatë i personazhit (Demkë), që duket sikur është i pavarur nga autori, janë edhe zërat e heroit kryesor, të personazheve të tjerë të dorës së dytë, zëra fare të panjohur, që kanë një farë pavarësie në rrëfimin e përgjithshëm.

Te ‘*Njeriu me top*’ ka momente që papritur rrëfimi merr trajtën, apo intonacionin e legjendës. Cili e rrëfen këtë legjendë? Është autori apo personazhi? Shfaqet një rrëfim i veçantë, me shkronja korsive, që sikur ndahet nga rrëfimi i përgjithshëm, për të shprehur në mënyrë të figurshme rolin dhe pushtetin e paragjykimëve të vjetra në botën shpirtërore të njerëzve, pra dhe të Matos.

Rrëfimtari **nuk tregon, por zbulon thelbin e personazhit**: Te ‘*Nëntori i një kryeqyteti*’ rrëfimtari ndjek nga pas personazhin, mendimet e tij të brendshme, duke i zbuluar lexuesit lëvizjet e padukshme në hallkat e të menduarit të këtij ose atij personazhi (Adrian Guma).

Pa u ndalur në raste të tjera të konceptimit të rrëfimit, në funksion të formësimit dhe **zbulimit të thelbit të personazhit**, mund të themi se teknikat e strukturë narrative janë pafund, origjinale te çdo autor.

FLORESHA DADO

Figura-Personazh që ‘shihet’ përmes fjalës

Onufri



Romantizmi shqiptar si një rrymë letare e Rcila u zhvillua në gjysmën e dytë të shek XIX-të, kish të vecoritë e saj të përbashkëta me romantizmin Evropian por edhe specifikat e saj. Kjo rrymë e fuqishme gjallëroi dhe zhvilloi të gjitha gjinitë dhe llojet letrare, e ndër to edhe elegjinë, e cila pavarësisht nga shkrimi letrar, në jetën shqiptare kishte ardhur shumë më herët, që në trashëgiminë gojore të hershme. Elegjia në romantizmin shqiptar mori një formë letrare më të plotë, mbase duke dalë edhe nga konotacioni i vjetër e duke u përshatur në kohë me nuanca dhe forma të reja, por thelbi mbeti po i tillë, vajtimi i njeriut të dashur. Në një këndshikimit të poezisë së romantizmit si e një natyre të dhimbjes njerëzore, koncentrojmë idenë se në një pjesë të konsiderueshme të lirikës romantike mbizotëron trishtimi, dhimbja, vetmia të cilat dalin si dominante dhe si e tillë kjo poezi del edhe në formatin elegjiak.

Fjala elegji vjen nga fjala greke elegela-këngë zije që do të thotë përshkrimi i vdekjes. Poezia elegjiake jep një përjetim të dhimbshëm, të trishtueshëm, të përvajshëm për njeriun e humbur ose për ndjesi të tilla si malli, vuajtja larg në mërgim etj. Elegjia është forma më e vjetër e ndërtuar me vargje ekzametër dhe pentametër. Pas Simonidhit kjo poezi u quajt poezi e vajtimeve. Poeti më i njohur elegjiak ishte Tirteu nga Atika (në vitet 685 deri në 668 para.e.r.), i cili mori pjesë në ushtrinë spartane. Tirteu njihet si krijues i elegjive plot pathos, poezi me ritëm marshues dhe nga ai na kanë arritur vetëm tri elegji. Më pas vjen Mimnermi nga Kolofoni në vitin 638 para.e.r. ai ka lëvruar poezi me ndjenja të brishta. Nga ai kanë arritur vetëm disa fragmente. Gjithashtu përmendim dhe Solonin nga Athina, nga i cili kemi pak elegji, kryesisht patriotike dhe politike. Ndërsa në Romë elegjia erdhi nga Parthenios, skllav grek. Më pas e zhvilloi Katuli i cili i dha frymën romake. Në folklorin shqiptar si forma më e vjetër e letërsisë gojore, elegjinë e gjejmë në të gjitha zonat folklorike. Në folklorin tonë këto këngë quhen edhe këngët e vajit, ndër të cilat përmendim si më të hershme në krijimtarinë gojore, “Gjama e burrave” ose fenomenin e Vajtocave të cilat thirreshin në vdekje për të vajtuar. Vajtimi është përshkrimi që i bëhet një të vdekuri duke vënë në pah vecoritë e tij fizike. Në këto këngë fryma elegjiake e dhimbjes së thellë bashkohet më vënien në dukje të cilësive të larta morale. Psh Zemërplasta nanë për ty / oj lulja e ballit tem... Vajtimi ka një ndryshim nga elegjia, në vajtim ka një dhembje më personale, ai është më i drejtpërdrejtë, mbetet më i fshehtë, ndërsa elegjia është një shprehje e vajtit në mënyrë më të hapur.

Profesor Rexhep Qosja thekson: “Elegji shkruajnë gati të gjithë romantikët sepse të gjithë kanë arësye të mjafta, objektive dhe subjektive, shoqërore dhe intime, që zëri i tyre të jetë edhe elegjiak”. Por ndër modelet më të arrira të përdorimit të elegjisë në poezinë shqipe janë dy poetët e mirëfilltë romantikë, Naim Frashëri, i vlerësuar si romantiku më përfaqësues i romantizmit shqiptar, dhe Zef Serembe i vlerësuar si lirik origjinal me këndvështrim romantik evropian.

Nga një këndvështrim analitik i poetikës së dy poetëve do të ndalemi në disa koncepte bazë të elegjisë që karakterizojnë vargjet e tyre. Tek të dy këto poetë identifikojmë koncepte të tilla si: vetmia, malli, dhimbja, distanca, loti, trishtimi, vajtimi, pikëllimi, fataliteti, tragjizmi, endrra, dëshpërimi dhënë të gjitha këto më një frymë elegjiake. Po të gjykojmë shohim se vetmia, malli dhe distanca janë po aq sa shkaktarë njerëzorë aq edhe shpirtërorë. Të treja këto kanë pasoja ndjesish që në poetikë vijnë me një shprehje përmes dhimbjes, lotit, tragjikes, pikëllimit me një formë vajtuese tipike për elegjinë në të cilën të dy këta poetë shpërfaqën talentin e tyre si krijues.

Vetmia

Profesor Sabri Hamiti në veprën e tij “Letërsia filobiblike, letërsia romantike” citon se “vetmia shfaqet në dimensionet e veta tek

Poezia elegjiake në një vështrim krahasues midis Naim Frashërit dhe Zef Serembes.

Nga Dhurata Kasa

Serembe, si vetmi romantike, personale dhe kolektive”. Vetmia tek Serembe është shkaku i të gjithë nuancave elegjiake të shprehura në vargje, është shkaku i mallit, dhimbjes, mërziisë etj. Serembe e shfaq hapur dëshirën të largohet nga bota njerëzore, të rrijë në vetminë e tij duke iu shmangur në këtë rast “të ligave” të shoqërisë por edhe vetes së vet, e duke u transformuar në një un vetmitar universal i cili është i dërrmuar nga jeta tokësore. Ndaj ai kërkon një lartësi qiellore, pavarësisht se edhe atje ai është vetmitar

Edhe prof Ali Xhiku e thekson këtë largim nga shoqëria duke shkruar më tej “Ngaqë s’është i aftë të kuptojë shoqërinë heroit i Serembes parapëlqen më mirë t’i largohet, të jetojë jashtë saj, vetëm me dashurinë”. Por a i mjaftoi kjo Serembes? Jo! Vetmia e tij e bën atë një vetmitar të përhershëm edhe ndaj dasshurisë, kështu heroit lirik në këtë rast shndërrohet në një këngëtar elegjiak për fatin e dashurisë së tij të humbur. Heroi në vargjet e Serembes është një i humbur i madh i dashurisë, ndaj ai e vajton vetëm dhe i vetëm këtë. Humbja e dashurisë është humbja më e madhe, ngushëllimi i së cilës vjen i plotë vetëm nëpërmjet vajtit vetmitar. Vetminë e tij e bën më të madhe pikërisht vetë konceptimi që bën Serembe duke vënë përballë vetës dritën dhe dritësinë e vashës. Kjo e dërrmon dhe e vetmon më shumë. Tashmë ai e ka humbur atë. Heroi i Serembes është në një vetmi tragjike edhe për faktin se nuk ka të afërm në vende të largëta, ose edhe në vendin e tij ata iu larguan atij nga vdekjet e parakohëshme të cilat ai i përjetoi shumë. Ali Xhiku konstaton se “Gjithnjë i vetëm” mbetet heroit i Serembes. Kjo shkon përputhshmërisht me biografinë e vetë poetit deri në fund të jetës, në këtë rast heroit dhe poetit janë një. I braktisur vdiq edhe Serembe në mes të shëshit të Sao Paolos në Brazil. Ndaj konkludojmë se vetmia e Serembes ishte vrastare për të dhe e përhershme në vargun e tij, ajo e shtonte më

shumë trishtimin e thellë duke e theksuar edhe më shumë shpirtin e tij vetmitar.

E ndërsa kjo vetmi tek Serembe është gjithëpërfshirëse tek Naimi qëndron vetëm në momente të caktuara për shkak të aktivitetit të tij më të plotë si në jetën profesionale, shoqërore intelektuale. Por pikërisht në këto caste Naimi ka ditur ta përkthejë këtë vetmi në mënyrë mjeshtërore poetikisht. Ndaj elegjitë e tij janë tipike vajtime për njerëzit e dashur që nga vajtimi për bijën, për motrën, për vëllezërit. Vetmia e ngërthen herë herë por në ndryshim nga Serembe nuk e pushton në vazhdimësi. Interesante janë titujt e këtij cikli tek Naimi, të gjitha fillojnë me ...Mbi varrin....që do të thotë se poeti vetëm grafiksht mbi epitafet e varreve e ka shkëputjen nga të dashurit e tij dhe kuptimisht lidhja është e përhershme brenda kësaj vetmie shpirtërore. Vajtimi i Naimit e ka thelbin tek vetmia shpirtërore e tij e cila herë herë e ngërthen si një të mbetur të vetëm në gen në këtë botë, i rrethuar me kaq shumë të vdekur të dashur. Pra kemi një vetmi që riciklohet vdekje pas vdekjes, patjetër që kjo ka pasojat e njëpasnjëshme të cilat zënë hapësirën qëndrore në vargjet e poetit si dhimbjen, humbjen e identitetit familjar ose zvogelimin e ekzistencës familjare, ndaj ai vajton bindshëm . Këtu na shfaqet Naimi personal. Profesor Sabri Hamiti thekson: “Të gjitha lirikatat personale të tij janë elegjiake”. Ndaj vetmia rikthehet si një ritëm thellësisht i brendshëm për Naimin që del në sipërfaqe në cdo elegji, pas cdo kohe që ndodh fatkeqësia. Në këtë rast vetmia e tij shndërrohet në mjerim. Studiuesi Robert Ellse do ta përforcojë më tej natyrën e lirikës së Serembes: “ Vargu i Serembes i pikëlluar, i trishtuar nga karakteriAi ishte një poet i ndjenjës, e sidomos i vetmisë e zhgënjimit”.

Dhimbja

E ndërsa vetmia është aureola brendia e saj ndërthur në mënyrë pulsante shumë




ndjesi të qënies, sidomos mbi të gjitha ngrihet dhimbja. Dhimbja është thelbi i vajit, humbjes, ngashërimit, mërziisë, pikëllimit. Ndaj ajo del herë e butë si tek Serembe, herë e fuqishme si tek Naimi. Nëse shohim në retrospektivë jetësore Serembe humbi dajën, të dashurën, prindërit dhe veten, ndërsa Naimi akoma më shumë, vajzën, gruan, motrën, vëllezërit por qëndroi më i fortë në vete sepse ai mbi fenomenin e vdekjes të cilën e provoi në shumë forma u ngrit duke filozofuar për një shpirt të mëpasëm (këtu përmendim një grup poezish mbi të cilën Naim Frashëri filozofon mbi vdekjen si psh “ Të vdekurit” etj). Edhe prof Rexhep Qosja tek vepra monografike “Porosia e Madhe” e thekson: “ Naim Frashëri e kalon dhimbjen personale nga elegjia në forma të tjera ngadhënjyese”. Shkaqet që sjellin vuajtjet e njeriut sipas pikpamjeve të Naim Frashërit janë të ndryshme. Në këtë rast dhimbja është e pamatshme por e ardhur tek të dy autorët me të gjitha nuancat njerëzore.

Tek Serembe dhimbja është tragjike dhe del në forma të ndryshme. Serembe nëpërmjet heroit lirik shpreh dhimbjen e vet si një vuajtje që është bërë bashkëudhëtare me të. Elgjia vetanake e tij ia nxjerr më shumë në pah këtë dhimbje. I vuajtur prej largësisë kohore, prej mohimit të dashurisë, prej humbjes së saj dhe njerëzve Serembe u shpërfaq sinqerisht në vargjet e tij duke zhbiruar në labirintin e shpirtit të vet të gjitha nuancat e dhimbjes, që nga mërmërima e lehtë e deri tek ofshama lotuese. Ka një vecanti vargu i Serembes sic e thekson edhe prof Sabri Hamiti: “Dashuria shijohet në lirikat e tij përmes dhembjesh e psherëtimash”. Kjo na bën të konludojmë se trajtimi i dashurisë me një dhembje kaq përfshirëse dhe që shijohet në një pjesë të madhe të poezive të tij elegjiake ose jo, është një vlerë e padiskutueshme, meritën e së cilës e ka arti i Serembes. Ai tek dashuria e tij platonike e materializoi dhimbjen e vet përmes përpjekjes reale, ndaj ajo prapë është e bukur. Dhimbja për humbjen e vashës u trupëzua me jetën e Serembes dhe si rezultat në cdo varg ajo ndihet në nuance të ndryshme, edhe nëpërmjet përndritjes së përshkrimit fizik të përfytyruar

Vëm re tëk vargjet e poetit një triptik nuancash të dhimbjes si psherëtim, helmimi, thërmimi i tij deri në shndërrim. Edhe prof Sabri Hamiti thekson se tek Serembe “Helmi është shkalla më e lartë e dhembjes dhe ndëshkimit jetësor, filli i fatkeqësisë dhe kulmi i saj”. Ndaj poeti psherëtin këtë vetëhelim deri në kulm të cilin e ushqeu në kohë pas përpjekjes të dështuara duke mos i dhënë vetes hapësira për gëzime të tjera. Dëshira për dashuri të mëdha, iluzionet platonike, rënkimet për të dashurën e vetëhelmojnë gradualisht heroin serembjan.

Të njëjtën teknikë të paralelizmit të gjendjeve kemi edhe tek Naim Frashëri por më e dukshme dhe më konkrete. Naimi e fillon gjithmonë me natyrën. Në të gjitha vjershat jetëshkrimore të tij që i përkasin fazes së parë të krijimtarisë natyra ka një ravijëzim dukshëm të dhimbshëm sa dhe ndjenja që provon poeti. Dhimbja e poetit shtrihet mbi një shëmtim të natyrës larg shijimit të saj, ajo tashmë është thjesht një objekt i rastësishëm për poetin. Kopshiti,



dheu, lulja, zogu bilbilat, trëndafili, tani janë tjetër, e kanë humbur funksionin e tyre jetëdhënës duke u shndërruar në jetëmarrës si simbol i të vdekurve të cilat poeti i akuzon:

Dhimbja elegjiake tek Naim Frashëri është një model romantik më i gjërë se tek Serembe, kjo për shkak të krijimeve më të shumta dhe më të qarta të vjershave elegjiake që sic e theksuam më lart I përkasin fazës së parë. Rexhep Qosja koncepton se: “Dhimbja e Naimit është, vërtet, subjective, por ka të gjitha kushtet, shkaqet shoqërore e psikologjike të jetë dhimbje e sinqertë e kurrësesi pozë”. (Naim Frashëri Vep I) Simboli kryesor i poezisë elegjiake jo vetëm naimjane por në tërë letërsinë shqipe mbeten poezitë mbi humbjen e vajzave, motrave dhe vëllezërve të cilat vërtetojnë konceptin e Qoses se janë krijime të sinqerta personale. Ajo që bie në sy në këtë grup vjershash është trajtimi i vuajtjes si një dhimbje e pathënë , e pa shpjegueshme por e pranueshme. Ndaj mënyra e vetme për ta shprehur atë është vaji, një model tipik popullor. Por kjo dhimbje është kaq e madhe saqë poeti kalon në dilema filozofike.

Dhimbja për Naimin është një pjesë ekzistenciale e dashurisë ndaj e trajton si të tillë edhe tek poemthi “Bukuria”. Nuk mund të ketë hyjnizim pa anën tjetër, sakrificën, dhimbjen me të cilën arrihet ky hyjnizim. Në këngët e fundit të poemthit “Bukurija” jepet një tablo e plotë e dhimbjes, një këndim elegjiak për ikjen, dhimbje për tretjen e shpirtit me peisazhin dimëror në këngën e 15-të, ku zemra e autorit zien, bie, tretet. Vetëm se duhet të dallojmë se në këtë poemth Naimi nuk transmeton një dhimbje të butë, tragjike por ai kelthet në mënyrë vetërrëfyese, njerëzore dhe poetike edhe kur dhimbja e tij ka nuancë tjetër vajtuese.

Një përbashkim i pa emërtuar i zizë personale me atë të përgjithshme na jep një dhimbje vetëngushëlluese në poezinë “Një lul’ e vishkurë, a një vashëz’ e vdekurë”. Sic e thekson edhe Sabri Hamiti : “ Në këtë poezi vdekja bëhet fakt, realitet Por ka një diskordancë këtu, sado Naimi kërkon gjithësi për konceptin universal të vdekjes prapë ai mbytet nga dhimbja personale. Pra është dhimbja ajo që nuk e lë poetin të dalë mbi veten. Kjo dhimbje tek Naimi është një kurbë e lëvizshme në të cilën poeti herë ngrihet në sipërfaqe , në gurë e drurë herë bie në thellësi të shpirtit të përvuajtur, kaq e madhe dhe e pabesë është dhimbja e tij. Një dhimbje që u universalizua si rezultat i përmasave të mëdha që mori dhimbja individuale duke qënë se Naimi e provoi mbi vete disa herë ndryshimin e qënies së vet prej kësaj dhimbje. Ndaj ai shpërthen nëpërmjet dhimbjes filozofike:

Ëndrra

Serembe ndjen dhimbje jo vetëm kur kujton por sidomos kur ëndërron. Vasha për heroin e Serembes ishte hidhërimi, vaji, dhimbja tokësore dhe mbeti vec gazi i tij në ëndërr. Ëndrra për heroin është një paraprijëse për veprim në të cilin Serembe u mundua të mundë kohën, ta gënjejë atë, të shpresojë për një shmangie nga fati. Kaq mund t’I jepte ëndrra. Por jeta si thelbi i kohës e la vec një shtegëtar të zhgënjyer dhe një ëndërrimtar universal. Jeta e poetit kaloi duke shtegëtuar dhe ëndërruar sic shprehet ai në fillim të “ Elegjisë”. Ëndrra në fakt tek Serembe është bipolare , aq sa është burimi i të gjithë fatkeqësisë së tij erotike aq është edhe poli i kundërt i mbarimit pasi poeti e ka atë frymë për mos harresë, ai frymon përmes përfytyrimit të saj. Ëndrra qëndron si një kufi mess ë kaluarës, kujtimeve ngazëllyese dhe të sotmes dëshpëruese. Ëndrra në ndjesinë e Serembes është një far që here ndricon dhe para saj kalon magjia e ëndërruar e përjetimit platonik e here shuhet dhe bëhet barricade që ndan dy botët, jetën dhe nëntokën. Ndaj është i vecantë Serembe se e shikon ëndrrën si fuqi sa fuqিদhënëse aq edhe mjeruese sepse ka dy realitete të saj , dëshira për të qënë dhe pamundësia. Duke e quajtur dashurinë e Serembes “Të perënduar që në lindje”

professor Sabri Hamiti thekson se përmes ëndërrimesh të së nesërme e përmes asaj që shkeli në jetë, poeti e kuptoi fytyrën e hidhur dhe të ëmbël të kësaj bote. Të ëmblën e pati vetëm në ëndërrimet e veta, këtë të dytën në faqet e jetës”.

E ndersa tek Naim Frashëri vërejmë një oksimoron te fenomenit të ëndrrës me elegjinë. Pikërisht poezitë elegjiake të Naimit i përkasin përmbledhjes poetike me titull “ Ëndërrimet”. Një titull që nuk ka lidhje me poezinë elegjiake të tij por që na intrigon të vëzhgojmë brenda këtyre vargjeve për te parë se a shtresëzohet diku ky concept si tek Serembe? Në vargjet e tij elegjiake Naimi nuk lë vend për konceptin e ëndrrës sic bën Serembe, porn në një nëntekst të lexuar më thellë kuptojmë se jeta e të vdekurve të tij të dashur mbeti një ëndërr. Koncepti i ëndrrës tek Naimi mbetet një dëshirë e pashpërehur si ëndërr por e nënkuptuar, një ëndërr që mbeti thellë brenda shpirtit të tij.

Malli

Malli tek Serembe është një largësi vetmitare e cila nëpërmjet dhimbjes së vetvetes krijon një aureolë nostalgjike të fajshme. Pra malli tek Serembe është shkak i pikëllimit dhe melankolisë në atë këndshikim të trajtimit të vargut elgjia si produkt jetësor. Profesor Sabri Hamiti thekson se: “ Serembe është liriku i parë i madh i letërsisë shqipe që e identifikoi poezinë me lirikën si këngë të mallit, duke e përforcuar teorinë për lirikën si gjini personale.....”. Një mall ky që u bë primar në tërë hapësirën krijuese duke nisur si një imazh natyror shpresëdhënës për heroin. Por duke ardhur si kujtim ky mall e përcakton që në krye të poezisë “Elegjia” natyrën e vet, e cila do të jetë tepër elegjiake.

Malli tek vargu i Serembes nuk e ka hapësirën e bukur të shijimit apo pritjes, përkundrazi ai ëshë një ndrydhje në zemër sepse heroi ndjen dhe paramendon kotësinë e arritjes. Gjithashtu ky mall është edhe pikëllim dhe vajtim i mos shijimit të tij. Ndaj poeti-hero përpëlitet nër vete për këtë duke vajtuar me lot. Malli i Serembes është edhe tragjik, pasi malli nuk e afron, kurrësesi, sic ndodh me Naimin apo me Lasgushin më vonë. Ai shndërrohet në një kujtim që vec e largon nëpër rrugët e botës, nëpër honet e shpirtit të vet të përvuajtur deri në mallkimin e kujtesës. Kaq shkon malli i Serembes , të kujtojë duke vuar. Malli atë nuk e mban me shpresë por ndodh e kundërta, ai e dërrmon, e con drejt fundit, drejt harrimit. Një mall që e largon, që e vret drejt mbulimit me harresë, ky ishte malli serembjan.

Ndërsa tek Naimi malli së pari del si një ndërthurje qëniesh i të gjallëve me të vdekurit, i kohës së shkuar me të tashmen, i dy malleve, të kaluarës dhe të sotmes ku e kaluara është jeta e bijës dhe e sotmja humbja prej vdekjes. Pra malli shtresëzohet si dhimbje, plagë që edhe vetë shndërrohet në një përfytyrim të ri. Tashmë bija humbi në qënien e tij por mbeti vec si një mall në përjetësi për qeshjet, lajkat, nazet, vështrimin e saj. Kjo është tragjikja e shpirtit të poetit. Një tjetër formë malli na jep Naimi tek elegjia “Mbi varrin e sime motre”, ku malli përvëlues konstaton humbjen e përhershme që jepet me konceptin e ndarjes.Duket qartë se Naimi e shfrytëzon konceptin e mallit për të na dhene humbjen dhe zhdukjen e qënieve të dashura por duke u kapur fort tek ky concept (malli) për të krijuar përjetësinë e tyre në shpirtin e vet. Gjithashtu ai është katërcipërisht i bindur se malli i tij është vrastar për të, një mall që nuk do të jetojë si funksion shprese por si një ngushëllim. Pra malli naimjan nuk është një shpresë për ritakim por një ngushëllim për humbjët tragjike të të dashurve të tij. Si përfundim themi se Zef Serembe solli nje elegji të munguar në letërsinë shqipe, si për nga rrugëtimi real gjithkohor ashtu edhe nga modeli më evropian me formën me të cilën u prezantua. Naim Frashëri solli një elegji të plotuar në të gjitha karakteristikat e saj duke u bërë modeli më i plotë i elegjisë dhe më ne letërsinë shqipe.



BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË PËRKUJTON VEDAT KOKONËN


Është përkujtuar në ambientet e Bibliotekës Kombëtare ditëlindja e 110 e Vedat Kokonës. Miq, të njohur dhe lexues e adhures të punës së tij u mbledhën në ditën e fundit të tetorit për të vizituar ekspozitën kronologjike me gjithë udhëtimin e tij letrar, nga fillesat në vitet ’20, deri kur ndërroi jetë duke lënë pas një kontribut të ndritshëm si përkthyes i disa kryeveprave të letërsisë botërore dhe një fjalor frëngjisht-shqip, i cili u shërben prej dekadash të gjithë filologëve.

Në çelje, drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, z. Piro Misha u ndal në rëndësinë e kujtimit të personaliteteve të tilla. Gjat fjalës së tij, ai vendosi rëndësinë mbi ëndrrat e shtresës së intelektualëve të rinj të para luftës dhe mënyrën se si këto ëndrra morën tjetër trajtë, duke përmendur rastin e Kokonës i cili me gjasë donte të ishte shkrimtar, por më pas ndoqi udhën e përkthimit, në atë kohë po aq e rëndësishme për kulturën shqiptare.

Pas tij, Diana Çuli, shkrimtare dhe përkthyes tregoi se si Kokona ishte jo vetëm burim i përhershëm referimi me punën e tij, por edhe konkretisht, gjithmonë gjendej dhe u ofronte mbështetje atyre që i kërkonin ndihmë apo i bënë pyetje. Të njëjtën gjë vuri në dukje edhe Edmond Tupja, njeri i afërt me Vedat Kokonën, pa harruar të kujtonte poliedrinë e profesorit të tij, si dhe pikën që i lidhte me shumë se të tjerët, faktin se të dy, në kohëra të ndryshme, patën studiuar në Francë.

Interesi për aktivitetin ishte shumë i lartë. Përkthyes si Severina Pasho, Ben Andoni e të tjerë; studiues si Behar Gjoka si dhe shkrimtarë, mes të cilëve binte në sy Fatos Kongoli, ndoqën me interes ceremoninë dhe me po aq interes, vizituan ekspozitën e përgatitur nën kujdesin e dr. Etleva Domit, nëndrejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare.

Në fund, z. Misha falenderoi të pranishmit dhe njoftoi se ekspozita do të rrinte e hapur për disa ditë, dhe hyrja për këdo që ka interes do të jetë jo vetëm e lirë, por edhe e mirëpritur.



Letërsia e shkrimtarit të shquar Zija Çela, krahas nivelit të lartë estetik, është thellësisht humaniste. Ndaj, sa të ketë njerëz, do të ketë lexues të tij.

Atë që shumëkush e ndjen, e mediton, e monologon, atë që shumëkënd e mundon, e torturon, por nuk ka as kurajo, as gjuhë për ta shprehur si dashuri, si pendesë, si mall a trishtim, befas e shfaq si tekst shkrimtari Zija Çela, duke i ardhur gjithkujt në ndihmë. Thuhet se të gjitha kuptimet e një teksti letrar gjenden te vetë teksti, gjenden te lexuesi, gjenden te nënteksti, gjenden edhe te konteksti. Por në rastin e letërsisë së shkrimtarit Zija Çela, kuptimet e tekstit marrin dritë edhe nga jeta e njëmëndët e autorit, humanizmi i thellë, ndjeshmëria dhe ndershmëria e lartë, emocioni dhe mahnia, tipare që shpesh mungojnë edhe tek autorë të shquar.

Te Zija Çela mesazhet kuptimore dhe mesazhet artistike realizohen njëherësh në mendjen e në shpirtin e lexuesit. Duke leçitur Zija Çelën, lexuesi përndritet nga nyjëtimi artistik i tekstit, njëkohësisht përfton atë katarsis mendor dhe shpirtëror, si proces zanafillor i letërsisë.

Vepra e shkrimtarit Zija Çela është voluminoze, me një arkitekturë të menduar që në fillesat e saj. Tani mozaiku i kësaj vepre shfaqet i plotë, duke zënë një vend tejet të veçantë e të rëndësishëm në letërsinë shqipe dhe në letërsinë bashkëkohore në përgjithësi. Ai është një shkrimtar i shquar shqiptar dhe njëherësh european për mesazhet artistike e semantike që përcjell me veprën e tij.

Thjesht, si një trokitje te porta e veprës së shkrimtarit Zija Çela, në këto radhë, zgjodhëm pikërisht tregimin më të shkurtër të shkruar prej tij, atë me titullin “Trokitje”. Është një tregim mjaft i pëlqyer nga lexuesit sqimtarë të Zija Çelës, por i kundruar së jashtmi. Ky tekst është një sprovë për ta vëzhguar këtë tregim së brendshmi. Tregimi ka afro 150 fjalë, të rreshtuar diku te rreth 11 rreshta. Meqënëse është një tekst i shkurtër, po e sjellim më poshtë për lexuesin:

TROKITJE

Isha njëzet vjeç dhe pyeta: “Kur do ta njoh?” Në njëzet e pesë thashë: “Kur ta kem njohur, do të jemi gjithmonë bashkë.”

U bëra tridhjetë dhe ne ishim bashkë. Në tridhjetë e pesë ishim përsëri bashkë.

Po mbushja dyzet, kur bëmë udhëtimin e madh. Nuk mbaj mend se ku vajtëm, por kthimi ishte njëlloj si prej botës së përtejme: njëri prej nesh u tjetërsua aq shumë, sa e humbi toruan edhe tjetri.

Në dyzet e pesë u ndamë.

Pesëdhjetë vjeç i trokita në derë. Doli dikush dhe më tha:

“Ajo po fle. Ke ndonjë porosi?”

“Jo”, thashë, “vetëm desha të dija nëse është mirë.”

“Ajo është mirë”, tha.

Ende s’jam pesëdhjetë e pesë që ta di nëse është zgjuar nga gjumi dhe vazhdon të jetë mirë. Ndoshta kur të bëhem gjashtëdhjetë, do të pyes veten: “A do ta shoh përsëri?” Nëse në gjashtëdhjetë e pesë nuk do të jetë ajo që do të trokasë tek unë, shtatëdhjetë vjeç do të marthohem me një tjetër.

Kam frikë të plakem, por sidomos kam frikë të vdes, pa pasur afër një dorë gruaje.

Bie në sy se frekuenca e trokitjeve të subjektit mendues është harku kohor i pesë viteve: *Isha njëzet vjeç dhe pyeta: “Kur do ta njoh?”; Në njëzet e pesë thashë: “Kur ta kem njohur, do të jemi gjithmonë bashkë.”; U bëra tridhjetë dhe ne ishim bashkë. Në tridhjetë e pesë ishim përsëri bashkë; Po mbushja dyzet, kur bëmë udhëtimin e madh; Në dyzet e pesë u ndamë; Pesëdhjetë vjeç i trokita në derë; Ende s’jam pesëdhjetë e pesë* që ta di nëse është zgjuar nga gjumi dhe vazhdon të jetë mirë; Ndoshta kur të bëhem *gjashtëdhjetë, do të pyes veten: “A do ta shoh përsëri?”; ?” Nëse në gjashtëdhjetë e pesë nuk do të jetë ajo që do të trokasë tek unë, shtatëdhjetë vjeç do të marthohem me një tjetër.*

TROKITJE NË VEPRËN LETRARE TË ZIJA ÇELËS

Nga Yzedin Hima

Po cila është simbolika e numrit pesë?! Ja çfarë thonë teoritë e simbolikës së numrave: Numri pesë është një simbol i ekuilibrit. Do të thotë që në jetën tuaj, ju duhet të balancooni aspektet fizike dhe shpirtërore. Është thelbësore të jetosh në ekuilibër dhe harmoni, sepse vetëm atëherë mund të jesh i lumtur. Numri pesë është simbol i unitetit të njeriut me Kozmosin. Subjekti mendues troket në portat e kohës në çdo pesë vite të jetës së tij, pikërisht për të njohur dhe siguruar atë harmoni e ekulibër të nevojshëm.

Tregimi “Trokitje” është një tekst i ndërtuar me fjali eliptike, tipar i teksteve hermetike. Simbolet janë dukuri te këto tekste. Për të depërtuar te kuptimet e fshehta lipset të bëjmë dekodifikimin e tekstit, pikërisht duke u kapur te figura misterioze e simbolit. Fjala *trokitje*, e vendosur si titull i tregimit është filli i Arianës për të përshkruar labirintin e këtij teksti.

Trokitja e parë

Trokitja e parë në portën e kohës ndodh pikërisht në moshën njëzetvjeçare. Është

mosha kur njeriu bëhet i vetdijshëm se veç trupit të fortë e të bukur, veç materies memece, ka edhe një shpirt për të cilin i duhet të kujdeset. Trokitja e parë në kohë shfaqet në formën e një pyetjeje: “Kur do ta njoh?!” Te pyetja trokitje duket qartë se subjekti mendues, në moshë farë të re ka krijuar vetdijen se trupi i tij i ri dhe i bukur është thjesht burgu ku qendron shpirti dhe mendja e tij. Nga nënvetdija e tij i vijnë impulse të mistershme të cilat mezi pret t’i mishërojë në formën e një poezie apo vaje, për të cilin ka kërshëri të fortë. Simbioza tekst letrar- femër do ta ndjekë gjatë gjithë jetës subjektin mendues. Energjia krijuese i vlon në gjak dhe i shfaqet edhe si femër e bukur edhe si poezi e tillë.

Trokitja e dytë

Në moshën njëzet e pesë vjeçare trokitja e dytë në portën e kohës është disi e ndrojtur. Subjekti mendues e ka projektuar te vetja krijesën e tij dhe mezi pret ta njohë të projektuar në letër si tekst letrar apo ta ketë krahas të mishëruar si vajzë. Pikërisht te ndrojtja e trokitjes shfaqet pasiguria, e



cila do ta ndjekë gjatë gjithë jetës, ndaj ai bën premtimin: “Kur ta kem njohur, do të jemi gjithmonë bashkë.” Kjo pasiguri vjen nga mospërputhja midis realitetit të njëmëndët dhe realitetit artistik që pret të shfaqet. Për të linjat e krijesës janë të pakonturuara qartë. Ajo shfaqet herë si vajzë e bukur enigmatike, herë si tekst letrar. Herë si femër e bukur me trup fjalësh. Një tekst hermetik dhe një femër kanë shumë gjëra të përbashkëta. Janë dy objekte që lipset të njihen, zbulohen, përjetohen, dhe të krijohen në forma të ndryshme, në kohë të ndryshme, ndaj premtimi vjen si këkesë për kohë, për të realizuar këto procese: “Kur ta kem njohur, do të jemi gjithmonë bashkë.”

Trokitja e tretë

Është një trokitje në portën e kohës, kur subjekti mendues ka gjetur një harmoni të përkryer midis trupin dhe shpirtit, midis tij dhe krijesës, midis tij dhe realitetit të njëmëndët rreth tij.. Ai jeton më tepër në realitetin artistik, të krijuar prej tij, se sa në realitetin e njëmëndët. Ka humbur rëndesën dhe vrapon mbi re. Tekstet e tij letrarë botohen dhe lexohen kudo dhe ai dëgjon fjalë të bukura për krijesën e tij nga lexues dhe nga krijues të tjerë, të cilët i vlerëson e admiron. Në tregimin e tij gjuha është e shtruar dhe rrjedh si lumi në një terren të qetë: “U bëra tridhjetë dhe ne ishim bashkë.” Në tekst simbioza grua – letërsi, pas përemrit pronor Ajo. Në moshën tridhjetëvjeçare ndodh takimi i shumëpritur. Me tekstin apo me gruan e projektuar më së pari te vetja?! Natyrshëm, mund të themi se në këtë moshë shkrimtari ka nisur të përvijojë portretin e tij si artist i letrave. Gjithashtu është mosha, që e di mirë se çfarë është një grua dhe gjen shëmbëlltyrën e saj në botën e njëmëndët sipas shijeve të krijuara më parë te vetja. Në harkun kohor të pesëmbëdhjetë viteve autori ka gjetur harmoninë e duhur tekst letrar - grua - subjekt mendues - mjedis.


Ai na fton të soditim krijesën (gruan-tekst letrar) që ai e ka krijuar te vetja dhe mezi pret ta shfaqë dhe ta njohë. Pas shfaqjes së saj, harmonia dehëse ka përfshirë gjithçka.

Trokitja e këtërt

Trokitja e katërt është më tepër se në portën e kohës, te vetja. Në të tridhjetë e pesat subjekti mendues ende është në një harmoni të plotë me vetën, krijimin, mjedisin rrethues. Ai njofton se nuk ka asgjë të re në këtë hark kohor të jetës së tij nëpërmjet një fjalie pohore: *Në tridhjetë e pesë ishim përsëri bashkë.* Mjedisi rreth tij sërish ia ledhaton egon.

Trokitja e pestë

Është një kohë traumatike dhe trokitja në kohë bëhet në portën e një kohe dhe në portën e një hapësire tjetër. Koha në trokitjet pararendëse rridhte e qetë dhe hapësira ishte e njëjtë, e përcaktuar, e kufizuar. Edhe koha rridhte në të kundërtën e saj në portikë e porta. Udhëtimi i madh, për të cilin flet subjekti mendues është një zhvendosje e



madhe në kohë e hëpësirë. Është një udhëtim traumatik në kundërkohë dhe në hapësira të ndaluara të papërcaktuara nga autori: “*Po mbushja dyzet, kur bëmë udhëtimin e madh. Nuk mbaj mend se ku vajtëm, por kthimi ishte njëlloj si prej botës së përtejme.*”

Trokitja në një tjetër kohë dhe në një tjetër hapësirë ka sjellë trauma të forta, si humbjen e kujtesës, humbjen e ekuilibrit, humbjen e harmonisë trup - shpirt - krijim - krijesa. Metamorfoza ka përfshirë kohën, hapësirën dhe subjektin mendues. Kjo trokitje ka ndodhur në portën e Ferrit nga brenda apo nga jashtë?! Për të dalë apo për të hyrë në Ferr?! Kthimi krahasohet me kthimin nga bota e përtejme: “*Nuk mbaj mend se ku vajtëm, por kthimi ishte njëlloj si prej botës së përtejme: njëri prej nesh u tjetërsua aq shumë, sa e humbi toruan edhe tjetri.*

Në dyzet e pesë u ndamë.”

Në një tekst me fjali eliptike, dukuri e teksteve letrare hermetikë, lipset të hedhim një sy te shenjat semiotike që gjenden në tekst për të dekodifikuar tekstin. Në tregim gjejmë fjalinë pohore: “*Në dyzet e pesë u ndamë.*” Numrat janë shenja semiotike të ky tekst. Numri dyzet e pesë përkon edhe me moshën e autorit në kohën, kur në vend ndodhën ndryshime e kthesa të mëdha. Këto ndryshime prekin edhe subjektin mendues dhe krijesën e tij. Metamorfozat janë rrjedhojë e ngjarjeve traumatike në jetën e njeriut. Vendi doli nga ferri diktatorial i gjymtuar. Shoqëria lipset të ridimensionohet në një kohë e hapësirë tjetër. Mos vallë subjekti mendues braktis një estetikë dhe një produkt letrar për një estetikë tjetër dhe si rrjedhojë për një tjetër produkt letrar?! Kush duhet të ketë ndryshuar, të jetë tjetërsuar, Ajo (estetika, teksti letrar, gruaja) apo autori? Apo të gjitha bashkë?! Befas edhe subjekti mendues dhe Ajo (estetika, letërsia, femra e tij e adhuruar) gjenden në rrafsh të ndryshëm. Shenjat në tekst nuk premtajnë shumë për të ndërtuar kuptime. Palët kanë humbur toruan dhe ndarja është e pashmangëshme. Subjekti mendues kalon në një stad tjetër jete dhe krijimi?! Apo pretendon diçka të tillë?! Ndarja është e përkohshme, siç ndodh zakonisht në trauma të mëdha apo përfundimtare? Më tej tregimi i jep përgjigje edhe këtyre pyetjeve.

Trokitja e gjashtë

Kjo trokitje bëhet në ajër. Portat e kohës kanë rënë bashkë me portat e hëpësirave të kufizuara . Trokitja nuk u dëgjua nga rrapëllima e mureve që binin gjithandej.

Trokitja e shtatë

Në trokitjen e shtatë kuptojmë se subjekti mendues ka gjetur sërish ekuilibrin dhe harmoninë e humbur. Ai ka vënë re se koha ka ndryshuar, hapësira është e pafund, e pakufizuar, ndërsa krijesa e tij në simbiozën (tekst letrar- grua) është po aq e vlerësuar dhe po aq e dashur si në kohën e hapësirën e kufizuar. Ai zbulon se, pavarësisht nga koha e hapësira , ka krijuar një art dinjitoz. Autori, si të gjithë autorët e mëdhenj, ka pasigurinë nëse letërsia e tij është në nivelin e duhur artistik, nëse është në të njëjtën valë me letërsinë botërore të shekullit të ri: “*Vetëm desha të dija nëse është mirë.*” Qetësohet kur merr përgjigjen: “*Ajo është mirë.*”

Dihet etja për letërsinë që kishte lexuesi gjatë viteve të diktaturës. Aty gjente të bukurën, humanizmin, ledhatimin e shpirtit dhe të intelektit nga tekste letrare si të Zija Çelës. Në këtë letërsi lexuesi gjente strehimin shpirtëror e mendor, duke u larguar nga dhuna, vulgariteti i dhunshëm i botës së njëmëndët dhe tekste pseudoletrare si fotografi e atij realiteti dhunues të autorëve të socrealizmit, ku mungonte funksioni estetik dhe shfaqje funksioni qëllimor i tekstit që kishte pushuar së qeni tekst letrar. Zija Çela, ndonëse krijoi edhe në kohë dhune, tekste të tij letrare i shpëtuan morsës së aestetikës së socrealizmit falë talentit

të fuqishëm letrar, humanizmit të thellë që është shenjë themelore e kuptimit të teksteve të tij. Në tekstet e tij së pari lexuesi dallon shtyllën e fuqishme të funksionit estetik, që përbën shtyllën kurrizore të këtyre teksteve. Natyrisht, nuk mungon edhe funksioni ndikues dhe ai formues në të vetimin kah, atë njerëzor. Nuk mungojnë edhe tatuazhet e dhunës së socrealizmit edhe në tekstet e tij. Po le të kthehemi te tregimi ynë.

Trokitja e tetë

Kjo trokitje realizohet te kujtesa e subjektit mendues. Ajo del në formën e një pohimi për mosplotësinë kohore: *Ende s’jam pesëdhjetë e pesë që ta di nëse është zgjuar nga gjumi dhe vazhdon të jetë mirë.* Në këtë tregim të shkurtër kemi zhvendosjen nga teksti te gruaja. Ndihet pritja e ethshme e subjektit mendues. Po çfarë pret ai?! Të zgjohet letërsia e tij, të zgjohet gruaja e dashur apo lexuesi?! Ndoshta të gjitha bashkë.

Gruaja e përgjumur, apo tekstet e përgjumur shënojnë, për mendimin tonë, tekstet letrare që flenë në biblioteka dhe librari të palexuara, të pashfletuara. Pas diktaturës, në vend nisi anarkia postdiktatoriale. Libri që i braktisuri i madh. Filloi prirja e ethshme për materialen e gjithmunguar. Njerëzit u bënë robër të sendeve. Libri u braktis. njeriu harroi të gdhëndë njeriun te vetja me daltën e librit.

Trokitja e munguar

“Nëse në gjashtëdhjetë e pesë nuk do të jetë ajo që do të trokasë tek unë, shtatëdhjetë vjeç do të martohej me një tjetër”,- thuhet në tregim. Në këtë hark kohor subjekti mendues pret që dikush të trokasë te porta e tij. Ai ka humbur disi sigurinë se *Ajo* mund të vijë dhe të trokasë, por ai do ta presë.

Trokitja e nëntë

Kjo trokitje bëhet në portën e absurdit. Tregimi përfundon me një thënie: *Kam frikë të plakem, por sidomos kam frikë të vdes, pa pasur afër një dorë gruaje.* Në këtë thënie të autorit ndihet qartë ekzistencializmi. Shpirt i ri, i pandryshkshëm, mendja e mprehtë që vlon nga idetë, gjenden të burgosur te materia memece që quhet trup, i cili është tejet i përkohshëm. Tregimi përfundon me këtë klithmë ekzistenciale. Subjekti mendues ka humbur ekuilibrin trup -mendje - shpirt. Ai ndihet i brengosur dhe i burgosur në trupin e tij, në materien memece që nuk po i përgjigjet siç duhet shpirtit të ri dhe mendjes së tij që vlon nga idetë, por që nuk ka kohën e duhur t’i vërë në jetë. Ai gjendet në këtë situatë absurde. Me kohë është kujdesur për të transferuar shpirtin dhe mendjen e tij në një dimesion tjetër, nga trupi i tij i përkohshëm (burgu i mendjes dhe shpirtit të tij), te një dimesion tjetër, te librat si krijesa të paasgjueshme. Ky është shpëtim i mendjes dhe shpirtit. Dalëngadalë autori shndërrohet në libër, metamorfoza dhe altruizmi më fisnik i genies.

Autori është njohës i thellë i shpirtit njerëzor. Ai ndjen dhe dallon edhe vibrimet më të lehta të këtij shpirti. Gjithashtu në tekstet e tij dallohen qartë tatuazhet e dhunës që njeriu i ka shkaktuar njeriut, jashtë çdo arsyeje njerëzore. Shkrimtari Zija Çela është anëtar i denjë i Bankës së

Ankesave, ku ka depozituar dhimbjen e tij për vuajtjet, padrejtësitë, ankesat e njerëzve të thjeshtë, të cilët nëpërkëmben çdo ditë nga ata që janë persona vip të bankës së kursimeve.

Në tekstet letrare hermetike lexuesi gjatë dekodifikimit të tyre zbulon edhe njeh edhe veten, anën irracionale të tij. Ndaj kur kemi para një tekst letrar si tregimi i shkurtër “Trokitje”, krahas kënaqësisë estetike, zbulojmë edhe veten, prekim ato vise te brendësia jonë, të cilat nuk do t’i kishim njohur e prekur kurrë, pa ndihmën e letërsisë së madhe, si letërsia e shkrimtarit të shquar Zija Çela.

PUBLIKOHET NJË KËNGJË E RE NGA “THE BEATLES”

Regjistruar në vitin 1977 si *demo* në shtëpinë e vet nga John Lenon, shoqëruar prej tij në piano, *Now and then* nuk u publikua asnjëherë, pasi Lenon vdiq dhe anëtarët e tjerë të *Beatles*, ndonëse muzikën e luajtën disa herë, nuk e shoqëruan edhe me vokal. Një përpjekje u bë në vitin 1995, por teknologjia e asaj kohe nuk ja doli dot ta ndante vokalin e Lenon prej tingujve të pianos së tij. Dhe kur u mendua se qe një punë e pamundur, në korrik të 2022, Peter Jackson mundi të krijonte një program nëpërmjet të cilit kjo ndarje u realizua. Tani gjendej më vete John Lenon duke kënduar dhe pianoja e tij.

Anëtarët e tjerë të bandës, me në krye Mçartney-n, bashkë me Ringo Starr, rimorën regjistrimin variantin e punuar në ’95, duke vendosur edhe pjesën me kitarë të luajtur nga George Harrison dhe riluajtën muzikën e këngës, së cilës ju shtua edhe zëri i Lenon.

Kështu, me datë një nëntor u publikua në YouTube një dokumentar i shkurtër prej dymbëdhjetë minutash për historinë e *Now and Then* dhe një ditë më vonë, edhe vetë kënga.

Now and then është një baladë rrok e cila u mirëprit menjëherë, duke numëruar me miliona klikime qysh në orët e para pas lançimit.



Mario Bellizzi është dëshmia e mos heshtjes kulturore dhe gjuhësore te Letërsia e Sotme Arbëreshe. Një zë i veçantë që vazhdimisht flet për rezistencë, andaj shkruan gjithnjë për prejardhjen dhe vazhdimësinë arbëreshe, dhe pa pra apelon për ruajtjen dhe kultivimin e traditës së paraardhësve të tyre nga Peleponnesi. Ky shqetësim arbëresh është shtjelluar edhe në poemën **NGA DRITARET E HISTORISË**, aty ku *“Rrëzohen këmba këmba ka shurat e shkretëtires/ kërcejnë fërfillatet gjëmba-hekuri të filaqivet/ fshehuraz pështojnë nga ushtrit e markandet/ sa të bëjnë udhën e çafkavet e kurrilavet mbi Mesdheun”*, (faqe 9.) Mario Bellizzi, është zëri më autentik i kësaj letërsie, studiues i pasionuar, njohës i historisë dhe etnografisë dhe poet i gjëmës së madhe, i mallit të pashuar, i ëndrrës dhe mos heshtjes arbëreshe! Ai *“Ng’janë më njerëz po vetëm robëri, krahë për punë,/ ndër dhera me narënxa, dredhëza, domate, petkat e mafjas,/ të shprishur ndër gërmime arkeologjike nën zhegun pa lipisi/ [...] Në këtë vrathaq dhe, pizull magjjas së Jugut,/ prak i Gjithësisë të filozofëve Ipaso dhe Arkita/ njeriu për herën e parë skallioj harmoninë e tingujvet/ sasitë pamasura”*, (po aty, faqe 9.)

E më tutje, po në këtë poemë, Mario Bellizzi, na jep një pasqyrë më të qartë në shtjellimin jo vetëm si motiv po më tepër si realitet i Heshtjes Arbëreshe, komunitet që edhe vet po nëpërkëmbë një traditë historike, kulturore e etnografike në kohën kur *“historia është vetëm lëvizja e pëllëmbës së dorës së hapur që ture valëvitur në qiell”*, (faqe 25), d.m.th. historia është aq e gjatë për jetën e njeriut sa një *“lëvizja e pëllëmbës së dorës së hapur?”*, prandaj në poemën **NGA DRITARET E HISTORISË**, ai shton:

[...] Këtu, të mallkuarit e Jetës, pa dhë,
Shumiza nani në lutje nani në luftë
e varfër lypën një shpi, të drejtën për
strehimin,
dreq si ndodhi për Danaidët në
tragjedinë e Eskilit
ki është Faj që mban popujt të poshtëruar
nga uria
përveç shurbiset livisënjn ka duan!
Udhëtarët lahuriq e pa ndihme, kurriz
përmystë,
shtiejnë baltë ndër faqet e Priftërinjvet
të fodhull
ndër Qishat (Kishat) e Tregut
Ka mot dihet se trupat e frymat kanë
“një sinor që ng’mund kcëhet të jesh zot
i jetës së të tjerëve”
[...] dallandysha të lodhura
në hartografi të shqerra nga heshtja
i shkojnë martrinë këtyre migranteve
ndërsa popujt që erdhën me ani të moçme
me abetare ilire, prifta dhe ikona, keza
për mbretëresha,
edhe atë të përzënë nga turqit në
shekullin XV
nani ju lëshojnë palën
vatrat, rrathët piçkulaç të gjitonivet
melurgjitë dhe panajin e të vdekurvet

**Poema “NGA DRITARET E HISTORISË”,
faqe 11.**

Ky libër përveçse përfaqëson letërsi, është vazhdimësi e jetës dhe ëndrrës, ndjenjë kjo e realitetit të përjetuar. Por metafora e Heshtjes Arbëreshe lidhet drejtpërdrejt me aspektin kulturor e fetar të këtij komuniteti i cili vazhdimisht ndrydhet dhe shtypet për t’u tjetërsuar, e më pas, edhe për tu asimiluar sa më shumë, sa më shpejt dhe mundësisht në planin fetar për t’iu përshtatur ritit latin, pasi kështu Arbëreshët mund të harrojnë gjuhën dhe zakonet e tyre, e bashkë me to edhe Atdheun e lashtë nga i cili para pesë shekuj me dhunë janë dëbuar, e tash *“jemi në Jug ndanjë katund jashtë historisë”*, ku zhvillohet një dramë e tërë, një histori e dhembjes, jo vetëm arbëreshe, por *“heshtjan e njëj populli ç’u xarris udhëvet për shekuj”*, nuk e duron as poeti:

Mario Bellizzi, *“La crisalide e la forma die silenzi – NIMFA DHE PJAZMA E HESHTJEVET”*, poezi italisht – arbërisht, botoi *“Edizioni Promoidea Pollino”*, Castrovillari, anno 2021. Faqe 112.

NË HESHTJE RREZIKOHET VDEKJA E GJUHËS

Nga Shefqet Dibrani

Gjendem në një vend i madh, pjot
simbola dhe njerez
me prejardhje gjeografike sa më të
ndryshme
vend i ndërlikuar piçkulaç, i mbitur në
shenjtëri dhe peisazhe
zbrazëti, mura të gramisur
(jemi në Jug ndanjë katund jashtë
historisë)
para meje shoh një kështjellë
e rrethuar me shpizë si kaliva vetmitarëve
ku jetojnë nani emigrantet rumunë dhe
afrikanë
aty këtu shtohen shfaqje marramendëse
një burim përrallor me mbistica
më poshtë kupola bizantine ngjyrë
kobalti
ruajnë në lindje, ujërat e kthjellëta të
detit të *Magna Graecia*-s
ku fanaren Perëndi pjeq
si thonej Euripidi: *hije të pajisura me
frymë*
të bërë me copa qielli, një vegim i mbrazt
**Magna Graecia*-s – Vend në Greqi.

**Fragment nga poezia
HIJE ME COPA QIELLI, faqe 19.**

Përndryshe, edhe sot e kësaj dite nuk
dëgjohet gjëma e tyre. Libri është edhe
protestë, përmes tij poeti bënë thirrje për
mos heshtje, prandaj është detyrim i të
gjithëve, kulturën dhe letërsinë arbëreshe
ta shijojnë e kultivojnë si duhet e sa duhet.

Kjo trashëgimi kulturore që na fali Zoti dhe
e ruajtën Arbëreshët në Itali, është dëshmia
historike se si ky komunitet u rezistoi
shekujve duke rrezatuar vlera të mira në
njërën anë, kurse në anën tjetër në sfidat e
globalizmit e të dixhitalizimit, ata lëshojnë
klithma e bëjnë thirrje për qëndresë e
mbijetesë ekzistenciale, ku me veprime
kulturore do të sfidohet Heshtja... e cila në
këtë libër është lajtmotiv duke u shndërruar
në simbol letrar që ka kultivuar një metaforë
specifike dhe të përpunuar, e cila me gjëmë
e britmë, po sfiduar kohërat dhe po thyen
Heshtjen e detyrueshme.

Bulerëvet e fshatit i shkoj për krye
t’i lëjnë stërnipravet e stërmbesavet
gjurmat të çetës
të gjuhës së Hyjnivet pellazge dhe
kozmogonisë orfike
po duhej të zgjamararej indi
në ehjën e kujtesës, pa marr frymë,
në një *Hë* si thonë arbëreshët.
[...] Në fillim u lë Nata, një zog i madh me
krahët të zi,
çë Vorea - era e ftohtë të Veriut - përfendi
Në barkun e Errësirës
Nata lëshoj vezën kozmike argjëndi
kur u ça duall Eros-i
çë zbuloj se atje brënda ish e fshehur
Bota e tërë
tek ana e sipërm u ngul Qielli
i njohur gjithashtu si E-tërë, Brazi, Ka-
Honi,

në pjesën e poshtme, u vendos Dheu.
Qielli e Dheu qijtën pa turpë e u lë Ujana
dhe Dejt
Bulerët rrëfijtin gjatë e gjerë me harë
se Dheu i vetëm puall Uranin
çë është qielli mbarë urime e plot yj
pra nga Dheu e Urani
lindin gjashtë djem e gjashtë vajza
[...] *paraardhësit tanë
me një gjumë pamasur
një shkretim i heshtur dhe pothuajse si i
dehës
të përkulur mbi tokë, gjysmë të gjallë,
me shpejtësinë e parmendës çë është
shpejtësia e përjetësisë ...
[pa triqim], sidoqoftë ku mund të
shkojnë?]*

**Fragment nga poezia
QYCAT E GJITHESISË, faqe 21 e 23.**


Heshtja e poetit ka të bëjë edhe me
shqetësimin nacional për zbrazjen e heshtur
të fshatrave arbëreshe dhe për më tepër
poeti proteston edhe kundër heshtjeve në
shkallë kombëtare, për gjithë ato ekzode të
pa kontrolluara, për të cilat nuk shqetësohen
udhëheqjet e Dy Atdheve poetik. Prandaj
poezia e Mario Bellizzit mund të klasifikohet
edhe si rezistencë maksimale për jetën dhe
gjallërimin arbëresh të cilët me sakrificë
kanë ruajtur e kultivuar vazhdimësinë dhe
qenësinë arbëresho-shqiptare! *“Oh Shqipëri
Atdhë i etërvet të mi/ refugjatët të shekullit
XV/ për mua ngjë më e Bukura Morë”*, (faqe
85.) E këtë konstatim ma së mirë e shpreh
poezia Hora e t’Arbëreshvet, në të cilën poeti
mësoi jo vetëm misteret e ngjyrave dhe fatin
e murgjve e priftrinjëve shpirtnor, por atje
mësoi edhe për rezistencë dhe kryengritje
të shumta me të cilat janë përballur
vazhdimisht Arbëreshët në Itali.

HORA E T’ARBËRESHËVET

Trupi yt perzihet
me arin e kallinjve gruri të aravet
atje ty mësove misteret e ngjyrave
të perziera me gjakun e Purtelës
melurgjite lindore të papasavet
të mbytura në tymrat e temjanit të
kryengritjes
Dua të të këndonj
me zërat e ngrohtë dhe të dashuruar të
jetës
së burravet që burojnë nga ikonat
asketë bizantine që dalin jashtë historisë
Së bashku me ta piva verën e fortë
të vreshtavet e lashta me rrënjë në
humnerë
ndër gjitonit të mahnitura nga ngjarjet
Këtë gratë qëndisijnë të qeta
shtigje argjendi në qiej razi
fshehtësi dhe kështjella ku strehojnë
shpresa

Faqe 99.

Pra çdo heshtje, rrezikon vdekjen e
gjuhës, prandaj arbëreshët këndojnë e
këndojnë për ta thyer heshtjen, shkrimtarët
shkruajnë klithmat e tyre dhe të tjerëve,
prandaj lirika arbëreshe është poezia më
tronditëse e atdheut tonë. Është thirrje e



drejtpërdrejt, është ritual fetar, lutje te Zoti për t’i shpëtuar Arbëreshët nga mos njohja e vetvetës, nga moskëndimi i këngëve arbëreshe, dhe apel kundër harresës së traditës, etnografisë dhe kulturës autoktone arbëreshe.

FSHEHTËSI

Mbi muret e shpivet ka jashti
çë moti i shkoqi
u bi një krogjallëshë e vetë.
Me dhelpëri Dejti na ruan për së llargu
me fshehtësi çë bëjnë syth ndër suvalet.

Faqe 29.

Ndoshta e kam gabim, por kur dëgjon se Kisha po e mallkuaka poetin pse shkruan arbërisht ose pse kërkon në Kishën e tij të lutej e rrëfehej arbërisht, veçmas në ritin që i kanë lënë amanet të parët e tij, nuk ke se si të mos ndihesh i tronditur. E qartë, këto konflikte konfliktuozë, përgjatë proceseve e ndryshimeve të mëdha shoqërore, ngjallin jo vetëm huti por shkaktojnë pezmë te secili arbëresh që beson në Zot dhe në Kishën e vet, veçmas poetët që nuk pranojnë të heqin dorë nga riti i tyre bizantin grek dhe gjuha arbëreshe. Një luftë demonesh, e cila vihet në pahë në trajta të ndryshme edhe nga ky libër poetik që tërhoqi edhe vëmendjen e kësaj qasje kritike. *“Rrëfihet se atjë/ atà themeluan koloni të reja/ bashkë me dica mërgimtarë/ të mbjëdhur pak e pak nga kudo./ Patjetër ajo lagje nani jeton/ vetëm falë dhunës së lëvizjes të mërguarvet përpara/ dhe kalivet të ndërtuar sapo ngultin këmbë/ nxitin muzgun e vendit“*, (nga poezia NUSJA, ABËZA DHE KÛKULLA, faqe 39), e në anën tjetër *“fjalët e tyre shumëkuptimesh ndezijnë poezi“*, (po aty faqe 39.)

Motivi i heshtjes për Mario Bellizzin është obsesion poetik dhe shqetësim i lartë patriotik. Pos këtij libri me poezi edhe në librat tjerë e ndeshim motivin e heshtjes si fenomen, si dukuri, por jo me këtë tonailitet sa në *NIMFA DHE PJAZMA E HESHTJEVET*. Me sa di edhe në studime të tjera në gjuhen italiane Mario Bellizzi e ka trajtuar këtë shqetësim dhe bashkë me të edhe shqetësimin Arbëresh i cili tashmë është bërë plagë për poetin dhe komunitetin.

GRAT E JUGUT

Grat e jugut
të mbitura në gropën e fatosur të vatrës
ndihijnë një mëmë
të pjell kometa dhe shkëndija.

Faqe 65.

Ky pasqyrim etik, lidhet edhe me çështjet historike dhe me fatin e komunitetit arbëresh, prandaj poezia e Mario Bellizzit është histori, është vet dëshmia historike e heshtjes së detyrueshme për shthurje të mundshme me rrezikun e përhershëm të shuarjes së zërit në lutjet edhe brenda Kishave Arbëreshe ose ndjekjet e shumta nga propagandat krishtere të ndihmuara nga feudet e caktuar të cilët ishin vënë kundër ritit bizantin grek që e praktikojnë Arbëreshët Ortodoks.

Ky libër është i pajisur me metafora të shumta të cilat ia rrisin vlerën librit, poezisë dhe vet poetit. Ja disa metafora të cilat i kemi vjelur nëpër poezitë e këtij libri: *“Me shoshin s’mund fshehet dielli“*; *“shpejtësia e parmendës çë është shpejtësia e përjetësisë...“*; *“shpejt ecen shinat e kohës simë“*; *“Shpejtësia e ngjarjevet/ ndonjëherë bën të të humbet kryet“*; *“bëhen guri i qoshes/ për udhëkryqet pa një vend tjetër përveç Ferriit“*; *“hëna me gjishtat ngjyrë trëndafili fiton mbi të gjithë yjet“*; *“sëmundje e hënës rrotullon qiellin dhe zemrën time“*; *“jemi pronë e jetës“*; *“vajtime çë shpojnë misht“*; *“bën`i erdhi malli të shkelënaj livadhin“*; *“Diçka ty do, në pazar e gjën,* (Gjithçka që do, në pazar e hjen)“;

“Ballkani ng’mund të ketë *kufij* por vetëm *pragje“*, “Aty ku është e rënie, ng’janë më *unë* dhe *ty*,/ *unë* me *tjetrin*, *unë* kundër *tjetrit“*, etj. etj.

GJEOGRAFIA E SHPIRTIT

Lë hijë prapa
në këtë gjeografi të mallkuar të shpirtit
shtigje kometash
çë kurrë ari i ikonavet
mund fsheh.
I ndëjtur mbi rahjn
përballë atyre pamjeve
koha dhe rrjedhat e kryengritjes
më shkundijnë kurmin.

Faqe 43.

Metafora Heshtjeve, bëhet e dukshme qysh në titullin e librit ku pjesa e dytë *“Pjazma e heshtjevet“*, përcakton dhe simbolizon motivin tematik që për simbolikë ka heshtjen, e trajtuar në forma dhe trajta të shumta, të cilat mund t’i formuloj vetëm ai që ndjen në palcën e shpirtit, heshtjen, jo aq atë fiziologjike e personale se sa dukurin e braktisjeve të gjuhës, traditave dhe përgjithësisht kulturës arbëreshe ku dita ditës shihet se zërat arberisht po heshtin, përkatësisht po paktohën. Këtë shqetësim poetik e gjejm nëpër vargje të shumta dhe ndijimi i saj nga çasti dhe rasti evulon, p.sh.: *Hartografi të shqerra nga heshtja; Lakimi, ritmi dhe toni çë rrëzohet drejt heshtjes; Mbretëria e Heshtjes; Harpokrati, zoti i Heshtjes; Heshtjan e njëj populli; Mbrënda heshtjes dhe motit; Bëri truc me heshtjen/ ambulanca e Historisë; Kallinj gruri të korrur në heshtje; Heshtjet e burravet të fortë dhe të pastër; Heshtja e gjtonivet* etj. Por metafora Heshtjeve, bëhet më e dukshme te proza poetike HESHTJET E MIA, e cila lidhet kryekëput me katundet arbëresha, poezi këto sa të bukura po aq shqetësuese, ndërsa metafora e heshtjes këtu përcakton edhe topikën e shqetësimit që lidhet drejtpërdrejt me katundet arbëreshe:

- **Farnetë**, ndër gjitonitë gjegjet një heshtje;
- **Shën Mitri i Koronës** heshtja eshte mbreterore... Këtù Historia u piks brënda gurin dhe bronxin/ në heshtjen e shurdhër të hapavet të De Radës.
- **Kastejnexh** hapni sytë e veshët se heshtja është e rreme;
- **Spixana dhe lavoma ne heshtjen e lutjes**, Heshtja e këtij katundi është një heshtje çë vjen përsë llargu, nga një gjeografi e huaj, heshtjen e sotme e çeli, si çelat një vé, heshtja tjetër e dhunës së Fuqive, çë kanë shtypur zërin çë parkalesnaj në një gjuhë tjetër.

Në anën tjetër, *“gjeografi-rrjedhim me themele në heshtjen o mungesën e përgjigjes“* sepse *“Në heshtje rrezikohet vdekja e gjuhës“*, sidomos kur *“heshtja ra mbi zërin“* e poetit arbëresh. Po ashtu edhe *“Mbuzat prita dimrin të ecija ndër udhët e katundit të lyer me klorofilin e heshtjes“* që në njëfarë mënyre *“dhuron ëndrra të thurur me heshtje e lufta“*, janë gjakim i përhershëm i poetit Mario Bellizzi.

Arbëreshët për shekuj të tërë kanë ruajtur identitetin e tyre falë kishës dhe këtij riti fetar ca ndryshe nga riti latin që predikohet anë e kënd italisë, kjo alegori lidhet edhe me tjetërsimin, përkatësisht heshtjen e arbërorëve në Shkup të Maqedonisë, ku *“Ng’ka tokë tjetër si yni të pasura me Shenja/ dhe simptoma të sëmundjeve të shpirtit./ Maqedonia, është dreq si unë, Dhe kurbeti.”*, (faqe 81.) Pa dyshim qëndresa e Arbërorëve në Shkup dhe ajo e Arbëreshëve kanë kaluar nëpër etapa të rënda, të vështira dhe diskriminuese, gjë që ky diskriminim nuk fshihet as në poezitë e Mario Bellizzit, sikurse që asnjë varg i tij nuk i shëron plagët e historisë arbëreshe, por as nuk do të shuhet gjakimi i poetit për një atdhe të idealizuar!

N’FUSHËBETEJË SHTRATIN KAM ME EKTHY

Cikël poetik nga
Donika Dabishevci



KRYQZUEME PARA TIJ

Jam krejt e brishtë
kur ftyrë e tij m’zen ninëzat.

T’dridhmet trupit
ma zi se t’rrqethunat dimnave t’acartë.
Krejt ng’jamë, plotë frymë,
humbun n’valë jam,
nji shej, nji reze, nji dritë tuj pritë.
Fort u qindron tundimeve t’mia
ai i mbshtjelluni me diell n’flokë.
Prej syve, mollzash, poshtë buzve tan’
musht
kryqzueme e zbrapsun para shenjtnisë
s’tij.
S’jepet ai...
Luftar mitik që s’njeh dorëzimin.
Dashnia n’mu veç vjen e rritet -
se e du fort e i falem veç t’pajepshmes!

N’ATË T’PËRVEÇMEN DITË

Nji ditë n’përveçmëninë e saj
papritueshëm kam me ta dhanë kumtin
se erdh koha me t’i shkye shtatë lëkurat
si rrangalla t’vjetra me t’i thye,
e me t’i gjujtë edhe lëvozhgat e shpirtit
tuj gërmue me e gjetë palcën
e naj vishkull drite n’sy.
Nadje heret masi t’jen’ mpi gjymtyrtë
kam me t’pa zbuluet tan’ paqtim.
Qielli ka me dënesë prej gëzimit,
shiu ka me gjallue edhe rrasat e vorreve,
n’zogj t’hareshëm ka me i kthye
e sytë e gjelbër kanë me lulzue.
Nji ditë n’përveçmëninë e saj!

EDENI JEM!

Je porti, je bregu
degë e artë je
që thurret shtegtar’

molepsun udhësh
n’aromë pishash
lugnajave tua
me zbritë me u ndalë
me i kthjellë sytë
n’at’ fresk mëngjesi
me ju dorëzue
përkdheljeve ngushë
magjepsun andrrash
n’atë lojë hyjniesh
krejt etjen e tyne
me e përmbushë
si gurrë me shpërthy lumnija
eliksirit tand tuj ju falë
n’kopshtin tand t’Edenit
n’strehën e amshimit
mos me pasë gjarpën
as dreq që m’ndalë

VULLKAN

N’fushëbetejë shtratin kam me e kthy
n’llavë ke me u zhba e kam me t’përbi
si kulçedër zjerm kam me lshu
ti ke me kanë njeri veç mrena n’mu
e jasht s’ke me mbetë gja
as ti as qenja jote

ti ke me kanë unë
e unë kam me shndritë veç me ty mrena

ME TY

Kan’ me kërcitë
tanë damart prej mllefi,
ka me u përskuqë lëkura
ftyra me u përflakë qefi
dashninë kem me e ba luftë
e luftën dashni!

Ikisha lexuar edhe më pare poezitë e poetit tone të dalluar Resul Shabani, dhe pastaj, për gjatë kohë, e kam ndier në vetvete veprimin e tyre fisnik në vazhdimësi. Një promovim i librit të tij, në ndërkohë, sikur të ishte ai shpërthimi i vërtet që ma zbuloi lirikën e tij të nivelit të lartë. Në këtë event poeti e lexoi poezinë e tij “Përsiatje tri ditë para vjeshte” dhe ne të gjithë të pranishmit u ndiem sikur jemi dëshmitarë të një ngjarjeje, e cila në kuptimin më të mirë të fjalës, e kthen besimin te misioni i veçantë i artit të shkrimit, përkundër të gjitha profanizimeve dhe drithërimave për marginalizimin e saj. U bindëm se kemi të bëjmë me një lirikë nga më të pastrat e më madhështoret, një arkë e vërtetë me shpërthime lirike, poezi të ngarkuara me përvojë dhe pjekuri, e mbi të gjitha me përjetime delikate dhe shumë të çmuara. Jo vetëm kaq, por edhe me njohuritë e thella për fushën e artit poetik. Fjalën e kemi për poezinë e serës dhe rangut të veprave të mëdha klasike, me një energji të pashtershme lirike me të cilën do të freskohen gjenerata të shumta lexuesish. Është plot me jetë dhe me art. Me një jetë të tërë dhe me art të përhershëm. Rrefimtare, skofiare, e ngrohtë, me nota tragjike, por përsëri madhështore, e përkryer. Shfaqet butësisht, shumëkuptimshme. Vajton, por nuk dëshpëron. Qetëson, pasi e kupton se rrjedha është e pandalshme. Na ofron një tablo vezulluese, obelisk ëndrrash, përshfaq magjinë e ndërtimit të urës me vlera dhe ndjenja jo materiale, por të pa shkatërrueshme: *prej marrëzie, prej mërie, prej xhelozie; prej mirësie, prej bukurie, prej dashurie*. Njëkohësisht ofron edhe rezultate të procesit të kundërt, dhe skulpturon portret mallëngjyes prej drite, prej malli, dhe prej flake. Ky portret jogazmor, kjo nusja vezulluese është qytetare e dy botrave, prandaj vetëm ndonjëherë, me ndihmën e ëndrrave të poetit, fluturimthi ngroh në botën tonë jo dashamirëse dhe të përthyer, duke i zbutur trajtat, duke na ngjallur përmallimin për të përtejmen, për hyjnoren te njeriu. Vallë, a s’ka vepruar kështu poezia prej lashtësie? Ajo e vërteta, e madhja? Prandaj edhe ky libër i Resul Sahabanit e ballafaqon lexuesin me freskën lirike, me lutjen e madhe njerëzor për bukurinë hyjnore, për fatin dhe të madhërishtmen e gëzimit të jetës, me poezinë e cila, si e tillë që është, dhe me aq sa është, duhet dhe me patjetër të përfundojë me aktin hyjnor, me akt të shenjtë, me ndezje qiriu “me lutje Shën Marisë”. E di poeti ynë i mençur: vezullimi i dritës së qiriut tonë, jehona e lutjes sonë, kur do të shumëzohen dhe kur do të shenjtërohen nga fytyra e shenjtore, atëherë ofron qetësi dhe ëmbësi në jetën tonë, e ngroh dhe e ëmbëlton fytyrën e botës, por edhe poezia, si kjo, e shndërrojnë në qiri, në kandil, në ndriçim qiellor. Kjo poezi e Shabanit është poezi dashurie, kjo është poezi e madhe, poezi e madhe erotike, por kjo është edhe diçka më shumë: është gjurmë artistike jetike, vulë lirike e një shpirti krijues të rizgjuar, i cili duke ia dalë në krye me vërshimet e tija emotive, na lë një vepër të përkryer artistike, vepër kjo që, nëse na lejohet ta perfrazojmë, e përbërë nga butësia dhe nga dhembja, nga pastëria njerëzore nga flaka e përmallimeve të pa krahasueshme sipas të drejtës të ngrohtësisë njerëzore dhe realizimit dhe fatit njerëzor.

Mu për këtë kjo poezi me të drejtë është vënë në hyrje të një libri të poetit tonë, por kjo po me aq të drejtë do të qëndronte dhe aq art dhe fuqi njerëzore do të mund të çelte edhe përzgjedhje antologjike të hartuara me kritere më se të rrepta të poezisë erotike me shtrirje më të gjerë. Kur flitet për këtë përmbledhje të Shabanit, gjithësesi duhet nënvizuar se kjo poezi mundëson një hapërim të mëtejshëm. Pra, pa marrë parasysh kohën e ndodhjes, në këtë radhitje të njësive lirike, ajo inicon edhe një këngëtim të ngjashëm, prej saj sikur del një poem i vogël, por i shkëlqyeshëm prej tri pjesësh, ose siç i pagëzon poeti, tri balada. Në këtë poem, në këto balada, përsëri na shfaqet nusja, kjo qendër e entuziazmit dhe shpresës, por tani jo vetëm për unin poetik dhe lirik. Tani ajo është burim i gëzimit dhe haresë të kolektivit, ngrihet si simbol me strukturë shumështrësore: të bukurisë dhe pafajësisë, të dashurisë dhe ngrohtësisë, të familjes dhe të shtëpisë, së fundmi, edhe i shpresës për trashëgimi dhe ardhmëri. Si të tilla, këto balada, janë të mbushura me vrytje, ajo e çon më këmbë tërë kolektivin. Gjithçka vihet në lëvizje, gëzohet, shpresohet, festohet, i zbulon, dhe në përputhje me traditat e këtij Ballkani të çuditshëm dhe kontradiktor, në mënyrë luksoze, ziliqare, dramatike por gjithnjë pranë gjasës të zgjidhjes tragjike, i demonstroi energjitë e saj, shpresat dhe shqetësimet. Ky poem i Shabanit sikur të kishte dalë nga kapota e *dasmës tragjike*

Resul Shabani “*Ëndërr e falur*”/Podaren son

POEZI ME SHKËLQIME DHE HIJE

Nga Sande Stojčevski

të Lorkës. Këtu bukuria (*Nusja jonë e Bukura e Dheu me velin e bardhë si bora...*) është në një farë lidhje të paparashikueshme dhe të fshehtë me një kalorës të zi, prejardhja e të cilit, në njëfarë dore, është e paspjegueshme dhe enigmatike, pasi ai shfaqet nga një anë që s’pritej, në një këngëtim ku demonstroi atmosfera tradicionale përrallore. Paramendoni, ... *Iku nga faqet e librit kalorësi dhe u doli/ Krushqve në ballë, e u tha: / Nusen që po merrni, nëntë vjet e nëntë net, e prita Unë!* Tani lexuesi, me të drejtë, është hutuar dhe me shqetësim pyet: Kush është ky kalorës?, i kujt është?, është kërcënim për bukurinë dhe për kolektivin, ose është inkarnim i tyre, dukuri materiale e frymës së traditës së tyre? Do ta kishim lutur lexuesin, duke ia përkujtuar rregullin themeltar të sigurimit kur ke të bësh me krijime të magjisë së shkallës së lartë lirike: mos shpupurisë, le të mos e ndezë dritën derisa zgjat ësndrra shumë e bukur, të cilën poeti e ndanë me ne. Le t’i besojë, le të mos kërkojë shpjegime, le të mos dyshojë, prandaj nuk thuhet kot: se ka diçka nga religjioni në krijimtarinë poetike. Por, ka diçka në këtë poezi moderne të Resul Shabanit nga prurja e madhe paraardhëse lirikopike, nga kënga *ballkanase* e Konstantinit dhe Doruntinës, në të cilën përgjërimet njerëzore e lënë anash, e fshijnë kufirin midis jetës dhe vdekjes, prandaj të vdekurit dhe të gjallët, të paktën brenda një sekuence të shkurtër kohe, ecin bashkë, udhëtojnë motra me vëllain, kalorësi i zi, i posadalë nga varri, në të cilin papritur kthehet përsëri. Kalorësi ynë i zi, ky i këtushmi, ky flakërim i vërtetë lirik nga kënga popullore, i ndjek veprimet e paraardhësit. Poeti këtë me

mençuri na e komunikoi përmes pyetjesh që, në të njëjtën kohë, janë të tijat, por edhe tonat:

*Po ku mbeti kalorësi i zi?
Mos e lëshoi toka?
Si pas tërmetit, si pas ëndrrës së ligë.
Ç’ ishte ajo hije kalorësi, që krushqve u kishte pri?*

Kurse nusja, e cila i zbulon para kolektivit, para krushqve të gjitha vrytytet dhe të gjitha shtresimet shpirtërore, dhe që ia del të nxjerrë shpirta misteriozë nga përrallat dhe nga faqe librash, është e nevojshme dhe duhet të përmendet qysh në fillim të këngëtimt, por kjo duhet të bëhet me pashirrmë, më lëvdatë, me pikëçuditëse:

*Nusja jonë, moj nusja jonë!
E syrit tim, bebëzo!*

E kotë, s’duhet për të flitet, sidomos të këndohet me ton të qetë dhe me zë të prajshëm, aq më tepër me indifrencë, dhe jo me qetësi. Jo e jo, asses! Vallë, a nuk është kjo bebëza e syrit tonë!

Dhe ç’ pritet prej asaj shkëndije hyjnore, çfarë veprimesh duhet ndërmarrë, çfarë ilaçesh duhet sjellë, çfarë mrekullishë duhet shpërfaqur në grinë e përditshmërisë të jetës së rëndomtë?

Pritet ta çelë ambisin e brendshëm të atij, të atyre që presin madhësi, festa dhe çudira, që i bartin të gjitha këto gjëra në thellësinë e tyre, dhe se, vetëm me dorën e bekuar të bukurisë do mund të shfaqen në dritën e ditën. Do lexojmë pashirrmën:

Ma nxir moj, këtë thellimë!, se atje brenda, aty

poshtë, ka mjedise, peizazhe-vezulime:

*Kam një krua,/një oxhak, pyll të errët.
Kam driza shumë, driza gjemba.
Edhe qengja.
Kam at shale dhe mëshqerra.*

Shikoni se në ç’mënyrë dinake poezia i ka vendosur gjithë këto pasuri në një mjedis me hije, ndërmjet fantazmës së trimit dhe peizazhit real të mjedisit, dhe na bëhet e dyfishuar me vëllim dhe me thellësi, në mënyrë të mjaftueshme e zëshme dhe qartë për t’u kthyer tek ajo, por gjithashtu mjaftueshëm enigmatike dhe me hije, për të premtuar shpresë dhe mall, të përshfaq madhësi.

Me të vërtet, lexues i çmuar, nuk haset shpesh një poezi sa joshëse, aq misterioze dhe jo transparente, plot me hije dhe vezullime, me pashirrma dhe me heshtje të zëshme, me vesë nëpër shkurre dhe me yje mbi kokë, me at, me trim dhe me pushkë; me gjergjef, puthje dhe zjarr. *Gota gjysma me raki e gjysma me magji*, të rikujtojmë këtu vargun e një kënge popullore maqedonase.

U zgjatëm si shumë te kjo poezi, edhe pse, nga ana tjetër, ndiejmë se edhe kaq sa folëm nuk mjafton, meqë nga çdo varg i ri, pas çdo rikthimi, poezia na rizbulohet me befasi lirike të rangut të lart, ose, si çdo të thoshte poeti, *me pika të reja të ujit të shenjtë*.

Bile, të gjitha poezitë e këtij libri të Shabanit, në këtë ëndërr të veçantë të falur, janë të mbarsura me veti të këtyre vargjeve në të cilat mbretëron bukuria, nusja, hej, *bebëzë në syrin tonë*. Kurse ne duhej ta dinim se ëndrra të këtilla do të na dhuronte poeti që me aq lehtësi hapëron nëpër *Rrugën qumështore*, nëpër *Kashtën e kumtrit*, me fantazi të bujshme, dhe mban mend e mban mend, e asgjë nuk harron, gjithçka që përbën material të fortë lirik e ruan që të ndërtojë poezi joshëse:

*Ora e mirë e kujtesës
Loz me mua
Si me mollën e falur*

E thamë se poezia e Shabanit është shumështrësore, shumëdomethënëse dhe ajo rëndom është e lehtë, dhe di në mënyrë të natyrshme të krijojë amalgam prej buzëqeshjes, prej pashirrmës dhe prej dhembjes, por nuk e përjashton as nënqeshjen, aluzionin dhe ironinë. Prandaj përjetohet në mënyrë kaq të përgjithshme dhe kaq komplekse. Nuk mbështetet vetëm tek ndjenjat dhe nxitjet elementare, asaj nuk i mjafton vetëm klithma, pashirrma dhe psherëtimë. Poezia e Shabanit, aty për aty, shndërrohet në një interpretuese subtile, por shpesh herë, edhe të ashpër mbi raportet dhe gjendjet, prandaj edhe thërreth, zgjon dhe tërheq vërejtjen, del në krye me vetëbesimin e saj, duke u mbështetur te informimi dhe erudicioni, si psh., tek poezia tepër e guximshme, e intonuar në mënyrë ironike: “*Diçka po ndodh në skenë*”, në të cilën pa hezitim poeti deklaroi: “*Ne presim me erudicion*”. Kjo poezi e guximshme e poetit tonë në mënyrë të hapur dhe kryengritëse thërret dhe, sikur godet me grusht mbi tavolinë, duke pyetur:

*“Përse nuk ngrihemi e të shohim se ç’ndodh?
Të dalim edhe ne njëherë në skenë!
Dhe aktorët që na lodhën me fjalë
Le të ulen e le të na dëgjojnë.”*

Dëshmohej se poezia e Resul Shabanit si zonë të sajën intime e konsideron ëmbëlsinë, butësinë dhe brishtësinë njerëzore, por në të njëjtën kohë edhe kundërshtimin, protestën dhe kryengritësen. Ndërton me rreze dhe me muzg, duke na u drejtuar me buzëqeshje dhe me ironi, por gjithmonë me respektin e thellë. Prandaj nuk ka dyshim: nga ana e lexuesit do ta marrë edhe atë që i ofron.

Qe, ky është raporti vlerësues për tundimet e rralla me këto poezi të pa zbutura të Resul Shabanit, raport i cili refuzon të zbutet dhe të qetësohet, të shtrihet në një marrëdhënie kritike të rëndomtë, por i rrëmbyer dhe i magjepsur i përcjell poezitë dhe me këmbëngulje huazon prej tonit dhe zërit të tyre, pastaj çlirohet, dëshiron të përshtatet me to: me poezitë, hej, poezitë, këto ëndërra të falura! Dhe këtu e kemi fjalën për poezitë *Agu në liqen, Mesnata nëliqen, Albumi dhe Fytyra të bukura, Kumria, Babai, Poeti në vizitë*, por edhe për ato fjalë të mençura të akademik Ali Aliut, i cili te poezia e Shabanit heton edhe veti efikase shëruese, në mesin e të cilave e veçon ironinë. Prandaj do t’i japim liri vetes



që përfundimin e kësaj përfolje të shkurtër për poezinë e Resul Shabanit të vëllimit “Ëndërr e falur”, ta përbyllim me huazimin nga parathënia e akademik Aliut, i cili në mënyrë precize dhe piktoreske e pëshkruan:

“Impulset që dallgëzohen nga kjo vatër e gjallë, e bartin poetin mbi duar, shndërrohen në çaste në sytë e të dashurës së parë, në pëshpërима të përhershme dallgësh të liqenit, në shenja të thella e të fshehta të tij, në zhurmën e dasmave dhe krushqve dhe kallamit, në kallamin që në mënyrë magjike shndërrohet në fyell që mbetet gjithmonë i zgjuar...”

Na mbetet vetëm të dëshmojmë se fyelli magjik prej kallamit lirik të liqenit, nxjerr zëra të tillë magjikë, zëra plot “me pëshpërима dallgësh liqeni” dhe me “shenja të thella e të fshehta”. Pikërisht gjurmini pas këtyre shenjave dhe ngulmimi që ato të interpretohen, do të thonë kënaqësi e madhe për lexuesit e këtyre poezive të Resul Shabanit.

(Marrë nga libri “Svetot i tekstot” (Bota dhe teksti), “Dijalog”, Shkup, 2016, fq. 78-83’ (Përtheu Aulona Trimçe)

Resul SHABANI

PËRSIATJE TRI DITË PARA VJESHTE

Derisa unë ngrys ditëvjshtën e vakët
Te këmba e urës së ujit,
Urës me dërrasa të çara
Prej marrëzie, prej mërie - xhelozie,
Urës me parmakë dafine
Prej mirësie, prej bukurie - dashurie,
Mbi të cilën shkel këmba jote e bukur,
Nën të cilën noton krahu yt - flutur;
Ti shpërndan mjegullën e dendur,
Prej portretit tim të venitur.
Po ti, sirenë vale, zanë dallge, orë liqeni
Ti, nuse nuri, nuse syri, nuse zhuri;
Ç’kërkon në varfërinë time
Më të varfër se varfëria?
Derisa ti mbjell luleborën
Në shpirtin tim të shkretuar,
Sjell filad pranvere
Në vjeshtën time të vonuar,
Unë s’jam i zoti të të fal
Asnjë ëndërr për ta ëndërruar,
Asnjë shpresë për ta shpresuar,
Veç një tufë rrezesh,
Që as dritën s’e ndriçojnë,
As terrin s’e zbardhëlojnë
Dhe një qiri të ndezë me lutje Shën Mërisë
Syri i keq mos të të shohë, sy i keq i xhelozisë.

Strugë, 18. 09. ‘12

Tri balada

BUZËMBRËMJJA NË LIQEN

Nusja jonë, moj, nusja jonë! E syrit tim, bebëz-o!
Hajt! Më gëzo me një djalë, bajrak hedhur, dre
Në fushë. Sypishë, moj, qafëgastare. Hajt, më
gëzo!
Ma nxirr, moj, këtë thellim! Copë e grimë e copë
E grimë. Oj e bardha, moj e zeza. Kam një krua,
Një oxhak, pyll të errët. Kam driza shumë, driza
gjemba.
Edhe qengja. Kam at shale dhe mëshqerra.
Nusja jonë je, moj, nusja jonë. Dash
bishtmëndafshin
E shes për ty; e qes pushkë e qes allti; e shkel
malin
Edhe fushën, bëj mrekulli.
Krushqit u nisën të gëzuar, me lodra e këngë.
U kthyen me mëngjesin, me vesën që u kishte
Rënë mbi flokë e vetull. Ecnin buzëliqenit
Të heshtur ; ecnin si mesdita parahistorike.
Sazexhinjtë mbanin veglat në krah, e ecnin
Kokulur, të ngrysur. Ishte karvan i çuditshëm.
Bajraktari në ballë, po flamurin s’ia merrte era.
Pas tij vinte një kalorës, mbi kalë të zi.
Të tjerët, dasmorë, këmbësorë të zymtë,
Shkonin prapa kalorësit. E prapa kalorësit
Shkonte nusja fytyrëshpaluar. Me velin e bardhë,
Si bora. Iku nga faqet e librit kalorësi dhe u doli
Krushqve në ballë, e u tha:
Nusen që po merrni, nëntë vjet e nëntë net, e
prita Unë!
Kishte rënë pluhur shekujsh mbi teshën e tij.
Nga larg dukej si gogol orizoresh jugu.
Nusja jonë, e Bukura e Dheut, me velin e bardhë
Tani i shkonte prapa faqeshpaluar, ballëhënë.
Krushqit e ndoqën deri te pirgjet e dritës.
Dikur u dukën çati fshati me kashtë e me gjela.

Në kodër u ndal karvani, i çuditshëm.
- Po gazet përse nuk dëgjohen? Ej!
Vërtet dasmorët, krushq e fshatarë bashkë,
Dolën në kodër. Për kalorësin dikush tha:
Pas nëntë vjetësh e nëntë netësh, e gjet’ fatin e
vet!
Po ku mbeti kalorësi i zi? Mos e lëshoi toka,
Si pas tërmetit, si pas ëndrrës së ligë.
Ç’ ishte ajo hije kalorësi, që krushqve u kishte pri’?

MESNATA NË LIQEN

Nusja jonë, moj nusja jonë! E zemrës sime plagë
e flakë.
Dilemë ditë, dilemë natë! Rridhmë përrua;
ftohmë krua.
Më vë në ballë akull, leckë, më vë në plagë lule
nepërkë.
Më lidh prush, më zgjidh nur,
Ma bëfsh shtëpinë këshqjellë me gurë.
Nusja jon, moj nusja jon: ditë e cektë, e bukur-o!
Djersë e ballit e tim biri! Nusja jonë, o!
Del si hëna pesëmbëdhjetë. Del si selvia me fletë.
Del me yjet, del me strallin, del me djalin del me
mallin.
Barit natën binte vesa, yje binin mbi gjergjef.
Syprinë liqeni si kristali; yll drite në gjerdek.
Dasmorë e krushq i digjte hëna në fitil kënge.
Kur dikush thërret: Po nusja fatin a e gjet’?
Pastaj të gjithë u kthjelluan se kishin gabuar.
Kalorësi gogol s’kishte dalë nga faqet e librit.
S’ ishte parë as kalë i zi, as kalorës pluhurosur.
Vetëm veli i nuses zbardhëllonte natën.
Mos vallë, Plaku përrallë tregoi, gjersa dhëndri
Në gjerdek puth mjaltë me gojë e ndez flakë me
sy.
Nata dremiste mbi liqen, fëmijë e peshq flenë
mbi bar.
Digjet pisha, digjet drita, digjet goca, piqet fiku
- Po ç’patët? - i pyeti një mëndeshë krushqit e
ngrysur.
Hija e kalorësit na ndjek. Qe ku rri maje kodre,
Pikë nate, shaluar mbi kalin e tij të zi.
Duket se gjuha e agut e ëndërronte si shtyllë
pupri.

AGU NË LIQEN

Nusja jonë, moj nusja jonë! Pus me ujë, mullar
me bar.
Arë me farë, hambar me misër; perri me hire;
Bebëz o, mall i djalit; djep i arit; pluhur yjesh;
emblemë.
Gojëkuti. Gëzo mal e gëzo fushë. Ma nxirr këtë
thellim!
Kam shkumb në gojë, dua vesë. Më gëzo me një
djalë!
Limon në fytyrë, në shpirt kam valë.
Kur doli dhëndri prej gjerdeku, të gjithë plisat
E agut kishin zbardhëlluar mbi syprinën e
liqenit.
Dasmorët po flinin mbi barin e tharë
Doli dhëndri prej gjerdeku, krisi pushka
-A bën t’ia nisim dasmës? - pyeti Plaku i shpatës,
-Apo t’i ndalojmë lodrat? Si doli nusja?
Dhëndri u zgjua me këngën e këndesave të
sabahut.
“Mos piqeni kafe të hidhëta!”-tha poeti. Një djalë
Si bajrak po hidhte valle midis logu. “Pritni, pritni”, -
Tha poeti. “Tash fillojnë shirat e vjeshtës. Liqeni
Bën dashuri me retë e larta!”
Te kroi i fshatit do të rrijë një djalë me një vajzë,
Një plep i gjatë, një tufë e bardhë, një govatë
druri.
Një gurrë do të marrë udhë liqeni. Një arë do ta
Pjekë farën. “S’ka një vjet, do t’i thotë djali vajzës,
“Që u mbushën aq shumë vjet, kur im atë mori
Rrugën e kurbetit. S’ka një vjet, do t’i thotë djali
vajzës,
Që u mbushën shumë vjet, që kur hija e një
kalorësi
Erdhi dhe e dëgjoi vajin tim të foshnjës në djep.
Te kroi i fshatit i zuri vera dhe i shkroi në librin
E shenjtë të rrufeve. Një Afroditë dhe një
Apollon.
Kurora lule nepërke kishin mbirë mbi kokë. Se
poeti
Përsëri tha: “Lulja në kokën e gjarprit s’ka bukuri”.
Zbritnin drejt vjeshtës, kah fshati e në sheshin
e tij
Dasmorët po prisnin të merrnin rrugën e gjatë
buzë
Liqenit, pas kalorësit që doli përsëri nga faqet e
verdha
Të librit dhe me gojën e Plakut, dasmën e
zbukuroi.

Mbi librin “Kalendari i ëndrrave të mollës”
të Natasha Shuteriqi Poroçanit

Kush lexon mirë, mendon bukur

Prof. as. dr. Helena Grillo

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Libri “Kalendari i ëndrrave të mollës”, fitues
Li Panairit të Librit 2022, ka hyrë tashmë
në shtëpitë e fëmijëve. Libri i këndshëm është
ndërtuar mbi një bashkëbisedim imagjinar
të pemës së mollës me fëmijët.

“Përsëndetje. Ma dëgjon zërin? Unë jam
një mollë e re. Nuk më sheh? Epo jam këtu nën
dëborë...Që ta dish ti, unë kam ca ëndrra të
bukura, plot ëmbëlsi dhe lëng. Dua të t’i tregoj
edhe ty, se gjërat e mira unë asnjëherë nuk i
mbaj për vete. Afrohu pak. Eja dhe bisedojmë
ca së bashku!”

Cilat janë ëndrrat e pemës së mollës që
rriten muaj pas muaji brenda trupit të saj, për
të shpërthyer pastaj në formë lulesh e kokrrash
të ëmbla, të kuqe gjak? Janë frutat e saj, mollët
që gëlojnë brenda trupit të pemës që në dimrin
e vonë, për të shpërthyer në pranverë.

Këtë moshë biologjike të një peme, autorja
e paralelizon me gjithë sa ndodh në jetën e
fëmijës.

“Shkurt
Oh, sapo hapa sytë....është ende ftohtë.
Në krahë ndjej sythet që duan të shpërthejnë
dhe vazhdoj të ëndërroj...”
-Si është koha tek ti?

Ke bërë ski? Më trego pak se ku ke dëshirë
t’i kalosh këto ditë të bardha të dimrit.”

Libri përbën një instrument praktik për të
edukuar te fëmijët aftësinë e bashkëbisedimit
si dhe zhvillon te ta të menduarit kritik. Në
sajë të strukturës së tij interaktive fëmija merr
koncepte të shumëfishta: *nëpërmjet rritjes
biologjike të pemës së mollës, fëmija mëson atë
çka ndodh me natyrën, me trupin e tij, dhe me
përditshmërinë e tij në komunitetin ku bën pjesë.*

Gjuha e thjeshtë dhe e këndshme e librit,
konkurron me modesti gjuhën e fëmijëve dhe
mënyrën e tyre të të vështruarit të botës.

“Qershor
Ja, dhe ëndrrat e mia erdhën. Kujdes, mos
m’i këput kokrrat e mollës se janë ende të
vogla. Më të vogla se sa ti.

-Ëndrrat e mia janë këto kokrra të kuqe
plot lëng. Po ti çfarë ëndrrash ke?”

Ky tekst, gjithashtu shërben si një
instrument shumë i mirë dhe i rëndësishëm
për mësuesit e parashkollorit dhe ciklit fillor.

Nëpërmjet tekstit “*Kalendari i ëndrrave
të mollës*” mësuesi:

- duke analizuar mënyrën e komunikimit
letrar dhe joletrar të gërshtuar në tekst,
identifikon një nga rrugët drejt formimit të
tij, dhe në aspektin instrumental të letërsisë
për fëmijë në veçanti, nis të orientohet
në produktet më të afërta gjuhësore për
fëmijërinë e hershme;

“Mars
Uaaa ndje se po më vlon gjaku i ri nëpër
degë. Sythet kanë mbushur degët.

-Unë e di që në muajin mars ka disa festa
shumë të dashura. Cilat janë ato? Një mollë
ka shumë dëshirë të dijë se cilat janë këto
festa.

Më trego , të lutem, ç’po përgatit për
festat?”

- duke analizuar *simbolikën* e figurës së
mollës, si dhe duke vlerësuar *personifikimin*
që sjell dialogimi i saj me fëmijën (si individ
social), njeh elemente të stilistikës në aplikim
si dhe kategoritë pedagogjike të qasjes së
letërsisë për fëmijë, apo kompleksitetin e
imagjinatës veçanërisht në lidhje me
fëmijërinë e hershme;

“Prill

Më në fund! Jam mbushur me lule.
Ëndrra ime po vjen në botën e bukur. Sa më
pëlqen klur ëndrrat bëhen të vërteta!.

-Po ditët si janë për ty në pranverë? Si
janë lulet? Po aroma e luleve të pëlqen?”

- njeh dhe zotëron mjete interpretuese që
shikojnë pluralitetin e gjuhëve të letërsisë për

fëmijë, për kompleksitetin e të cilave fëmija
është ende i pavetëdijshëm;

“Gusht
Jam e lumtur me fustanin tim të gjelbër
plot kokrra të kuqe.”

- duke vlerësuar cilësinë e pyetjeve
dialoguese me fëmijën-potencial, di dhe
është në gjendje të përdorë dhe të thellohet
në mënyrë të pavarur në fushat kryesore
praktike të referencës, në fushën pedagogjike
dhe psiko-pedagogjike në lidhje me linjat e
zhvillimit të fëmijërisë së hershme. Po ashtu
bëhet i vetëdijshëm për kryqëzimet që i
përkasin narrativës letrare për fëmijë;

- njeh kontributet themelore praktike në
marrëdhëniet edukative brenda komunikimit
gjuhësor të fëmijërisë së hershme;

nënteksti dhe gjuha e alegorisë së thjeshtë,
ndihmojnë mësuesin të planifikojë shtigje
narrative të përqendruara në stilet tipike të
aleancës edukative në momentin e rrëfimit:
dëgjimi i ndërsjellë i rrëfimit,

rrëfimi me gojë,
leximi me zë,
shikimi i ndjeshëm,
pranimi i gjuhëve verbale, joverbale dhe
ekspresiviteti,

vëmendja dhe përqëndrimi;
- kjo përvojë do ta ndihmojë mësuesin
të bëjë zgjedhje të informuara në fushën e
produkteve editoriale të letërsisë për fëmijë
dhe të orientohet në mënyrë kritike dhe të
pavarur në shumëllojshmërinë e degëve të
rrëfimeve të propozuara nga media.

Si vlerë e shtuar e këtij libri vjen *ilustrimi*.
Fëmija tërhiqet instinktivisht nga gjurmët e
lëna në letër, si gjurmët e tij që transformohen
dhe modifikohen në vija, goditje, pika, forma
që janë gjithnjë e më afër realitetit. Këto
gjurmë në tekst janë tablo të realizuara me
aq mjeshtri nga piktori Arben Nipolli, i cili
me mjeshtri ka aktivizuar fjalën në ngjyra
dhe peizazhe që ndjekin natyrën dhe mishën
e ëndrrave të mollës. Ngjyrat janë imazhet e
transformimit që pëson pema e mollës dhe
rugës së saj drejt realizimit të ëndrrave.

Penelatat e holla u atribuojnë edhe fjalëve
një konotacion afektiv, u shtresojnë të tjera
valenca shprehëse.

Për kaq e jo vetëm jo vetëm për kaq:
për një prindërim të mirë bashkëbisedues,
“Kalendari” nuk duhet të mungojë në
bibliotekat e familjeve...edhe kur ajo fle gjumë:
“Dhjetor

Po më flihet. Do të shoh përsëri ëndrrat e
pranverës. Ëëë,tani ..më trego ...për festat
e tua...

Gjumë të ëmbël, mollë e dashur!
Shëët! Mollën e zuri gjumi.

Shkruaji përgjigjet e pyetjeve që të bëri, në
mënyrë që, kur të zgjohet ti lexojë. Me siguri
do të gëzohet shumë.”



Lëhonë, u përmendë nga një pëshpërimë Lqë jehoi arteriesh teksa gjaku i parë mëmësor pulsonte limfë prilli: “Pa shih një herë...në sqetullën e fëmijës...”, iu bë se dëgjoi.

Më herët, deri një vit më parë, vetëtinte vajzë, më pastaj - deri para disa orësh bëri gruan.

I ishte gëzuar çdo ore të atyre viteve si dritës së diellit, gjer në çastin kur - hap e mbyll sytë- iu bë se i humbi të gjitha. Mbase si mënyrë e vetme për tu bërë nënë.

Pëshpërima po i bënte të ditur se si e deri-atyshme nuk ishte e tëra. Në lojën “fito duke humbur atë që kishe”, dukej se merrnin pjesë tërë femrat e kësaj bote.

Që po e ftonin të hidhte një sy nën krahun e bebit të vet, dukej se kishte diçka të posaçme, për të. Mezi-priti të mbetej vetëm, u ngritë, mbylli derën, u mbështet për pak në kanatin e saj, mori frymë thellë, u sigurua që edhe dritaret, grilat e perdet në to, qenë mbyllur.

“Mua më gjete, Zot?!”

Erdhi te shtrati dhe e rrotulloi me kujdes trupin e bebit, si një kukull, taksur për të prej kur qe gocë e vogël fare. Biri fërgëlloi, u shtriq i tëri dhe gugati, sikur ia ndjeu merakun prej nëne në preken e duarve. Si nënë, qe gati të pretendonte se ia dëgjoi atij edhe guakjen “ma-ma”, por kurrë-kush s’e pyeti- ishte fare vetëm aty, por asaj i mjaftoi pandehma e vetë.

“I je Nënë”, i tha vetes. “Nëpërmjet tij, u bëre Nënë! Përmes teje, ai zbriti këtu, në këtë botë, që ka nisur të bëhet e tij!”

Para se t’i ngrinte krahun, i mbylli edhe një herë sytë, vetëm për pak, që të mund të shihte më mirë kur t’i hapte. Që të provohej pëshpërima që e zgjoi, dhe ta shihte të vërtetë ç’i ishte ormisur nën krah. Si në fëmijëri në “lojën me shpia”, edhe tani, bëri t’i hapte sytë ngadalë, me frymën nën kontroll. Vetëm e vetëm që, kur të shihte shenjë që mund të ishte, të mos trembte engjëllin në të...

Sytë i shërbyen përtej merakut prej nëne dhe ajo pa, nën sqetullën e birit, një bisk të kaltër, si krah zogu sa-lindur...

Nuk e mbajti dot veç për veten, siç e dinte se këshillohej kërcënueshëm në këto raste. Ia tha, në moment, birit, atij vet. Me zë të ulët, edhe ajo, që vazhdim i pëshpërimës që dëgjoi të ishte, aq sa ta dëgjonte vetëm ai. Ia tha se ai ishte lindur me shenjë, se ajo e kishte lindur me shenjë!

Ngaqë ende s’fliste, mbase as dëgjonte, s’priti reagim prej tij.

Ishte shumë herët të pritej a të rrëfehej mirënjohje a sëkëlldi prej shenjës origjinare. Për gjithë urimet a bekimet, do vinte ngeja të urohej apo mënohej, apo të falënderohej kohë më vonë. Ajo ishte ende nënë e re, e sapo...siç ai bebush i ri, i sapo...!

Si tërë fëmijët e botës, do mbushej me ditë, me orë do rritej.

Kur më në fund ajo u bind se e kishte fëmijën me gojë e veshë, kur ndjeu se edhe vet ai po i gëzohej trupit të vet, po u besonte gjymtyrëve, më në fund fare, pra, kur ndjeu se s’ishte mirë të shtyhej edhe më, ngaqë e keqja prej nishanit nën krahë mund të ndodhte në orën tjetër, gjeti rastin t’i rrëfehej, t’i shpjegohej birit. Për shenjë si fat, që mund të kthehej në brengë. Këtë të fundit mbase nuk do t’ia thoshte.

“Je lindur me shenjë, bir!”

U përpoq t’ia bënte sa më të qartë, atë që as ajo vet s’e dinte, së paku jo aq sa i duhej si nënë. I tha birit atë që paskëtaj duhej ta besonin dhe bindeshin të dy. Si një urdhri lufte që mund të niste fill momentin tjetër.

“Askush s’duhet të ta shikoj shenjën, askush veç meje...” shtoi, edhe pse ai as do ta kuptonte merakun e saj, as do ta ndihete veten.

Deri atë ditë, edhe ajo, me të dëgjuar e kishte: foshnjat ezhderha apo dragua të sapo-lindur, u pështillej në trup një si cipë e hollë. Lindur me këmishë, thuhej, si me fat, të veçantë. Në asnjërin variant, në



Faruk Myrtaj

KRAHË ZOGU TË SA-LINDUR

Tregim

asnjë gjuhë të botës, nuk quhej “fat” edhe për nënat e tyre. Atyre u ishte lejuar t’ua shikonin shenjat, krahët si të zogut, në këtë rast, pa pasojë në ta.

E meku frymëmarrjen duke e vështuar më nge, ia preku lëkurën kudo, por nuk shqoi ndonjë cipë në të, siç thuhej. Më në fund, iu bë se e pa...Mbase sytë prej nëne qenë veshur me cipë, që ajo ia kundroi mugull, si me cipë, edhe trupin. Ngaqë mezi e kishte pritur, iu dorëzua ndjesisë se ia preku cipën si napë djathi. Madje ishte fati të besonte se, që ta mos ia shihte ndonjë nga kureshtaret, mund t’ia hiqte cipën, t’ia paloste e, pasi t’ia mbështillte në një tjetër napë të bardhë, mund t’ia vendoste poshtë jastëkut, si lodër, në kryet e djepit.

Dy pika qumështi nëne të re ia njomën fustanin e hollë, kulluan dhe ranë mbi lëkurën e qashtër të bebushit duke u bërë edhe ato në çast të padukshme...

Në njërin prej rrëfimeve për këto shenja hyjnore që, prej ditës së lindjes së birit, veshi i saj i tërhiqte si magnet, thuhej se bisku nën krahë zakonisht kishte ngjyrën e syrit të nënës.

Këtë variant e dëgjoi edhe nga fqinja matanë dritares, por bëri sikur s’kishte lidhje me të. E mbylli shpejt dritaren e andejshme por, njëlloj si në vajzërinë e hershme - kur për herë të parë dikush ia përmendi si edhe të sajën bukurinë, edhe tani nuk desh t’ia privonte vetes shtysën për tu gjendur përpara një pasqyre.

Iu afrua sa mundi syprinës së qelqtë, syri thuaj e preku syrin shembëllues në qelq, afërsia vetiu u kthye në largësi dhe befas ajo u tërhoq, sikur të kishte mëkatuar.

Vërtet aq e bukur t’i ishte ngjyra e tyre... si pigmenti i cipës së birit?!

Ngriti kryet për nga qielli dhe pyeti, sërish në qartësi të pa-adresuar: “Vallë do mund ta ruaj fshehtësirën tënde?!”

Prej atij momenti, prej orës së parë të

ditës së parë të jetës së atij që kishte sjellë në jetë, i duhej t’i gjendej pranë, pa pushim, pa asnjë bosh, pa asnjë ndërprerje fryme. E drejta për prani nëne për secilën grimasë, kërkohet si vigjilencë ekzistence, në rastin e saj. Askush s’do duhej të mbetej vetëm me birin e saj. Kurrkush s’do lejohej, as edhe rastësisht, t’ia shihte shenjën...

Në secili zgjim të beftë, të jetës që kishte sjellë me shenjë, do duhej t’i ishte aty. Përjetshëm.

Përjetësisht?!

“Jo, jo, kam frikë se mori për keq mendja ime!”, shtoi fill më pas.

Pa asnjë të keq, nxitoi ta tjetër-thoshte atë që kishte ndërmend, në shpresë të ngutshme dhe të pastër se nuk ia kishte ndërjerë kurrkush. “Thashë t’i jem birit, aq sa t’i duhem, kaq. E përhershme për të, vetëm sa për të. Aq sa duhet në roje të shenjës së tij...Nëse do guxoja ta lypja, përjetësinë, do ta bëja vetëm për të...”

Sikur u egërua me veten ngaqë s’ishte kollaj ta urtonte pulsën, edhe pse s’e kishte zënë ngoje ngjatjen e jetës si si gjallje e vetes. Si mund ta bënte nëna për birin?! Për gjithë nënat, në gjithë vajtje-mendjen e pa pushimtë të tyre në rreziqet për ta, ekziston pafundja, përjetësia e fëmijëve. Në këtë kahe, nëse pikërisht kjo lloj tej-gjatësi jete mirëkuptohej, vetëm për fëmijën, do mund të pëshpëritej ndonjë lloj marrëveshje, pajtesë për kohën që nënës i duhej të mos-mbyllë sytë në ruajtje të fshehurës së kaltrës, është fjala...

“Jo, Zot, s’kërkova shtesë jete...”

Duke i qenë pafund mirënjohëse Atij, përpiquej ta zinte sa më rrallë ngoje. As edhe, si në këtë rast, me pretekst birin. Ndjerë e privilegjuar prej Tij, ende s’kishte gjetur kohë t’i rrëfente mirënjohjen për zgjimin nënë, kur po i pëshpëritej privilegj tjetër, në të kaltër!

Jam nënë, mos qofsha...s’ri dot pa të pyetur: çdo bëhet me të...me ikjen time?!

Tërë nënat ikin, moj qyqe, i a ktheu vetes, në hopin tjetër.

Tërë fëmijët e botës, edhe pa nënat jetojnë, shtoi ditën më pas. Dashke të mbetesh edhe vet, ngaqë është yt bir?! S’je edhe ti si gjithë nënat, që ikin para tyre?! Apo dashke ta privosh tët bir nga dhimbja për nënën?! E bukur mendje! Sjellëse e një Jete je, jo e për-gjithnjëshmja për të. Rrëfeja jetën atij, duke bërë gati ikjen tënde...

Gjithnjë siç thuhej, (sa shumë thuheshin për njerëzit me shenjë), nëse dikush e shihte, edhe pa dashur, njeriu-dragua a ezhderha ngrihej e ikte. Mbetej bosh vendi në shtrat... Si varr shenjtë, mbetej.

“Të gjithë, prej një gruaje vijnë, një tjetre i dorëzohemi,” kujtoi, sapo ndërmendi shtratin e të birit.

E ëma e vet kështu u drejtohej djemve-që ata do “dorëzoheshin” te gratë e tyre, por me që ishin aty, le ta dëgjonin edhe vajzat e saj, motrat e tyre!

Në gërricje të heshtur prej këtyre mbajtje-mendjeve, u kujtua se dikujt tjetër duhej t’ia rrëfente. Dikur, do ta ndante sekretin e birit me dikë tjetër; do t’ia përcillte merakun, pa ia rrëfyer vet shenjën. Kaq.

Tërë ditëve më pas, në pritje të Asaj Tjetrës të cilës do t’i dorëzohej Biri, mendoi çdo fjalë që do t’i thoshte dhe çdo habi që do qetësonte tek ajo.

Merret vesh që ia tha së resë, pa hyrë ende te Dhoma e Nuses, mbrëmjen e Altarit.

“T’i kthesh sytë nga ana tjetër, përpara se të hapet për ty krah i tij, më dëgjove?!”

Ia tha kështu me zë të butë, duke ia qepur sytë si një krijese që, në besim jete e dashurie, do i duhej parathënë që pa dashur mund t’i kthehej të birit rrezikuese e mundshme.

“As në gjumë s’duhet të të shkojnë sytë te nën krah i tij, as kur ai të përqafo, përhumbur në zjarrmi të hireve të tua...as kur ai do të dorëzohet me të dyja duart, rob dëshire dhe epje të bekuar, as atëherë mos ia shih fshehtësinë. I premtove në altar besë për ditë të bukura e të vështira, betohu se do ta ruash edhe si jetë rob të dorëzuar tek ti! Mos qesh, me fjalët e mia! Asnjë kuptim s’ka kërkimi i ndjesës më pas, jo! S’do ta falte as Zoti!”

Në vend të priste përgjigje, pas këtyre fjalëve, e shtyu lehtë për nga Dhoma e Nuses, ku dhëndër do hynte I biri. Po ia dorëzonte Tjetrës, birin e vet...

...

U ul për bri derës së Dhomës së Nuses. Aty do priste. Si nënë, nuk ndjehej në faj që shkonte ndërmend tërë rreziqet që mund t’i ndodhnin të birit. Pa asnjë dilemë, edhe kësaj dite. Kjo ezhderhaja, bijë e botës, qysh orën e parë mund të hidhte një bisht syri tek nën-krah i tij. Duke besuar se askush tjetër nuk do ta donte më shumë se ajo këtë engjëll, tashmë i saj, ajo mund t’i jepte fund tërë gjërave brenda një çasti.

Duke përgjuar te dera e gjerdekut, tërë natës, pa e kuptuar i ishte dorëzuar gjumit, por i ndjeu në çast kur dolën të dy nga Dhoma e Nuses. “Zot, m’i ke falur të dy, engjëj!” Biri ia fshihte sytë, i drojtur, se ajo ishte nëna e tij. Ishte e reja që i foli, fare afër veshit.

“Në gjithë legjendat, dragoi ka katër këmbë! Dy kishte yt bir. Dy të tjerat, janë të miat! Kam edhe unë shenjë time, që veç ime-më e di, por ia rrëfeva tët biri!”

Nëna dëgjonte nusen, por sytë i mbante nga biri. Dontë të sigurohej që e fshehura nën krahë, kishte mbetur sekrete.

“Dragoi në legjendat rron një qind vjet! Edhe kur ia shohin shenjën, ngrihet e ikën! Kaq! Në mungon ndonjë natë yt bir, do ta kem marrë unë e kemi dalë në pyll!”

“Mos e prish gojën, bijë! Bëj ç’të duash me të, veç mos ma largo! Sa të jem, ta di që është aty...”

Me Besmirin rrimë në një lokal buzë autostradës. Është kohë e ngrohtë me një diell rrezitës. Një lumë i shpejtë makinash vërshon në autostradë me një ritëm çmendurak. Ai më tregon për llojet e ndryshme të makinave, ndërsa unë sikur dua të gjej për ndonjë lloj të tyre teksa shoh këtë vërtitje të shpejtë në autostradën Tiranë Durrës. Mendja ime bredh gjetiu, në të kaluarën kur makina të tilla nuk shiheshin as në ëndërr. Dua t'i tregoj bashkëbiseduesit tim për atë kohë jo për tentimin që ta bind për diçka që ai mbase nuk e beson po për t'u çliruar nga feksja e një kujtese të pakëndshme. Dhe ia nis:

- Dikur, - them unë, - kur erdhi Fiati i parë në qytetin tim provincial, njerëzit dilnin dhe e shihnin me kërshëri, ndërsa sot kalojnë pranë makinave të shtrenjta dhe as u bën përshtypje...Njerëzit udhëtonin mbi karrocerinë e skodave dhe ngjisheshin në to si sardele. Ishte lumturi e madhe të gjeje një skodë apo t'i luteshe një shoferi që të lejonte të hipje në karroceri. Dhe, e gjithë kjo, sepse makinat nuk lejoheshin të ktheheshin private dhe as kishe mundësi t'i gjeje diku në treg. .

- Unë, - vijova , - jam nga katundi Katrenë dhe deri në qendër të komunës Libotik, katundi im mban tre orë në këmbë, në mos më tepër. Në çdo kohë njeriu ka nevojë të udhëtojë...Libotiku atëherë nuk ishte i lidhur me Katrenën me rrugë makine... Një ecje më këmbë nga Libotiku në Katrenë dhe anasjelltas ishte diçka e jo e paqtë, trishtuese, ndërsa duhej, patjetër duhej, të transportoje njerëz të sëmurë me vig për në spital...Gjëja më groteske që më ngjeth mishtë edhe sot qe se, në qendër të Libotikut vinte çdo ditë një autobus tridhjetë vendësh nga qyteti për në Libotik... Aty Këshilli i Bashkuar kishte përcaktuar një numër të saktë biletash. Ishin gjashtë fshatra që e kishin kryet në atë rrugë...Nga tridhjetë vende që kishte autobusi, mund të ndodhte të vinin dyzet nevojtarë për të shkuar në qytet. Autobusi vinte vetëm një herë. Ndodhte që nga një fshat(pesë biletat e tij mund të mos shiteshin) vinin vetëm dy, ndërsa nga fshati tjetër vinin gjashtë. Shitësi i biletave biletën e tepruar s' kishte të drejtë ta shiste. Nëse ai nuk i njihte njerëzit, atëherë kërkonte pasaportën... Dhe e gjithë kjo bëhej që njerëzit të mos lëviznin kot, të mos braktisnin vendin e punës...Nuk kishte rëndësi sa punonin, kishin marrë leje nga përgjegjësit a jo... Dikur - dikur edhe autobusi u hoq dhe njerëzit e shkretë nga Libotiku drejt qytetit shkonin më këmbë. Një torturë e vërtetë!...

Nuk e di pse më erdhi në kujtesë kjo e kaluar e trishtë, apo pse ndoshta shoh këto makina që ulërijnë si të hutuara dhe vërshëllejnë me gomat e tyre nervoze mbi asfaltin me arna.

Njerëzit e mi mitikë të ngujuar nëpër male jo vetëm që nuk lejoheshin të zbrisnin në qytet, por nuk mundeshin të udhëtonin drejt tij me makinë , veçse të ecnin më këmbë, herë- herë fshehtas, sepse ndodhte të spiunoheshin se kishin braktisur ditën e punës në fshat. Një kontroll i tejskajshëm, një evidentim i plotë i lëvizjeve, një shtrëngesë çmoblizuese dhe shpërblimi për ditë-pune fare qesharak , aq sa mund të blije me të vetëm një paketë cigare për të hequr pakëz mërzinë.

Kujtoj ngjarje të tjera më të hidhura dhe njëra nga fshati Oksh nuk më shqitet nga mendja. Fshati Oksh është ngjitur me



Qazim Shehu

QYTETI I NDALUAR

Tregim

Katrenën por i përfshirë në një provincë tjetër. Është një fshat me pyje shekullore, lëndina ujëra të kristalta dhe me dimër të egër. Aty stinët kanë kufi të prerë dhe nuk lozin me njëra- tjetrën. Mban dimër i ashpër... Shpendëria gjatë dimrit zbrit deri afër kullave , ndërsa ujku del në rrugët e fshatit në mes të ditës. Bora e madhe atëherë vinte si përherë, gati një metër e gjysmë dhe shkrihej vonë kur në fshatrat e tjera pranvera vinte me kohë. Sa herë më kujtohet peizazhi i këtij fshati ndërsa sjell ndërmend Faslli K i cili mbeti në dëborë për shkak të dimrit dhe jo vetëm.

Faslli punonte në qytet dhe po vinte Viti i Ri. Ai u nis drejt fëmijëve nga qyteti me dy orë ditë. Hipi në karrocerinë e një skode çeke dhe u mbështoll me mushamanë i ulur në një cep të karrocerisë. Punonte hamall te stacioni i trenit. Ishte i shëndoshë dhe i fortë. Era të priste brisk dhe makina hungëronte nën shiun që binte me rrëmbim. Kur mbërritën në Fushë Tundanë(emri i kësaj fushe ishte vënë mbase nga era që e tundte atë si gjethe në pëllëmbë të maleve), skoda ndaloi. Nga aty kishte filluar të binte borë dhe shoferi tha se do të zbriste. Ai nuk kishte marrë zinxhirë me vete dhe do të kthehej mbrapsht edhe pse mund ta kritikonin në ndërmarrje. Jetën e kishte të shtrenjtë. Ai i tha Faslliut të kthehej me të. Fshati Oksh nga Tundana ishte dy orë udhëtim me këmbë, po në atë kohë mund të bëhej edhe tre edhe katër...

Faslli duke menduar se bllokimi nga bora mund të zgjaste një javë apo dy dhe jo vetëm Vitin e Ri nuk do e festonte me gruan e fëmijët por edhe disa ditë pas tij nuk kishte mundësi të shkonte për shkak se bora mund t'i bllokonte makinat edhe

më larg fshatit se aty ku gjendej, atë çast vendosi të mos kthehej. Ishte i fortë dhe i fuqishëm dhe borën e kishte çarë si ari edhe më parë. Me vete kishte vetëm një elektrik dore.

- Guxim të tepruar ke vëlla, - i tha shoferi...

- Mos u bëj merak!, - ia ktheu Faslli, - jam i këtyre anëve dhe ia di borës...

Askush nuk e di sesi udhëtoi Faslli për shkaku se shoferi nuk kishte marrë zinxhirë me vete, ai nuk pati më gojë ta tregonte këtë. E vrau bora duke e lodhur vazhdimisht në atë rrugë, ia ëmbëlsoi ëndrrat duke ia pakësuar forcën ngadalë deri në fikje...Pastaj bora e mbuloi ngadalë në gjirin e saj ngaqë e donte shumë dhe e gjetën pesëdhjetë metra larg shtëpisë, pas dhjetë ditësh , pa jetë. Kishte kaluar Viti i Ri dhe Faslli nuk e dinte se fëmijët e tij e kishin festuar atë zemërthyer nga shkaku i mungesës së tij. Fshati nuk kishte telefon...

Nuk më hiqet nga mendja ai shofer që nuk mori zinxhirët...

Besmiri, si djalë i ri, këto mund t'i duken përralla ose sajime , ose të thëna si diçka për të mbushur pamundësinë e bisedës në ecjen e saj në një rrjedhë më të natyrshme...Ai më tha se këto mbase fryheshin, sepse sot gjithnjë gjendet një tendencë ose në psikologjinë e njerëzve rri gatshëm mikrobi ku një kohë e asgjëson tjetrën prej pafuqisë së saj për të rendur në plotësinë më të hijshme. Ç'fakt tjetër mund t'i sjell?

Mund t'i them për njerëzit që sëmureshin dhe mbarteshin në vig në krahë gjersa dërgoheshin deri në qendër të Lokalitetit ku vinte ambulanca e spitalit edhe ajo me vonesë dhe sa njerëz kishin

vdekur prej kësaj mungese të rrugës dhe të makinës, ndërsa rrugë bëheshin nëpër maja malesh për të mbjellë kërpuqha bunkerësh ose nëpër pyje të dendura , të cilat shfrytëzoheshin. Po nëpër maja malesh njerëzit nuk shkonin. Ata shkonin në qytet se atje i kryenin disa punë, atje kishte spital.

Mos vallë po bëhem retorist dhe po kaloj në një agjitim të panevojshëm për t'i mbushur mendjen një djali të ri i cili për atë kohë ka dëgjuar vetëm nga mësuesja e klasës të pestë. Por unë kam nevojë të flas. Në djall retorika dhe kujdesi racional dhe etik. Edhe unë, si njeri i atyre anëve e kam vuajtur sa herë mungesën e makinës dhe udhëtimin në këmbë, natën ditën. Vuajtja gjithnjë ka kujtesë emocionale të hidhur. Ajo nuk shlyhet.

T'i flas për radiot, për televizorët? T'i them që në fshatin tim televizori i parë erdhi kur vdiq diktatori? Atë e sollën me urgjencë nga rrethi dhe e vunë në qendër të fshatit. Njerëzit shkonin dhe shihnin kronikat e mortit duke qarë. Vetëm një "i marrë" nuk shkoi dhe përhap i lajmin e gëzueshëm se tani do të kishte televizor çdo shtëpi...

Njerëzve atëherë u ishte mpirë nervi i besimit. Qytetarët u dukeshin si njerëz që jetonin në një planet tjetër....

Por nuk dua të zgjatem në këto gjëra të njohura, të cilat sot arrijnë në kufijtë e një grotesku dhe marrin trajtë luhatshmërie përsa i përket besimit.

Besmiri flet për llojin e ri të makinave, ai sapo e shiti një dhe po kërkon në internet një tip të ri. Nuk mund t'i them mos e blejë, se ndërsa kujtoj ca fakte të hidhura të së shkuarës, sot , duhet thënë se makinat na janë mërëzitur...Ato gërvishtin ajrin, duke i kthyer rrugët në tuba gazi...Pa folur për aksidentet, për parakalimin me bori, për xhamat e errëta, për përplasje etj., etj..

Më ngjan se më janë shterur kujtimet dhe po flasim për diçka tjetër, kur shoh në anën tjetër të autostradës, një fshatar që mban përdore një lopë. Ai rri dhe vështron lumin e makinave që i sjell valët e tyre me ndërprerje, duke pritur që këto valë të vijnë më ngadalë dhe ai ta kalojë autostradën. Duhet të jetë ndonjë fshatar-qytetar i zonës së Kasharit. Me siguri. Po pse pret ai, kur mbikalimin aty e ka? Po lopën si do ta kalojë? mendoj...Dhe nuk vonon dhe lopa, (siç duket e mësuar edhe më parë) bëri këmbë dhe u ngjit në mbikalim.

E shihja lopën sesi ngjiste shkallët si ecte e qetë mbi mbikalim, shihja njeriun që rrinte dhe këqyrte lopën me kujdes, pastaj vetë, pasi priti valën e makinave të shteronte pak, me një guxim prej të marri, vrapoi, kapërceu ndarësen, priti sërish valën të shterte pak dhe ja, u gjend në anën tjetër e ndërkohë lopa po e priste e qetë në cep të autostradës...

Besmiri, që deri atë çast mbase nuk më ka dëgjuar me kujdes, pse koha e shkuar nuk është në interes të tij dhe tani nuk është në atë moshë për të dëgjuar "përralla" të tilla, befaz më sheh me vëmendje.

- Vërtet ai njeri qenka i krisur. Po sikur ta kishte shtypur makina... Larg qoftë o zot, po sikur atë çast të isha unë me makinë!

Dhe përfundon:

- Ka disa njerëz që s'e meritojnë qytetin kurrë!

- Jo, - them unë, - të gjithë e meritojnë qytetin, por disa nuk e kapin kurrë e të tjerë e kapin me vonesë...

Luis Sepulveda, 1949

USHTRIM NGA A DERI TE Z

Në Shqipëri
Në këtë orë një njeri qan
Për vetminë e një fotografie

Atë e ndan
Marrëzia kategorike e shekullit
Atë e ndan

Nga vetmia e një fotografie
Për të cilën një njeri tjetër qan në këtë orë
Në Zimbabve

(Nga “Antologji e poezisë kiliane”)

Bill Manhire, 1943

NË NJË BAR TË UDHËS SË QUMËSHITIT

Unë rroj në skaj të gjithësisë
Siç bën secili prej nesh. Nganjëherë them me vete
Se për këtë duhet të falënderoj jetën:
Unë kundroj yjet atje larg
Dhe i përpëlit lehtazi qepallat,
Zëri im nxjerr një psherëtimë të kënaqur.

Tërë kënaqësia ime vjen nga ajo që duket pak;
Më pëlqejnë gjërat e pabujshme.
Unë zbres në Galeritë e Muzgut
Dhe vështroj pushtuesit marsianë,
Të cilët, të lahtarisur nga ligjërimi ynë,
Tregojnë me gisht diçka që duan.

(Nga “Antologji e poezisë neozelandeze”)

Ewa Lipska, 1945

VENDI IM

Sot vendi im i ngjan
Një miniere thëngjilli, që ende nuk është mbyllur.

Një peizazh mjeran. Thuajse një falimentim.

Ai ka bërë gjumë të keq. Për këtë na bëjnë me dije
Gazetat e mëngjesit.

Në murin rrethues ka mbetur
Një copëz nga një afishe e grisur :
Historia nuk pranon reklamim.

Një çupëz e mbështetur në një shkop
Vrapon drejt pavdekësisë së shpirtit.

Vendi im kalon përmes një vendi
Që në pulpën leshtore
Ka një tatuazh
Me një shqiponjë
E cila përpiqet të fluturojë
Përpiqet të fluturojë
Përpiqet të fluturojë.

(Nga “Antologji e poezisë polake”)

Claude Tabarini, 1949

NJË KORB...

Një korb në një degë,
I habitur nga bora e madhe që ka rënë.

Një lypëse
E molisur,
E mbështjellë me shalle
Aq sa koka e saj mezi duket,
Vetëm një dorë tund me mllef
Një sapllak të zbrazët si qielli.

Murlani ulërin.
Sy të çakërritur aguliçesh!

(Nga “Antologji e poezisë zvicerane”)

NGA POEZIA
BOTËRORE

Përktheu Anton Papleka

Vincenzo Cardarelli, 1887-1959

PULËBARDHAT

Unë nuk e di ku e bëjnë çerdhen pulëbardhat,
Ku ulen për t’u çlodhur.
Unë jam si ato,
Fluturoj pareshtur.
Vetëm sa e përçik jetën,
Siç përçikin ato dallgët
Për të kapur shujtën e tyre.
Dhe ndoshta si ato e dua paqen,
Paqen e paanë të detit.
Por fati im është të rroj
Me mendjen gjithnjë te rrebeshi,
Ashtu siç bën rrufeja.

(Nga “Antologji e poezisë italiane”)

Inger Christensen, 1935-2009

BORA...

Bora
Nuk është borë
Kur ajo bie
Në qershor

Bora nuk ka rënë
Aspak
Nga qielli
Në qershor

Bora ka brofur
Vetvetiu
Dhe ka çelur lule
Në qershor

Si mollët
Kajsitë
Gështenjat
Në qershor

Të humbasësh udhën
Në borën e vërtetë
Që është bora e rënë në qershor
Bashkë me mugujt e me lulet

Kur njeriut i duket se nuk do të vdesë kurrë

(Nga “Antologji e poezisë daneze”)

Lubomir Levçev, 1935-2019

KAPRIÇIO NR. 1

Po bëra karrierë ndonjë ditë
(Dhe thonë se kjo gjë është e pashmangshme)
Po u ngrita aq lart
Sa të më telefonojnë nga të gjitha anët
Atëherë do të emëroj vdekjen
Si sekretare.
Kur ju do të doni të flisni me mua,
Ajo do të thotë se unë nuk jam këtu.
-Sidoqoftë unë desha të flisja me...
vetëm një çast...
-Jo, - do të thotë ajo.-
Ai nuk është më këtu!

Gjatë kësaj kohe të pambaruar,
Unë do të vështroj nga dritarja

Gjethet që bien
Ose që blerojnë sërish,
Kubenë e largët të kishës
Që i ngjan një filxhani të kthyer përmbys
Për të lexuar fatin në llumin e kafes,
Vajzat që shohin në dyert prej xhami
Dhe ju që mendoni se unë nuk jam më në këtë botë.

1968
(Nga “Antologji e poezisë bullgare”)

Carlos Drumond De Andrade, 1902-1987

KADRIL

Joao-ja dashuron Terezën që dashuronte Raimundo-n
Që dashuronte Marinë që dashuronte Joakim-in
Që dashuronte Lilin
E cila nuk dashuronte asnjeri.
Joao-ja u nis për në Shtetet e Bashkuara, Tereza
U bë murgeshë,
Raimundo-ja vdiq në një aksident, Maria mbeti lëneshë,
Joakim-i vrau veten dhe Lili u martua
Me J. Pinto Fernandes-in
Që nuk kishte marrë pjesë në këtë histori.

(Nga “Antologji e poezisë braziliane”)

Gloria Gervitz, 1943-2022

RABINI ZOUCHA

Pak para se të vdiste, rabini Zoucha ka thënë:
Kur të mbërrij te dyert e qiellit,
Askush nuk do të më pyesë:
“Përse ti nuk ke qenë Moisiu?”
Por : “Përse nuk ke qenë Zoucha ?
Përse nuk u bërë ai që vetëm ti
Mund të kishe qenë ?”

(Nga “Antologji e poezisë meksikane”)

Murathan Mungan, 1955

TË GJITHA YJESITË...

Të gjitha yjesitë e natës
Ishin përkulur mbi bregun e detit
Mbi rërën drithëruese
Ato vështronin fytyrën tonë
Si në mëngjesin e parë të botës

Nata harroi mbi kraharorët tanë
Një grusht me dritë hëne
Dhe unë lashë mbi kraharorin tënd
Gjumin tim më të thellë
Dhe mbeta aty
Dhe mbeta aty

(Nga “Antologji e poezisë turke”)

Manuel E. B. Argüello, 1924

GRUNJËRAT E PJEKURA

*Ti u ktheve dhe unë të dëshiroj
Unë nuk të prisja
Por ti erdhe vetë
Katuli*

E qeshura jote
Gjeografia jote prej vajze të re
Shkëlqen si një zjarr i parandier.
Trupi yt vashëror,
Kodrat e tua,
Kofshët e tua,
Pylli zanafillor,
Flaka që ti më jep
Pa kurrfarë detyrimi,
Dyert e hapura,
Trallisje e errët,
Ishull i zjarrtë.

(Nga “Antologji e poezisë paraguajane”)

György Somlyó, 1920-2006

FABUL KUNDËR FABULAVE

a
Nuk ka rëndësi ajo që na ndodh

Ka rëndësi ajo që ne jemi
Çfarëdo që të na ndodhë

b
Çfarëdo që të na ndodhë
Gjithmonë ka rëndësi ajo që ne jemi

Nuk ka rëndësi ajo që na ka ndodhur

ab
Nuk ka rëndësi ajo që na ka ndodhur
As ajo që ne jemi
Çfarëdo që të na ndodhë
Gjithmonë ka rëndësi ajo që mund të bëhemi

(Nga “Antologji e poezisë hungareze”)

Juan Gustavo Cobo Borda, 1948

A MOS E KAM ÇUAR DËM JETËN?

Ndërsa miqtë e mi të ndershëm sa më s’ka,
Përmbysnin diktaturat,
Organizonin revolucione,
Dhe me trupin e mbuluar me plagë
Hynin në trashëgiminë e rëndomtë
Të historisë lationo-amerikane,
Unë lexoja libra të ndaluar.

Ndërsa mikeshat e mia të bukura
Bëheshin erë para djaloshit të pavendosur
Që mezi mund t’ua shprehte
Sesa shumë nevojë kishte për to,
Unë vazhdoja të lexoja libra të ndaluar.

Tashti, unë e di :
Në ata libra të ndaluar
Ishin dashuritë më të marrosura, luftërat më të drejta,
Gjithçka që në ditët e ardhshme
Do të linte në hije aq kauza të zbrazëta.

(Nga “Antologji e poezisë kolumbiane”)

Franz Hodjak, 1944

OVIDI NË EKZIL

I harruar nga të shtatë kodrat nga qielli i lartë
Mbi Tibër i harruar nga hijet e pishave
Nga kopshtet festive i fshirë nga kujtesa
E Forum Romanorum-it
I shpërfillur nga njohësit e letërsisë dhe nga mecenët
I braktisur nga shkëndija e fundit e lumturisë nga fama
Dhe nga emri i braktisur nga çdo shpresë
Madje edhe nga shakaja më e mbrame

Vetëm armiqte tij i kanë mbetur besnikë

(Nga “Antologji e poezisë rumune”)

Regino Elado Boti, 1878-1958

DRITË

Unë pres diamantin tim,
Unë jam diamanti im.
Ndërsa të tjerët bërtasin,
Unë hesht, skalit, pres ;
Unë krijoj art në heshtje.

Ndërsa të tjerët marrin zjarr,
Unë zhvilloj betejën time ritmike
Dhe nuk e shes emrin tim për pesë pare.
Unë jam diamanti im,
Unë pres diamantin tim,
Unë krijoj art në heshtje.

1921
(Nga “Antologji e poezisë kubane”)

Henri Meschonic, 1932-2009

KUR SHKRUAJ...

Kur shkruaj
Unë nuk e di kush shkruan
Unë pres unë kërkoj
E vetmja gjë që di
Është se ti je aty
Se ekziston qenia ne
Një pjesë e së cilës jam unë
Dhe ti je pjesa më e bukur
Unë kam sy
Vetëm për të të parë ty

(Nga “Antologji e poezisë franceze”)

Jure Kastelan, 1919-1990

TË VDEKURIT SHTËPIA

Vendi i të vdekurve nuk është varreza
Ai është në shtëpitë tona.
Në thellësi të pasqyrave. Në ujë, ata shohin veten.
Të heshtur.
Ata mbajnë veshjet tona, lexojnë, shfletojnë libra.
Pamabrimisht të padukshëm.
Lakmitarë, të dërrmuar, të pagjumë. Pambarimisht
Të verbër. Të mbuluar me pluhur, të lodhur.
Gjithnjë kalimtarë. Duke rënkuar. Të padëgjueshëm.
Ata na e marrin bukën nga dora.
Ata na marrin rrobat, na përgjojnë dhe sidomos heshtin,
Me veshët pipëz, ata heshtin, heshtin.
Me veshët pipëz. Asnjëherë brenda nesh. Jashtë nesh.
Kudo të pranishëm. Pa jetë, ata ekzistojnë.
Ne të gjallët jemi kalimtarë
Në shtëpinë e vdekjes.

(Nga „Antologji e poezisë kroate“)

Ruth Fainlight, 1931

NGULMIM

Kurë nuk do ta kisha besuar se do të shkruaja për hënën
në moshën time
As që hëna e plotë ende mund të më linte zgjuar, si në
ethe, të përndezur,
Një natë të tërë vere ashtu si dikur.

Por kjo hënë ngulmuese, shkëmb i ndritshëm në qiellin e
errët, prani
e pazakontë
Përmes perdeve të hapura, kërkon që t’i përgjigjet dikush.
Për një çast,
e ndjeva veten të tubulluar, të pavendosur, si të isha ende
një çupë çapkëne.

Pastaj me atë siguri që kishte hëna, e vështrova edhe unë.
Ndërsa ajo ngulmon
Me dashamirësinë e saj, unë ve re se asgjë nuk ka ndrysh-
uar: Të jem motra sypafjetur
Dhe vetmitare e hënës është fati im i përhershëm.

(Nga “Antologji e poezisë britanike e fillimit të shekullit XXI”)

Antonio Gamoneda, 1931

DASHURI

Mënyra se si të dashuroj unë është e thjeshtë:
Unë të shtrëngoj pas vetes
Sikur të kishte pakëz drejtësi në zemrën time
Dhe sikur të mund të ta falja bashkë me trupin tim.

Kur t’i shpupurish flokët,
Diçka e bukur merr formë midis duarve të mia.

Dhe nuk di asgjë më shumë se kaq ose aty afër.
Dëshiroj të jem në paqe me ty, të jem në paqe
Edhe me një dëshirë të panjohur
Që nganjëherë më rëndon në zemër.

(Nga “Antologji e poezisë spanjolle”)

Ivo Vodsedalek, 1931

Mbi fronin pranë dritares
Unë vura një pjatë të bukur majolike
Të mbushur me kumbulla të freskëta
Pastaj i pajtuar me fatin u ula dhe ndenja aty
Duke lexuar nganjëherë rrëfenja biblike
Nganjëherë duke këqyrur retë
Por të shumtën e herës hidhja një vështrim të trembur
I mbaja sytë te dritarja përballë
Ku për disa çaste ia behte
Trupi i zhveshur i Verës që bënte gjimnastikë

(Nga “Antologji e poezisë çeke”)

Joao Luis Barreto Guimaraes, 1967

SHPATA E SELIMI III

Ligjërata e skalitur në tehun e saj
Me një bukurshkrim të përsosur
E shpon armikun. Nga ata të dy
(Shpata dhe trugu i njeriut)
Vetëm ky i fundit ka vdekur –
Shpata rron ende në Pallatin Topkapi
Ajo e ka humbur atë lëvizje
Që e bëri të lavdishme
(Atë gjest të prerë e të moçëm
Me të cilin ajo shprehu zemërimin e saj)
Shpata e përmbushi kohën e saj për të derdhur gjak
Kur një trung njeriu u ndesh me një trung njeriu
Ajo u dënua me një jetë të amshuar
(Në burgun e një vitrine) duke e pasur zili
Çdo trup që pikërisht në këtë çast
Dashuron dhe vallëzon pambarimisht
(Si një dervish) në parajsë

(Nga “Antologji e poezisë portugeze”)

André Schmitz, 1929

BETOHEM PËR FJALË TË NDERIT

Betohem për fjalë të nderit
Se nuk kam të bëj fare
Me veten time.

Unë nuk jam pronari
I trupit ku banoj.

Këta sy që ditë e natë vështrojnë
Zogj të çuditshëm
Dhe magjepsen nga bukuria e botës
Nuk janë dritaret e shtëpisë sime.

Vendi ku ndodhem ai që jam
Nuk është atdheu im.

Jam biri i një fëmije
Që ende nuk ka lindur,
Bashkëshorti i sertë i një gruaje që e takoj
Dhe nuk më përket asnjë grimë.

Diku një vashë e re
Orvatet të jetë nëna ime.

(Nga “Antologji e poezisë belge”)

Në tërë Danimarkën, s'ka përveç zuzarë dhe kalorës vagabondë.
SHEKSPIRI
("HAMLETI"AKT.I. SKENA V)

Tri ditë dhe tri netë kryeqytetin e pllakosi një gjumë i rëndë. Çdo gjë ishte e mbështjellë nga një qetësi e frikshme. Dukej sikur mijëra e mijëra gjuhë të prera befaz ishin groposur bashkë me gjarpërinjtë, në gropën e madhe prapa Pallatit të Madh të Kulturës... Dhe pas dymbëdhjetë orëve të para të këtij gjumi, nisi të bjerë shi i qetë, nanuritës, duke sjellë siç duket mesazhe prehjeje, pas trazimeve shqirtërore të kryeqytetasve. Shiu vazhdoi pa ndërprerje, në qetësinë prehëse të tij, deri në mesnatën e dytë të gjumit.

Dhe kur ai pushoi, nga groa e madhe nisën të dalin ata, duke u zvarritur nëpër rrugët dhe rrugicat e lagura të qytetit. Nën ndriçimin e ftohtë të hënës së plotë, duke u zvarritur dhe lëshuar ca "th, th, th" të zgjatura, gjarpërinjtë ngjtnin shkallët e pallateve, muret dhe avllitë e shtëpive një-e dykatëshe, fasadat e ndërtesave publike, monumentet, si dhe piedestalet pa monumente. Fishkëllimat dhe "th,th,th " lemeritëse, gjuhët e holla, që i nxirrnin nga gojët e hapura të kokave të ngritura, tregonin zemërimin për ata, që i kishin flakur pa mëshirë dhe pastaj groposur. Tani e ndjenin veten zotër të gjithçkaje. Ish-zotërit, pas gjumit të thellë, kur të ngriheshin do të shihnin pasojat hakmarrëse të pickimeve të atyre, që i pranuan me gëzim nëpër shtëpi dhe një ditë i flakën... Ah, njerëzit mosmirënjohës e të pabesë... Kur të ikte edhe një natë dhe kur të delte dielli, ata do të largoheshin andej nga kishin ardhur, duke lënë pas vetëm harrim, harrim, harrim...

KRONIKË

Ora 24.00

U dëgjuan tre gjëmime, sikur vinin nga thellësitë e tokës: gjëmimi i parë në kodrën e varrezave të Sharrës, në periferi të kombinatit të tekstileve, gjëmimi i dytë në fushat e Kamzës dhe gjëmimi i tretë rrëzë malit të Dajtit. Dhe pas këtyre tre gjëmimeve, tri herë u shfaq një dritë e bardhë në lindje të kryeqytetit. Dhe kur drita e bardhë nuk u shfaq më, në orën 0.15' zogj të vetmuar pa pupla, pasi u vërtitën mbi hapësirën e Tiranës, u ulën në degët e zhveshura të pishave e të bredhave të bulevardit.

Në orën 0.30, në shatërvanin pranë godinës qendrore të Universitetit, u grindën mes tyre një grup i madh hijesh, për emrat e bulevardit të madh, të sheshit qendror dhe të disa rrugëve kryesore. Pas pesëmbëdhjetë minutave, dy hije të gjata vunë tabelat Bulevardi "Hijet e Vdekura" dhe Sheshi "Kotësia". Hijë të tjera u shpërndanë në të gjitha rrugët dhe zëvendësuan emrat e tyre me të gjarpërinjve, si rruga "Gjarpri me Pika", rruga "Boa", rruga "Gjarpri me Zile".

Ora 1.00

Re të ardhura nga deti lëshuan mbi kryeqytet një shi të qetë, shoqëruar me vetëtima të shpeshta. Ai ishte shi gri, që vazhdoi rreth një orë, duke i dhënë gjithçkaje një ngjyrë të njëtrajtshme.

Nga ora 2.00-5.00

Zëra anonimë. Rënkime. Ëndrra. Mijëra copa ëndrrash në pragzgjimin e ditës së re.

Ora 5.00

Zëri i spikerës të Radio Tiranës dukej si i mbështjellë me mjegull dhe herë-herë tingëllonte si zë nate: "Ju flet Tirana! Qytetarë të kryeqytetit! Ju që jetuat kohën e gjarpërinjve, që i pranuat ata me gëzim e shpresë në gjirin tuaj, që provuat pabesinë e kafshimit, të helmimit të tmerrshëm e që i flakët menjëherë, këtej e tutje nis një epokë e re. Kjo do të jetë epoka e lirisë së vërtetë, e mirëkuptimit, e lumturisë. Ju triumfuat mbi gjarpërinjtë dhe helmin e tyre dhe tani duhet të gëzoni frutet e fitores".

Punonjësja e vjetër e fonotekës, disa sekonda para përfundimit të fjalës së spikerës, i dha teknikës së pulsit kasetën me këngë popullore. Në çastin kur spikerja tha fjalët: "Tani ju argëtojmë me muzikë të gëzuar popullore nga krahina të ndryshme të vendit", nisi të lëvizë shiriti i kasetës. Kaluan 1", 2", 3", ...10"... 30 sekonda ... Asnjë tingull muzike. Vetëm një zhurmë gërryese. Mbylli mikrofonat, tha spikerja. Jepe prapë thirrjen, u hodh teknika e pulsit, duke i bërë me shenjë punonjësës së fonotekës që të merrte menjëherë kasetën tjetër. Por ndodhi e njëjta gjë. Shiriti lëvizte duke lëshuar zhurmë gërryese. Ç'është kështu, tha punonjësja e vjetër e fonotekës, pasi vuri një grumbull kasetash mbi tavolinën e studios kryesore të transmetimit. Kush i ka fshirë shiritat?

Spikerja vuri duart në kokë, ndërsa teknika

KRONIKË NGA DITA E PARË E KOHËS ZERO

Enver Kushi

fragment nga romani në proces

e pulsit me sy të shqyer, ndiqte lëvizjen e shiritit të kasetës së dhjetë... Ç'është kjo gjëmë që na gjeti, tha punonjësja e vjetër e fonotekës. Dhe u dëgjua një e qarë me dënësë, shoqëruar me fjalët: "Oh, çgjëmë e madhe! Oh, çgjëmë e madhe!" Vaji i saj, nëpërmjet Radio-Tiranës, u dëgjua në të gjitha familjet e kryeqytetit si dhe në pjesët e tjera të vendit.

Ora 7.00

Gjithçka dukej si nga fillimi i botës. Zogj të çuditshëm, pa pupla, uleshin e ngriheshin mbi degët e zhveshura të drurëve dekorativë, apo të pishave e bredhave të bulevardit. Pas gjumit të gjatë, kryeqytetasit hapën dritaret dhe të hutuar vështronin grinë e përgjithshme të pallateve, të shtëpive, çative, antenave të televizorëve, të drurëve, të rrugëve e të trotuareve...

Ora 8.00

Të parët, që dolën në vendet e tyre të njohura ishin gazetashitësit, duke nxjerrë gazetatat e mbetura pa shitur. Por sapo hapën çantat dhe vunë mbi tavolinat e tregtimit gazetatat, shtangën nga habia: në vend të titujve, të gërmave të artikuive, të fotografive, ishte një hapësirë e bardhë letre. E nejta gjë kishte ndodhur edhe në Bibliotekën Kombëtare. Gërmat e librave, të revistave, të koleksioneve të gazetave kishin rënë. Ato u ngjanin blloqeve të shënimeve apo të atyre, që mbanin leksione studentët.

Tabelat e dyqaneve, restoranteve, hoteleve, vendeve përkujtimore, ishin fshirë. Shkallët e Muzeut Kombëtar ishin mbuluar nga qindra objekte pa formë, letra e fotografi të bardha, ndërsa në Kinostudio nuk kalohej dot nga mijëra shirita filmi, që kishin mbushur të gjithë territorin e saj. Nga dritaret me xhama të thyer të Institutit të Kulturës Popullore, dëgjoheshin zërat e vajtojcave të Veriut, si dhe të qarat me ligje të grave nga Jugu i vendit. Asgjë tjetër. Mbi rrënojat e mbetura nga rrafshimi i Akademisë së Shkencave dhe të Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, era shpërndante hirin e librave dhe të dokumenteve të djegura, ndërsa në juglindje të kryeqytetit, atje ku dikur ishin Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, vazhdonin të digjeshin qindra kafka e skelete, grumbulluar para monumentit të përçudnuar "Nëna Shqipëri".

Nga ora 9.00-11.00

Duke dalë nga shtëpitë, pasi vështronin e vështronin të habitur ngjyrën gri të pallateve, të ndërtesave qeveritare dhe zogjitë e çuditshëm pa pupla, që uleshin e ngriheshin në degët e zhveshura të drurëve, kryeqytetasit vinin re se megjithatë, qielli ishte i njëjtë si më parë. Edhe mali i Dajtit, edhe kodrinat e buta, edhe Lana. Si më parë? Ç'është kjo si më parë? Nuk mbaj mend asgjë. Ne sapo kemi lindur... Po, ja. A e mban mend se dikur... Ç'është kjo fjalë d-i-k-u-r? A ka patur d-i-k-u-r. Nuk dua t'ia di për atë dikurën.

Kështu flitej nëpër rrugët e mbushura me qindra kryeqytetas. Të përgjumur, me sy të përhumur, pasi vështronin e vështronin me minuta të tjera monumentin e Skënderbeut, befaz ndonjë me zë të lartë thoshte: "Ku e ke shpatën? Shpatën ku e ka? Po mburojën? Po përkrenaren?" I çarmatosur mbi kalin e bronztë, ai i ngjante një fshatari varfanjak, ardhur në kryeqytet për lëmoshë...O Zot, po këta kush janë? Ata... Ata... Se si më duken... Si... Nuk i kujtoj... Nuk... Asnjë nuk i mbante mend vëllezërit Frashëri, që të mbetur pa gojë, hundë e veshë, dukeshin si të sëmurë prikikë... E më tutje, pranë qendrës, "Partizani i panjohur", i përçudnuar, të kujtonte ndonjë psikopat, që kishte shqyer gojën dhe ulërinte në kupë të qiellit, pa e ditur se ç'kërkonte.

Në orën dhjetë e tridhjetë minuta, duke çarë me vështirësi në Sheshin e Kotësisë, Kolë D, Omer B, Zigur K, nxitonin në kërkim të Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve.

Me sy të çakërdisur, veshur me pizhamat e spitalit psikiatrik dhe duke mbajtur në duart bidona me bezuninë, ata herë-herë ndalonin e pyesnin se ku ishte godina e Shkrimtarëve dhe Artistëve. Kryeqytetasit ngrinin supet pa

u dhënë asnjë përgjigje. Pasi u vërtitën për një kohë të gjatë në Sheshin e Kotësisë dhe rrugëve të Tiranës, pasdite vonë morën rrugën për në fermën e Kamzës, ku i vunë zjarrin njerës përtej stallave të lopëve... Siç duket, parrulla e vënë prej kohësh në hyrje të stallave: " Vdekje lopëve të Bllokut Komunist dhe shkrimtarëve të realizmit socialist", i kishte ngatërruar disi ata.

Nga mesdita deri në mëngjesin e ditës tjetër Banorëve të lagjes Brrakë gjumi u doli rreth orës dymbëdhjetë. Këngëtari i njohur, sapo u zgjua dhe piu gotën me ujë e sheqer, befaz ndjeu se i kishte ikur zëri. Më ma ik zoni, i tha ai me zë të humbur së shoqes. Thirr më fort, i tha ajo. Ma kanë vjedh zonin. Ma kanë vjedh zonin, i tha ai. Luaj vendit! Më duket se ke ik prej fiquit... Ai nuk foli më. U shtri në krevat dhe ajo pa sytë e tij, që lotonin dhe me vështirësi dëgjonte fjalët e këngëtarit të famshëm të Brrakës: "Ma kanë vjedh zonin...". Në shtëpinë ngjitur me atë të këngëtarit, jevgu dhe katër vëllezërit e bërë synet, vazhdonin të flinin.

Pasdite ia dha një erë e fortë, shoqëruar me pika të mëdha shiu. Rrugët, sheshi qendror, bulevardi mbetën prapë të shkretë. Kur era pushoi, nga dritaret me xhama të thyer të Institutit të Kulturës Popullore, u dëgjuan prapë zërat e vajtojcave të Veriut dhe të qarat me ligje të grave nga Jugu i vendit, ndërsa në periferi të kryeqytetit, gjatë pistës së aeroportit të vjetër, vraponte një grua, duke tërhequr të lidhura me njera-tjetrën pesëmbëdhjetë kafka lopësh.

KRONIKË MUZGU

MUZGU I PLOTË I KOHËS ZERO

Epilog I

Në një nga orët e para të mëngjersit të ditës së dytë të kohës zero, më saktë midis pesës dhe gjashtës, nga rrugica që prapa hotelit "Internacional", doli një furgon i vogël dhe mori drejtimin për në sheshin qendror. Pushimin e parë ai, që tërhoqte furgonin, e bëri sapo kaloi reklamat e kinemasë. Era e lehtë që frynte, sillte nga rruga prapa reklamave ca zëra grash, që vajtonin në kor. Pastaj ai vazhdoi të lëvizë drejt qendrës, i ndjekur nga kori vajtues i grave të Jugut të vendit. Ndaloj pranë shatërvanit dhe për disa çaste hodhi vështrimin mbi sheshin qendror, mbi kalorësin lypsar, mbi rrugët e pandriçuara... Ndjeu se si nata ikte e trembur drejt perëndimit, për t'u gëlltitur kushedi nga ç'hapsira qiellore. Iu duk sikur një gojë gjigante përtypte pa pushim ditët, javët, muajt, vitet, të asaj që quhej kohë, ndërsa përreth ulërinin me dhimbje mijëra zëra të grave të Veriut e Jugut të Shqipërisë.

Dhe befaz Andi pati dëshirë të vraponte drejt hapësirave të panjohura qiellore dhe nëntëmbëdhjetë vitet e jetës së tij të gëlltiteshin nga goja gjigante, që përtypte kohë... Atje ka vetëm natë, tha me vete. Vetëm natë, sa nuk thirri me zë të lartë. Vetëm natë... Natë. Vështrimi iu mjegullua. Pastaj një dritë e bardhë mbuloi gjithçka, për t'i lënë vend një fushe me lule blu, një kali të bardhë, që vraponte drejt tij dhe zërit të nënës. Ai zë kishte kohë që e thërriste...

Kur zbardhi dita, patrulla e policisë e rajonit nr.1, gjeti të rënë përmbys në qendër të kryeqytetit kufomën e një të riu. Nga hetimet e bëra në vend, doli se ai kishte vdekur midis orës pesë dhe gjashtë të mëngjesit, pa pasur asnjë shenjë goditjeje me armë zjarri ose armë të ftohtë. Në komunikatën e dhënë për shtyp thuhej se viktima quhej Andi Kasa, vjeç nëntëmbëdhjetë, pronar i firmës së njohur "ANDKOM" e se policia ishte në kërkim të shkaqeve të vdekjes.

Në orën dhjetë, në rajonin e policisë, u soll një bllok i vogël, gjetur në xhepin e brendshëm të xhakaventës së viktimës. Shefi i policisë e shfletoi disa herë bllokun me shënime të ndryshme llogarie, pjesë ditari, vargje... Fletët e fundit ishin shkruar me shkrim shumë të kujdesshëm. "Hapa dritaren dhe në oborr pashë gjarpërinj të gjallë, që dilnin nga dera gjysëm e hapur e dhomës



magazinë. Iknin me kokat e ngritura lart drejt portës së madhe... "

Shënimi ndërpritej dhe vazhdonte më poshtë: "Sa kam fjetur? 1 vit? 50 vjet gjumë? Asgjë nuk mbaj mend. Vetëm atë natë kur pashë ata që delnin nga dera gjysëm e hapur e dhomës magazine me kokat e ngritura lart... Asgjë nuk mbaj mend. Edhe zërin e nënës... Zërin e nënës e mbaj mend. Ka netë që më thërret..."

Përsëri shënimi ndërpritej dhe pas një hapësire faqeje të pashkruar, në mes, shkruar me gërma kapitale, shefi i policisë lexoi fjalët:

E hënë, 1 mars. Viti zero

Shefi i policisë i lexoi disa herë ato fjalë, shkruar me kujdes. Pastaj ngriti receptorin e telefonit dhe në çastin kur formoi numrin 38705, për të pyetur drejtorin e spitalit psikiatrik, nëse ndonjë pacient me emrin Andi Kasa ishte larguar pa leje, sytë i shkuan në mur, ku kalendari gjithashtu shënonte të njëjtën datë:

E hënë, 1 mars. Viti zero

Receptor i ra nga dora dhe vështrimi i mbeti i ngrirë në kalendarin e murit: E hënë, 1 mars. Viti zero.

Epilog II

(Ose zgjim pas një ëndrrë të gjatë)

Andi e pa veten në ëndërr të vdekur, shtritë përmbys pranë një pellgu të madh me ujë. Pellgu me ujë herë i bëhej se ishte ai i shatërvanit në qendër të qytetit dhe herë i bëhej në Pazarin e Ri. Në ëndërr uji i pellgut ishte i pastër dhe në sipërfaqen e tij mbinin zambakë të bardhë. Pastaj humbi nëpër terr dhe me mundim të madh përpiquej të çante përpara... Dhe prapë në ëndërr e pa veten të vdekur pranë pellgut me ujë, ku mbinin zambakët e bardhë...

Kur u zgjua ndjeu të ftohtë dhe u mbulua kokë e këmbë. Gjumi e zuri menjëherë. Ëndrrat i erdhën prapë, shtëllunga-shtëllunga si re të hirta, duke e mbështjellë për ta çuar në botëra të çuditshme. Qindra e qindra gjarpërinj zvarriteshin nëpër rrugët e Tiranës. Të tjerë u kacavirreshin monumenteve, fasadave të ndërtesave, pemëve... E më pas iu shfaq në ëndërr shkretimi i kryeqytetit, hapësirat e hirta dhe memecllëku i gjithçkaje. Kore vajtojcash dëgjoheshin nga ca megafonë diku në qenër, ndërsa nga rruga e Kavajës dhe e Durrësit vinin jehonat e zërave të murgjerve të Spanjës. Andi u përpoq të vraponte nëpër bulevard, për t'u larguar sa më shpejt prej zërave të vajtojcave dhe murgjerve të Spanjës, por ra përmbys, duke thirur me zë të lartë: "Ndaleni këtë rrënim! Ndaleni këtë rrënim! Koha zero! Koha zero!"

U zgjua i llahtaritur dhe vështroi me sy të çakërritur çdo gjë përreth. Pasi erdhi në vete, u ngrit e doli jashtë. Andi nuk po u besonte syve. Dielli i marsit, i fortë dhe i gjithëpushtetshëm dukej si i dalë befasisht nga nata e gjatë e dimrit. Oborri, me drurët e zhveshur të hurmave e të fikut, zhytur në këtë shkëlqim, dukej gjithashtu si i dalë nga një ëndërr e gjatë. Edhe rrugica e lagjes e tillë dukej. Edhe qielli i kryeqytetit, i lartë dhe i kaltër, gjithashtu dukej si i dalë nga një ëndërr e gjatë dimri.

NË VEND TË NJË SQARIMI:

Fragmenti i mësipërm, që botohet për herë të parë në EXLIBRIS, është marrë nga romani im "Koha Zero", i botuar fillimisht në numrin e parë të gazetës "Evropa", që drejtohej nga poeti brilant, Frederik Rreshpja, në mos gaboj në fillimjanarin e vitit 1993, me titull "E hëna e vitit zero". Ishte mendimi këmbëngulës i Frederik Rreshpjes dhe Moikom Zeqos, që tregimi në fjalë të shkruhej roman. Dhe kështu ndodhi. Rreshpja me shpenzimet e tij e botoi këtë roman, me titullin "Hëna e vitit zero", në vitin 1995. Romanin e ripashë edhe një herë, në fillim të viteve 2000, botimin e të cilit e mori përsipër Shtëpia botuese "Baça", që në vitin 2002 e nxori në qarkullim këtë roman me titull "Koha zero". Romanin në fjalë po e rishoh, për ta ribotuar me disa plotësime.

Në të vërtetë titulli “Vizita e mrekullueshme” i shkon më shumë përshtat ardhjes së Davide Iodice në teatrin tonë sesa romanit të vitit 1895 shkruar prej Herbert George Wells (1866-1946), një prej njerëzve më influent në letërsinë fantastiko shkencore të të gjitha kohërave.

Vepra

Vepra ka në qendër të veten një Engjëll, një krijesë e fantazisë së shkrimtarit, që papritmas shndërrohet në protagonistin e jetës së një province angleze. “Vizita e mrekullueshme” e këtij Engjëlli nuk zgjat më shumë se një javë, kohë e mjaftë kjo për të dëshmuar se kjo krijesë është diçka ndryshe prej engjëllit të besimit fetar, por dhe atij popullor gjithashtu. Mbasi qëllohet gabimisht në krah nga famullitari i fshatit, merakli gjoje dhe zoolog amator, ai strehohet diku në famulli, ku fshatarët, fillimisht të frikësuar nga pamja e tij e çuditshme, më në fund jo vetëm që e pranojnë, por nisin madje edhe të magjepsen nga këndvështrimi i tij unik për jetën.

Kësisoj, Engjëlli, fillon naivisht të ndërveprojë me personazhe të ndryshëm, duke mësuar kësisoj për natyrën njerëzore, përfshirë këtu edhe kompleksitetin e dashurisë dhe rreziqet e paragjykimeve shoqërore. Por në finale, edhe pse ai, me kalimin e njëfarë kohe në tokë, bëhet gjithnjë e më shumë njerëzor, duke rënë në dashuri dhe duke vuajtur të gjitha sprovat, dhëmbjet dhe mundimet njerëzore, prapë se prapë nuk ia del ta shndërrojë për mirë atë realitet.

Romani i dramatizuar prej një djaloshi napoletan, dramaturg, vjen tashmë në teatrin tonë, si një satirë dhe koment analitik i shoqërisë së sotme shqiptare. Pra spektatori kupton që në krye se regjisori është i gatshëm të përgjigjet qartë dhe prerë se pse ka zgjedhur pikërisht këtë vepër nga biblioteka e pasur dramaturgjike e botës.

Të dy bashkë, dramaturgu me regjisorin e shfaqjes, i kanë bërë veprës një lexim që të provokon, të ngjall mendime dhe heq paralele të “rrezikshme” me realitetet tona provinciale. Përralla e këtij Engjëlli, që pavarësisht dëshirës së mirë, nuk mund të përshtatet me shoqërinë e këtij fshati të vogël, të kujton komentet e filozofit të famshëm frëng Zhak Mariten, kur thotë se Zoti nuk e ka, nuk e njeh, eksperiencën e së keqes dhe prandaj ai shpesh nuk mund t’i bëjë pritë veprave të djallit.

Pra duket qartë se regjisori e ka gjetur realitetin tonë si një kontekst që propozon një realitet të vështirë, kryefortë, dhe paragjykes. Me sa duket këto dhe të tjera kanë qenë argumentet e Davide Iodices për ta rikonsideruar këtë tekst si shumë të rëndësishëm kulturalisht, dhe për ta vënë atë në dispozicion të publikut shqiptar, si pjesë e angazhimit për mbrojtjen, ruajtjen

Shënime rreth shfaqjes më të re të teatrit “Migjeni”, “Vizita” me autor Fabio Pisano nga H.G. Wells; regjisor Davide Iodice; ndihmës regjie Jozef Shiroka; përkthyes Zija Vukaj; konstruksionet scenografike Divni Gushta; dhe me aktorët: Fritz Selmani, Pjerin Vlashi, Nikolin Ferketa, Rita Gjeka, Vladimir Doda, Jozef Shiroka, Merita Smaja, Julinda Emiri, Rajmonda Marko, Aleksander Prenga.

““VIZITA” E MREKULLUESHME E DAVIDE IODICE

Nga Stefan Çapaliku

promovimin, funksionalizimin dhe rikontekstualizimin e letërsisë dhe teatrit më të mirë botëror.

Shfaqja

Shfaqja nis e mëshjtjellë me një dritë të butë gri, një dritë që nxjerrë në pah edhe më mirë njollat e mbetuna mureve të një vendi të kapur në fyt nga rutina. Është rutina e njerëzve që vijnë në kishë, duke hyrë nga të gjitha cepat e hapësirës skenike dhe duke realizuar kësisoj ekspozicionin e veprës me elemente minimalistë dhe esenciale. Mendova se ishte zog, dëshmon prifti jo vetëm me tekst, por edhe me maskën e tij.

Pika e lidhjes vjen menjëherë, pa pasë nevojë me e tjerë fort. Engjëll i plagosur bie në vendin e njerëzve, që na qenka edhe vendi i ëndrrave. Mandej regjisori ndërton menjëherë një mizanskenë rrethore, ku shohim sesi të gjithë procesionin e udheheq një budalla. Një budalla që flet për jeten e qiellore, ndërkohë që të tjeret i shkojnë mbrapa. (Tamam si në një miting politik).

Shfaqja vjen dhe rritet si një fëmijë, pa bërtitur, pa u ankuar, dhe pa e trumbetuar ritmin e brendshëm.

Një tjetër pikë shumë interesante e shfaqjes janë daljet e aktorëve nga karakteret te narratorët, duke komunikuar kësisoj *a parte* me spektatorët dhe duke nënvizuar disa qëndrime. Prishja e murit te katërt dhe ndezja e dritave të sallës kërkon të provokojë te spektatori memoriet e fjetura të gjyqeve politike të vitit 1945. Gjatë kësaj kohe nis edhe përpjekja për ta veshë Engjellin me eksperiencat njerezore, nëpërmjet disa rrobave konvencionale, përpjekje e cila hepon pyetjen: Cili prej jush është një engjëll?

Ndërkaq pyetja e Engjëllit që ia drejton priftit: “Po çfarë bëni ju çdo ditë?” e fut skenën

në një *slow motion* dhe një repeticion rutinor. Është çasti kur diçka e rëndësishme ndodh: Prifti humbet gjithnjë e më shumë besimin, duke rënë pre e pasioneve bazike, si vena, etj.

Kësisoj njerëzit e qytezës fillojnë të mos besojnë më as te Engjëlli. Ndonji aktore që lëshon batuten dhe pret haraçin në formë duartrokitjesh, si të jetë ajo autori mbetet shtang. Por “The show must go on”!

Në pikpamje ideologjike shfaqja e Iodices prej fillimi deri në fund i lë pyetjet pa përgjigje, duke u bërë thellësisht provokative dhe duke i intensifikuar goditjet ndaj publikut, si të jetë duke e futur atë në një vend ekzaminimesh apo elektrohok.

Ashtu papritur, siç edhe erdhi, Engjëlli largohet, duke marrë me vete ndoshta edhe shpirtin e ndonjë vajze të re. Kështu edhe shfaqja vjen dhe shuhet papritur. Askush tjetër nuk dallohet në universin e engjëjve, askush nuk lind më, askush nuk vdes, dhe askush nuk na viziton për së dyti.

Davide i jep dinjitet tekstit. E lë atë të prijë, duke e shpërndarë veprimin në të gjitha cepat e skenës. Dinamika semantike e tekstit shkon paralelisht me atë të vënies në skenë.

Filozofia e veprës mund të lexohet edhe në dritën e mësimave të Jacques Maritain, i cili na mëson se Zoti nuk e ka eksperiencën e së keqes. Atë e kemi krijuar ne vetë dhe për këtë duhet edhe të paguajmë çmim.

Regjisori i “padukshëm”

Davide Iodice vjen në Shqipëri në kohën kur disa nga regjisorët tanë lokalë, shpesh të frymëzuar edhe nga disa ballkanas të tjerë, tregojnë arrogancë të pashoqe artistike, duke dhunuar më së pari tekstet e autorëve dhe më pas duke ushtruar edhe dhunë psikologjike (dhe jo vetëm) edhe mbi aktorët e bashkëpunëtorët e tjerë skenik. Këto lloj regjisorësh të mbushur me



vete, më së shumti të pazotë të kapërcejnë kufinj të kulturorë të shqiptarisë, po ofrojnë modele të tilla estetike me të cilat po e shndërrojnë teatrin në mos në cirk, në një vend ku spektatorët vijnë me u shkri gazi apo me mbetë me gojë hapë.

Davide Iodice, i diplomuar për regji nga Akademia kombëtare e artit dramatik të Romës, bashkëthemelues i kompanisë “Libera mente”, pjesmarrës aktiv dhe më vonë drejtor artistik i “Qendrës për kërkime teatrore të Napolit”, bashkëpunëtor i Carmelo Bene dhe pjesmarrës në “Crt” të Milanos, Bienalen e Venecias dhe “Festpiele” të Berlinit, fitues i çmimeve të mëdha kombëtare dhe ndërkombëtare në fushë të teatrit, vjen në Shqipërinë tonë vonë...

Ai ka arritur të realizojë një skenografi dinamike dhe në transformim të vazhdueshëm. Skenografia transformohet prej prekjeve të aktorëve, të cilët gjithashtu transformohen nga ajo vetë. Kjo marrje - dhënie është karakteristikë esenciale e teatrit të mirë.

Engjëlli i zbulon absurditetin në të cilin janë zhytur njerëzit dhe prandaj ata bëhen agresiv me të. Ai nuk mund të fluturojë më. Skenat paralele me priftin që lexon, atë që nuk mund te fluturojë më dhe dikuj që i bie këmbanës me të ça veshët, janë shtyjnë para veprimin skenik dhe karikojnë suspansën. Shfaqja gjithashtu erdhi te unë edhe si një intuitim i sinqert i realitetit tonë shqiptar, që e poetizon fund e krye tekstin dhe teksturën regjisoriale.

Muzika gjithashtu nuk tingëllon në asnjë çast si ambalazh i shfaqjes. Ajo është thjesht permabajtje, personazh, qëndrim. Ndriçimi i butë, teatral, bardh e zi, i ftohtë, ofron dicka prej frymës çehoviane e pirandeliane. Shpesh ndriçime lokale prodhoohen vetë në shfaqje, siç ishte përshembull momenti i djegies së letrave, që të kujtojnë ritualin e një *autodafe*-je.

Në përfundim mund të them se mesazhet dolën qartë dhe tingëlluan me zë të lartë. “Jemi njerëzor dhe kjo asht e meta jonë e madhe”, tingëllon si streha e gjithë pafuqisë sonë për të ndryshuar veten. Dhe Engjëlli bërtet, çirret duke e dëshmuar veten *Vox clamantis in deserto*.

Aktorët janë të gjithë për t’u përgëzuar. Të gjithë aktorët hyjnë në skenë me maska të përpunuara, varësisht pantelikeve të veta. Në fillim u duk sikur ata hynë me idenë dhe qëllimin për të vënë re se kush ishim ne, që kishim ardhë për t’i parë. Dhe kështu m’u duk se nuk vonoi shumë dhe ky proces u krye. Ata na njohën dhe ne i njohëm, duke lidhur kësisoj një miqësi krejt organike. Personalisht mendoj se transformimi i maskës, sjelljes së tyre psikofizike duhej të ishte edhe më i madh dhe më i thellë nga fillimi në fund të shfaqjes.

Post scriptum

Rruga është e qartë, e ndriçuar dhe tashmë duhet veç kujdes që të mos ketë kthim mbrapa. Davide i riktheu teatrit nderin e humbur, sepse vizita e tij ishte si ajo e një Engjëlli të vertetë dhe padyshim që për këtë meritë të posacme ka edhe drejtorit i Institutit italian të kulturës, Alessandro Rugera.



WILLIAM WEAVER & DAMIEN PETTIGREW: Çfarë vendi, zë deliri në jetën tuaj si shkrimtar, nëse ka delir?

ITALO CALVINO: Deliri?...Le të hamendësojmë sikur përgjigjem, jam gjithmonë racional. Çfarëdo që them apo shkruaj, i nënshtrohet arsyes, qartësisë dhe logjikës. Çfarë do të mendonit për mua? Do të mendonit se jam plotësisht i verbër kur bëhet fjalë për veten time, një lloj paranojaku. Nëse nga ana tjetër do të përgjigjesha: Oh, po, jam vërtet delirant; Shkruaj gjithmonë sikur të isha në gjendje trashendentale, as vetë s'e di se si shkruaj gjëra kaq të çmendura, do të mendonit se po shtirem, po luaj rolin e një personazhi jo edhe aq të besueshëm. Ndoshta pyetja nga e cila duhet të fillojmë është se çfarë duhet të vendos nga vetja ime në atë që shkruaj. Përgjigja ime: vendos arsyen time, vullnetin, shijen, kulturën që i përkas, por në të njëjtën kohë nuk mund ta kontrolloj, le të themi, neurozën time apo atë që mund ta quajmë delirium.

Cila është natyra e ëndrrave tuaja? Jeni më i interesuar për Jungun sesa për Frojdin?

Pasi lexova "Interpretimi i ëndrrave" të Frojdit, shkova në shtrat. Pashë një ëndërr. Të nesërmen në mëngjes e mbaja mend në mënyrë të përsosur ëndrrën time, kështu që arrita të zbatoja metodën e Frojdit në ëndrrën time dhe ta shpjegoja atë deri në detajet e fundit. Në atë çast besova se do të fillonte një epokë e re për mua; që nga ai moment ëndrrat e mia nuk do të më mbanin më asnjë sekret. Nuk ndodhi. Kjo ishte hera e vetme që Frojdi kishte ndriçuar errësirën e nënndërgjegjes sime. Që nga ajo kohë kam vazhduar të ëndërroj si më parë. Por i harroj ëndrrat, ose nëse mund t'i kujtoj, nuk kuptoj asgjë nga ato. Shpjegimi i natyrës së ëndrrave të mia nuk do ta kënaqte më shumë një analist Frojdian sesa një Jungian. E lexoj Frojdin sepse e shoh si një shkrimtar të shkëlqyer... një shkrimtar i thrillerëve policor që mund të ndiqmë me shumë pasion. Kam lexuar gjithashtu Jungun, i cili është i interesuar për gjëra me interes të madh për një shkrimtar si simbolet dhe mitet. Jungu nuk është një shkrimtar aq i mirë sa Frojdi. Por, gjithsesi, unë jam i interesuar për të dy.

Si shkruani? Si e kryeni aktin fizik të shkruarit?

Shkruaj me dorë, duke bërë shumë e shumë korrigjime. Do të thoja që më shumë u bie kryq atyre që shkruaj sesa i mbaj. Më duhet të kërkoj të gjej fjalën e duhur kur flas dhe të njëjtën vështirësi kam kur shkruaj. Pastaj bëj shumë shtesa, përmirësime, që i shkruaj me një shkrim shumë të vogël. Vjen një çast kur unë vetë s'mund të lexoj shkrimin tim të dorës, kështu që përdor një lupë për të kuptuar se çfarë kam shkruar. Kam dy dorëshkrime të ndryshme. Njëri është i madh me shkronja mjaft të mëdha. Kjo është dora që përdor kur kopjoj ose kur jam mjaft i sigurt për atë që po shkruaj. Dora tjetër përkon me një gjendje mendore më pak të sigurt dhe shkrimi është shumë e vogël. Kjo është shumë e vështirë për t'u deshifruar, edhe për mua. Faqet e mia janë gjithmonë me rreshta të shkarravitur dhe të rishikuar. Ishte një kohë kur bëja disa variante të shkruara me dorë. Tani, pas variantit të parë, të shkruar me dorë dhe tërësisht të zhvarrosur, filloj ta shtyp, duke e deshifruar ndërsa vazhdoj. Kur më në fund rilexoj atë që kam shkruar me makinën e shkrimit, zbuloj një tekst krejtësisht të ndryshëm që shpesh e rishikoj më tej. Pastaj bëj më shumë korrigjime. Në çdo faqe përpqem fillimisht të bëj korrigjimet me një makinë shkrimi; më pas korrigjoj disa të tjera me dorë. Shpesh faqja bëhet aq e palexueshme saqë e shtyp për herë të dytë. I kam zili ata shkrimtarë që mund të vazhdojnë pa korrigjuar.

ITALO CALVINO:

Kam frikën e përsëritjes në veprën time letrare

Intervista për Paris Review

Përktheu nga anglishtja: Granit Zela

Mendime para një interviste

Çdo mëngjes i them vetes, sot duhet të jetë ditë e frytshme, dhe më pas ndodh diçka që më pengon të shkruaj. Sot...çfarë duhet të bëj sot? Oh po, ata duhet të vijnë të më intervistojnë. Kam frikë se romani im nuk do të bëjë asnjë hap përpara. Diçka ndodh gjithmonë. Çdo mëngjes tashmë e di se do të të më ik dita pa shkruar. Gjithmonë ka diçka për të bërë: shkruarja në bankë, te posta, pagesa e disa faturave... gjithmonë duhet të përballem me ndonjë lëmsh burokratik. Ndërsa jam jashtë shtëpisë, bëj edhe detyra të tilla si pazaret e përditshme: blerja e bukës, mishit ose frutave. Gjëja e parë, blej gazeta. Pasi t'i blej, filloj të lexojë sapo të kthehem në shtëpi, ose të paktën të shikoj titujt për të bindur veten se nuk ka asgjë që ia vlen të lexohet. Çdo ditë i them vetes se leximi i gazetave është humbje kohe, por pastaj...Nuk mund ta shtyj pa to. Ato janë si drogë. Me pak fjalë, vetëm pasdite ulem në tryezën e shkrimit, e cila është gjithmonë e mbuluar me letra që presin përgjigje nuk e di për sa kohë dhe kjo është një tjetër pengesë për t'u kapërcyer.

Përfundimisht filloj të shkruaj dhe më pas fillojnë problemet e vërteta. Nëse e nis diçka nga e para, ai është çasti më i vështirë, por edhe nëse kam diçka të nisur një ditë më parë, gjithmonë krijohet një ngërç ku duhet kapërcyer një pengesë e re. Dhe vetëm në orët e vona të pasdites më në fund filloj të shkruaj fjali, t'i korrigjoj, t'i mbush me fjali të atypëratyshme dhe t'i rishkruaj. Pikërisht në atë çast zakonisht bie zilja e telefonit ose e derës dhe vjen një mik, përkthyes ose intervistues. Meqe ra fjala...këtë pasdite... intervistuesit... Nuk e di nëse do të kem kohë për t'u përgatitur. Mund të përpqem të improvizoj, por besoj se një intervistë duhet të përgatitet para kohe që të duket spontane. Rrallëherë intervistuesi bën pyetje që nuk i prisje. Kam dhënë shumë intervista dhe kam arritur në përfundimin se pyetjet ngajjnë gjithmonë. Mund të jap gjithmonë të njëjtat përgjigje. Por besoj se duhet të ndryshoj përgjigjet e mia sepse me çdo intervistë diçka ka ndryshuar ose brenda meje ose në botë. Një përgjigje që ishte e duhura herën e parë mund të mos jetë e duhura herën e dytë. Kjo mund të jetë lënda e një libri. Më jepet një listë pyetjesh, gjithmonë e njëjta; çdo kapitull do të përmbante përgjigjet që do të jepja në kohë të ndryshme. Ndryshimet do të përmbajnë përgjigjet që do të jepja në kohë të ndryshme. Ndryshimet do të bëheshin më pas itinerari, historia që jeton protagonistin. Ndoshta në këtë mënyrë mund të zbuloj disa të vërteta për veten time. Por më duhet të shkoj në shtëpi, po afron koha që intervistuesit të mbërrijnë. Zoti më ndihmoft!

- Italo Calvino

Punoni çdo ditë apo vetëm në ditë dhe orë të caktuara?

Në teori do të doja të punoja çdo ditë. Por në mëngjes shpik çdo justifikim të mundshëm për të mos punuar: duhet të dal, të bëj disa blerje, të blej gazetën. Si rregull, arrij ta mbush mëngjesin me gjëra të tjera, ndaj përfundoj ulur për të shkruar pasdite. Jam një shkrimtar i ditës, por që kur e humbas mëngjesin jam bërë shkrimtar pasditeje. Mund të shkruaja natën, por kur e bëj, nuk fle. Kështu përpqem ta shmang këtë.

A keni gjithmonë një detyrë të caktuar, diçka specifike për të cilën vendosni të punoni? Apo keni gjëra të ndryshme që ndodhin në të njëjtën kohë?

Kam gjithmonë disa projekte. Kam një listë me rreth njëzet libra që do të doja të shkruaja, por më pas vjen çasti kur vendos që do ta shkruaj atë libër. Jam vetëm një romancier sipas rasis. Shumë nga librat e mi përbëhen nga tekste të shkurtra të mbledhura së bashku, tregime, ose janë libra që kanë një strukturë të përgjithshme, por janë të përbërë nga tekste të ndryshme. Krijimi i një libri rreth një ideje është shumë i rëndësishëm për mua. Kaloj shumë kohë duke krijuar një libër, duke bërë skica që përfundimisht rezultojnë të jenë të padobishme për mua. I hedh tutje. Ajo që e përcakton librin është shkrimi, materiali që është në fakt në faqe. E filloj shumë ngadalë. Nëse kam asnjë ide për një roman, gjej çdo pretext të mundshëm për të mos punuar me të. Nëse jam duke bërë një libër me tregime, tekste të shkurtra, secili ka kohën e vet të fillimit. Edhe me artikujt për gazetatat, çdo herë kam të njëjtën vështirësi për të filluar. Pasi të kem filluar, mund të jem mjaft i shpejtë. Me fjalë të tjera, shkruaj shpejt, por kam periudha të mëdha bosh. Është paksa si historia e artistit të madh kinez – perandori i kërkoi të vizatonte një gaforre dhe artisti u përgjigj, më duhen dhjetë vjet, një shtëpi e madhe dhe njëzet shërbëtorë. Kaluan dhjetë vitet dhe perandori i kërkoi vizatimin e gaforres. Më duhen edhe dy vjet, tha ai. Pastaj kërkoi edhe një javë të tjera. Dhe më në fund ai mori stilolapsin dhe vizatoi gaforren në një çast, me një gjest të vetëm dhe të shpejtë.

A filloni me një grup të vogël idesh të palidhura ose me një konceptim më të madh që e plotësoni gradualisht?

Filloj me një imazh të vogël, të vetëm dhe më pas e zmadhoj.

Turgenievi ka thënë: "Më mirë të kem pak arkitekturë sesa shumë, sepse kjo mund të ndërhyjë në të vërtetën e asaj që them". A mund ta komentoni këtë duke iu referuar shkrimeve tuaja?

Është e vërtetë që në të kaluarën, le të themi gjatë dhjetë viteve të fundit, arkitektura e librave të mi ka pasur një vend shumë të rëndësishëm, ndoshta tepër të rëndësishëm. Por vetëm kur ndjej se kam arritur një strukturë rigorozë, besoj se kam diçka që qëndron në këmbët e veta, një vepër të plotë. Për shembull, kur fillova të shkruaj "Qytetet e padukshme", kisha vetëm një ide të paqartë se cila do të ishte korniza, arkitektura e librit. Por më pas, pak nga pak, projekti u bë aq i rëndësishëm sa mbajtja të gjithë librin; u bë subjekti i një libri që nuk kishte subjekt. Me "Kështjellën e fateve të kryqëzuara" mund të themi të njëjtën gjë - arkitektura është vetë libri. Deri atëherë kisha arritur një nivel obsesioni me strukturën, saqë gati sa nuk u çmenda pas saj. Mund të thuhet për "Nëse në një natë dimri një udhëtar" se nuk mund të ekzistonte pa një strukturë shumë të saktë, shumë të artikuluar. Besoj se ia kam dalë mbanë, gjë që më jep një kënaqësi të madhe. Natyrisht, gjithë kjo lloj përpjekjeje nuk duhet të shqetësojë fare lexuesin. E rëndësishme është të kënaqem duke lexuar librin tim, pavarësisht nga puna që kam bërë me të.



Jetoni në disa qytete, duke lëvizur mjaft shpesh nga Roma në Paris në Torino dhe gjithashtu në këtë shtëpi pranë detit. A ndikon vendi ku jeni në punën që po bëni?

Nuk mendoj kështu. Përvoja e jetës së përditshme në një vend të caktuar mund të ndikojë në atë që po shkruan, por jo në faktin që po shkruani këtu ose atje. Aktualisht po shkruaj një libër që në një farë mase është i lidhur me këtë shtëpi në Toskanë ku kaloj verën prej disa vitesh. Por mund të vazhdoj me atë që po shkruaj në një vend tjetër.

A mund të shkruani në një dhomë hoteli?

Dikur thosha se dhoma e hotelit ishte hapësira ideale – bosh, anonime. Nuk ka një pirg letrash që duhet t’u përgjigjesh (ose pendimi që nuk u je përgjigjur); nuk kam shumë detyra të tjera. Në këtë kuptim, një dhomë hoteli është vërtet ideale. Por më duket se kam nevojë për një hapësirë timen, një strofull, megjithëse mendoj se nëse diçka është vërtet e qartë në mendje, mund ta shkruaj edhe në një dhomë hoteli.

A udhëtoni me shënime dhe letra?

Po, shpesh mbaj shënime me vete dhe skica. Në dhjetë vitet e fundit apo më shumë, skicat e jetës sime janë bërë diçka si një idengulitje.

Prindërit tuaj ishin të dy shkencëtarë. A nuk donin të bënin edhe ju një shkencëtar?


Babai ishte agronom; nëna, botaniste. Ata ishin shumë të angazhuar me botën e perimeve, me natyrën, me shkencat natyrore. Por e kuptuan shumë herët se nuk kisha prirje në atë drejtim – reagim i zakonshëm të fëmijëve ndaj prindërve të tyre. Tani më vjen keq që nuk përvetësova aq shumë nga njohuritë e tyre sa mund të kisha. Reagimi im mund të ketë ndodhur pjesërisht për shkak të faktit se prindërit e mi ishin më të rritur. Kam lindur kur nëna ishte dyzet vjeçe dhe babai gati pesëdhjetë, kështu që kishte një distancë të madhe mes nesh.

Kur keni filluar të shkruani?

Adoleshent nuk e kisha idenë se çfarë doja të isha. Fillova të shkruaj shumë herët. Por, përpara se të shkruaja, pasioni im ishte vizatimi. Kam bërë karikatura të shokëve të klasës, mësuesve të mi. Vizatime fantastike, por pa u shkolluar si t’i bëj. Kur isha i vogël, nëna më regjistroi në një kurs vizatimi me korrespondencë; gjeja e parë e botuar - nuk kam një kopje tani dhe nuk kam mundur ta gjej një - ishte një vizatim. Isha njëmbëdhjetë vjeç. U botua në një revistë të kësaj shkolle. Isha nxënësi i tyre më i ri. Kam shkruar poezi shumë i vogël. Kur isha rreth të gjashtëmbëdhjetave u përpoqa të shkruaj pjesë për teatrin; ishte pasioni im i parë, ndoshta sepse gjatë asaj periudhe një nga lidhjet e mia me botën e jashtme ishte radioja dhe dëgjoja shumë radiodrama. Kështu që fillova duke shkruar – duke u përpjekur të shkruaj – drama. Në fakt, për dramën e mia dhe gjithashtu për disa tregime kam qenë ilustruesi i tyre dhe autor. Por kur fillova të shkruaj me zell, ndjeva se vizatimit tim i mungonte çdo lloj stili. Nuk e kisha zhvilluar një të tillë. Kështu që hoqa dorë nga vizatimi. Disa njerëz – për shembull, gjatë një takimi – bëjnë shkaravinë dhe do të bëjnë vizatime të vogla në një fletë letre. Unë as që jam shkolluar për ta bërë këtë.

Pse e braktisët teatrin?

Pas luftës, teatri në Itali nuk ofroi modele. Proza italiane po lulëzonte dhe kështu fillova të shkruaj letërsi. Kam njohur shumë shkrimtarëh. Pastaj fillova të shkruaj romane. Është çështje mekanizmesh mendor. Nëse mëson të përkthesh në roman përvojat, idetë e dikujt, ajo që ke për të thënë, bëhet roman; mbetesh pa lëndë të parë për një formë tjetër të shprehjes letrare.



Mënyra ime e të shkruarit të prozës është më e afërt me mënyrën se si një poet krijon një poezi. Nuk jam romancier që shkruan romane të gjata. E përqendroj një ide ose një përvojë në një tekst të shkurtër sintetik që shkon krah për krah me tekste të tjera për të formuar një seri. I kushtoj vëmendje të veçantë shprehjeve dhe fjalëve si në lidhje me ritmet, tingujt e tyre dhe imazhet që ndjellin. Unë besoj, për shembull, që “Qytetet e padukshme” është një libër, vendi i të cilit është mes poezisë dhe romanit. Nëse do ta shkruaja plotësisht në vargje, do të ishte një lloj poezie prozaike, narrative. . ose ndoshta poezi lirike, sepse poezia lirike është ajo që dua më shumë dhe ajo që lexoj nga poetët e mëdhenj.

Cilët ishin shkrimtarët që keni lexuar me kënaqësinë më të madhe dhe ata që ju kanë lënë përshtypjen më të madhe?

Herë pas here, kur rilexoj libra nga adoleshenca dhe rinia, habitem kur rizbuloj një pjesë të vetes që dukej se e kisha harruar, megjithëse ka vazhduar të veprojë brenda meje. Për shembull, pak kohë më parë, rilexova legjendën e Shën Julianit dhe kujtova se sa shumë ndikoi ai – me pamjen e tij për botën e kafshëve si një sixhade gotike – në prozën time të hershme. Disa shkrimtarë që kam lexuar kur isha djalë, si Stevenson-i, kanë mbetur për mua modele stili, butësie, shtytjeje narrative dhe energjie. Autorët e leximit tim të fëmijërisë, si Kipling dhe Stevenson, mbeten modelet e mia. Pranë tyre do të vendosja Stendalin e *Manastirit të Parmës*.

Me Pavesen dhe shkrimtarët e tjerë të shtëpisë botuese “Einaudi” keni pasur edhe një shoqëri letrare, apo jo? Ju u dhatë atyre dorëshkrimet tuaja për t’i lexuar dhe komentuar.

Po. Në atë kohë unë shkruaja shumë tregime dhe ia tregova Pavese-s, Natalia Ginzburg-ut, e një shkrimtare e re që gjithashtu punonte atje, ose ia çoja në Vittorini në Milano, që është vetëm dy orë larg Torinos. I kushtova vëmendje mendimeve të tyre. Në një moment të caktuar, Pavese më tha: Ne e dimë tani që mund të shkruash tregime; duhet ta ndash mendjen dhe të shkruash një roman. Nuk e di nëse kjo ishte një këshillë e mirë apo jo, sepse isha tregimtar. Nëse do të kisha thënë gjithçka që kisha për të thënë në formën e tregimeve, do të kisha shkruar tregime që nuk i kam shkruar më kurrë. Gjithsesi, romani im i parë u botua dhe pati sukses. Për disa vite u përpoqa të shkruaj një tjetër. Por klima letrare tashmë po përkufizohej si neoralizëm dhe nuk ishte për mua. Në fund

iu ktheva fantazisë në të cilën u shpreha vërtet. Unë them “u ktheva” sepse kjo ishte ndoshta natyra ime e vërtetë. Ishte vetëm fakti që kisha përjetuar luftën dhe peripecitë e Italisë së atyre viteve që më lejoi për një kohë të punoja mjaft i lumtur në një drejtim tjetër derisa “u ktheva” dhe gjeta një lloj shpikjeje që më përkiste mua.

A janë romancierët gënjeshtarë? Dhe nëse nuk janë, çfarë lloj të vërtetë thonë ata?

Romancierët tregojnë atë pjesë të së vërtetës të fshehur në fund të çdo gënjeshtre. Për një psikoanalist nuk është aq e rëndësishme nëse thoni të vërtetën apo gënjeshtërën sepse gënjeshttrat janë po aq interesante, elokuede dhe zbuluese sa çdo e vërtetë e mëtuar. Dyshoj te shkrimtarët që mëtojnë se thonë të gjithë të vërtetën për veten, për jetën ose për botën. Parapëlqej të qëndroj me të vërtetat që gjej te shkrimtarët që e paraqesin veten si gënjeshtarët më të guximshëm. Qëllimi im me romanin “Nëse në një natë dimri një udhëtar”, një roman tërësisht i mbështetur në fantazi, ishte të gjeja në këtë mënyrë një të vërtetë që nuk do të kisha mundur ta gjeja ndryshe.

A besoni se shkrimtarët shkruajnë atë që munden ose më mirë atë që duhet?

Shkrimtarët shkruajnë çfarë të munden. Akti i të shkruarit është një funksion që bëhet i efektshëm vetëm nëse e lejon njeriun të shprehë brendësinë e tij. Një shkrimtar ndjen disa lloje kufizimesh - kufizime letrare si numri i rreshtave në një sonet ose rregullat e tragjedisë klasike. Këto janë pjesë e strukturës së veprës brenda së cilës personaliteti i shkrimtarit është i lirë të shprehet. Por pastaj ka kufizime sociale si detyrat fetare, etike, filozofike dhe politike. Këto nuk mund t’i imponohen drejtpërsëdrejti veprës, por duhet të filtrohen përmes brendësisë së shkrimtarit. Vetëm nëse janë pjesë e personalitetit më të thellë të shkrimtarit, mund të gjejnë vendin e tyre në vepër pa e mbytur atë.

Keni diskutuar ndryshimin në statusin social të shkrimtarëve amerikanë dhe italianë – shkrimtarët italianë janë më të lidhur ngushtë me industrinë botuese, ndërsa ata amerikan zakonisht janë të lidhur me institucionet akademike.

Si mjedis për një roman, universiteti - kaq i shpeshtë në romanet amerikane - është shumë i mërzitshëm (Nabokov është një përjashtim i madh), madje më i mërzitshëm se mjedisi i shtëpisë botuese në disa libra italian.

Lufta mes njeriut që përpiqet të organizohet mes rastësisë duket se është një temë që përshkon pjesën më të madhe të veprës suaj. Po mendoj veçanërisht për “Nëse një natë dimri një udhëtar” dhe Lexuesin, i cili vazhdon të përpiqet të gjejë kapitullin tjetër të librit që po lexon.

Konflikti midis zgjedhjeve të botës dhe idengulitjes së njeriut për t’i kuptuar ato është një model i përsëritur në atë që kam shkruar.

Në librat tuaj ju jeni zhvendosur midis mënyrave realiste dhe fantastike të të shkruarit. Ju pëlqejnë të dyja njësoj?

Kur shkruaj një libër që është i gjithi i trilluar, ndiej një dëshirë për të shkruar që ka të bëjë drejtpërdrejt me jetën e përditshme, aktivitetet dhe mendimet e mia. Në atë çast libri që do të doja të shkruaja është ai që nuk jam. Nga ana tjetër, kur po shkruaj diçka shumë autobiografike, të lidhur me veçoritë e përditshmërisë, atëherë gjakimi im shkon në drejtim të kundërt. Libri kthehet në atë të trillimit pa asnjë lidhje të dukshme me veten time dhe ndoshta, pikërisht për këtë arsye, është më i sinkertë.

A besoni se Evropa është e pushtuar nga kultura britanike dhe amerikane?

Jo. Nuk kam asnjë lloj reagimi shovinist kundrejt kësaj. Njohja e kulturave të huaja është një element jetik i çdo kulture. Nuk besoj se mund të na mjaftojë ndonjëherë. Një kulturë duhet të jetë e hapur ndaj ndikimeve të huaja nëse dëshiron të mbajë gjallë fuqinë e saj krijuese. Në Itali komponenti më i rëndësishëm kulturor ka qenë gjithmonë letërsia franceze. Edhe letërsia amerikane, sigurisht që më ka lënë gjurmë gjatë gjithë jetës. Poe ishte një nga interesat e mia të para; ai më mësoi se çfarë ishte një roman. Më vonë zbulova se Hawthorne ndonjëherë ishte më i madh se Poe. Ndonjëherë, jo gjithmonë. Melville. Një roman i përsosur, *Benito Cereno*, ishte edhe më i vlefshëm se *Mobi Dik*. Në fund të fundit, mësimi im i parë ishte nën hijen e Cesare Pavese-s, përkthyesit të parë italian të Melville-it. Gjithashtu ndër modelet e mia të para letrare kanë qenë shkrimtarë të tillë të vegjël amerikanë të fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë si Stephen Crane dhe Ambrose Bierce. Vitet e zhvillimit tim letrar, të dyzetat e hershme, u mbizotëruan para së gjithash nga Hemingway, Faulkner dhe Fitzgerald. Në atë kohë ne përjetuam këtu në Itali një lloj pasioni pas letërsisë amerikane. Edhe autorë shumë të vegjël si Saroyan, Caldwell dhe Cain konsideroheshin modele stili. Pastaj ishte Nabokovi, tifoz i të cilit u bëra. Më duhet të pranoj se interesimi im për letërsinë amerikane është disi i nxitur nga dëshira për të ndjekur atë që ndodh në një shoqëri që në një farë mënyre parashikon atë që do të ndodhë në Evropë disa vite më vonë. Në këtë kuptim, shkrimtarë si Saul Bellow, Mary McCarthy, Gore Vidal janë të rëndësishëm për shkak të kontaktit të tyre me shoqërinë që shprehet në krijimin e eseve cilësore. Në të njëjtën kohë, unë jam gjithmonë në kërkim të zërave të rinj letrarë – këtu hyn zbulimi i romaneve të John Updike në mesin e viteve pesëdhjetë.

A jeni mërzitur ndonjëherë?

Po, në fëmijërinë time. Por duhet theksuar se mërzia e fëmijërisë është një lloj mërzie e veçantë. Është një mërzitje plot ëndrra, një lloj projekcioni në një vend tjetër, në një realitet tjetër. Në moshën madhore mërzia vjen nga përsëritja, është vazhdimësi e diçkaje nga e cila nuk presim më asnjë befasi. Dhe unë - sikur të kisha kohë të mërzitesha sot! Sot kam frikën e përsëritjes në veprën time letrare. Kjo është arsyeja që çdo herë më duhet të përballem me një sfidë të re. Duhet të gjej diçka për të bërë që të duket si një risi, diçka pak përtej mundësive të mia.

Karikaturë nga Arben Mexsi

